

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2022



43

PRISHTINË
2023

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2022

43



PRISHTINË
2023

**KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

YEAR-BOOK 2022

43

Editor: Academician Justina Shiroka-Pula

Prepared by: Lendita Juniku-Pula



**PRISHTINA
2023**

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS**

VJETARI 2022

43

Redaktor: Akademike Justina Shiroka-Pula

Përgatitur nga: Lendita Juniku-Pula



**PRISHTINË
2023**

Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

| | |
|------------------------------------------------------------------------------|----|
| PËRBËRJA E AKADEMISË | 1 |
| KRYESIA | 1 |
| ANËTARËT E AKADEMISË | 3 |
| SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË | 3 |
| SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE | 3 |
| SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS | 3 |
| SEKSIONI I ARTEVE | 4 |
| ANËTARËT IN MEMORIAM | 4 |
| ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS | 4 |
| ANËTARËT E JASHTËM | 4 |
| ANËTARË NDERI | 5 |
| SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE DHE TEKNIKE | 5 |
| | |
| RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022 | 9 |
| KUVENDI I AKADEMISË | 9 |
| KRYESIA | 19 |
| SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË | 47 |
| SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE | 52 |
| SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS | 53 |
| SEKSIONI I ARTEVE | 57 |
| | |
| SHËRBIMI PROFESIONAL, ADMINISTRATIV E TEKNIK | 59 |
| | |
| PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK- ut PËR VITIN 2023 | 67 |
| | |
| PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS | 85 |
| | |
| KRONIKA E VITIT 2022 | 99 |

PËRBËRJA E AKADEMISË

KRYESIA



Akademik
Mehmet Kraja
Kryetar
(3.10.2019 – vazhdim)



Akademie
Justina Shiroka-Pula
Nënkryetare



Anëtar
korrespondent
Luan Mulliqi
Sekretar shkencor




Akademik
Sabri Hamiti
Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë



Anëtare
korrespondente
Gjyljeta Mushkolaj
Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore



Anëtar
korrespondent
Fetah Podvorica
Sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës



Akademik
Rauf Dhomi
U.D. Sekretar i Seksionit të Arteve

PËRBËRJA E AKADEMISË

ANËTARËT E AKADEMISË

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Ali Aliu (1934), i zgjedhur më 2000,
Eqrem Basha (1948), i zgjedhur më 2004,
Kujtim Shala (1974), i zgjedhur më 2020,
Mehmet Kraja (1952), i zgjedhur më 2008,
Rexhep Ismajli (1947), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Qosja (1936), i zgjedhur më 1975,
Sabri Hamiti (1950), i zgjedhur më 2008.
Zejnullah Rrahmani (1952), i zgjedhur më 2016.

b) Anëtarët korrespondentë:

Bardh Rugova (1974) i zgjedhur më 2016,
Mehmet Halimi (1937), i zgjedhur më 2012,
Nysret Krasniqi (1976), i zgjedhur më 2020,
Shkumbin Munishi (1971) i zgjedhur më 2020.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Anton K. Berishaj (1954), i zgjedhur më 2016,
Edi Shukriu (1950), e zgjedhur më 2020
Hivzi Islami (1946), i zgjedhur më 2000,
Isa Mustafa (1951), i zgjedhur më 2012,
Jusuf Bajraktari (1948), i zgjedhur më 2016.
Justina Shiroka Pula (1953), e zgjedhur më 2020,
Muhamedin Kullashi (1949), i zgjedhur më 2016.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Bajrami (1960), i zgjedhur më 2012,
Besnik Krasniqi (1978), i zgjedhur më 2020,
Frashër Demaj (1973), i zgjedhur më 2016,
Gjyljeta Mushkolaj (1963), e zgjedhur më 2016,

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Fejzullah Krasniqi (1953), i zgjedhur më 2012,
Feriz Krasniqi (1931), i zgjedhur më 2000,
Isuf Krasniqi (1948), i zgjedhur më 2012,

Minir Dushi (1929), i zgjedhur më 1979,
Nexhat Daci (1944), i zgjedhur më
1996.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Morina (1956), i zgjedhur më
2012,
Fetah Podvorica (1968), i zgjedhur më
2016,
Myzafere Limani (1954), e zgjedhur më
2016,
Qamil Haxhibeqiri (1949), i zgjedhur më
2012,
Salih Gashi (1944), i zgjedhur më 2012.

SEKSIONI I ARTEVE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Rauf Dhomi (1945), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Ferri (1937), i zgjedhur më 2000,
Tahir Emra (1938), i zgjedhur më 2008,
Zeqirja Ballata (1943), i zgjedhur më 2000.

b) Anëtarët korrespondentë:

Luan Mulliqi (1953), i zgjedhur më 2012,
Xhevdet Xhafa (1934), i zgjedhur më 2012.

ANËTARËT IN MEMORIAM

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Agim Çavdarbasha,
Ali Hadri,
Ali Podrimja,
Idriz Ajeti,
Besim Bokshi,
Dervish Rozhaja,
Ekrem Murtezai,
Engjëll Berisha,
Esat Stavileci,
Enver Gjerqeku,
Esad Mekuli,
Fehmi Agani,

Gazmend Zajmi,
Jashar Rexhepagiq,
Latif Susuri,
Mark Krasniqi,
Muharrem Berisha,
Musa Haxhiu,
Muslim Mulliqi,
Osman Imami,
Pajazit Nushi,
Remzi Bakalli,
Syrja Popovci,
Vladeta Vukoviq,
Vukasin Filipoviq.

b) Anëtarët korrespondentë:

Anton Pashku,
Eshref Ademaj,
Hajredin Hoxha,
Ibrahim Rugova,
Ruzhdi Pllana.

ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Sinan Hasani (letërsi), Serbi, i zgjedhur
më 1986.

b) Anëtarët korrespondentë:

Zef Mirdita (histori), Kroaci, i zgjedhur
më 1991.

ANËTARËT E JASHTËM

Aleksandar Stipçeviq (histori), Kroaci, i
zgjedhur më 1983,
Abdylmenaf Bexheti (ekonomi),
Maqedoni e Veriut, i zgjedhur më
2020,
Brian D. Joseph (gjuhësi), SHBA, i
zgjedhur më 2020,
Ismail Kadare (letërsi), Shqipëri, i

zgjedhur më 1991,
Irena Sawicka (gjuhësi), Poloni, e
zgjedhur më 2020,
Wilfried Fiedler (gjuhësi), Gjermani, i
zgjedhur më 1991,
Eric Hamp (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur
më 1991,
Shaban Demiraj (gjuhësi), Shqipëri, i
zgjedhur më 1996,
Gunnar Svane (gjuhësi), Danimarkë, i
zgjedhur më 1996,
Kristian Gyt (histori e kulturës), Francë,
i zgjedhur më 1996,
Gjelosh Gjokaj (art figurativ), Gjermani,
i zgjedhur më 1996,
Leonard Newmark (gjuhësi), SHBA, i
zgjedhur më 2000,
Robert Elsie (letërsi), Kanada, i zgjedhur
më 2000,
Michel Roux (gjeografi, gjeopolitikë),
Francë, i zgjedhur më 2000,
Muhamedin Kullashi (filozofi), Francë, i
zgjedhur më 2000,
Tomë Berisha (elektroteknikë), Kroaci, i
zgjedhur më 2000,
Noel Malcolm (histori), Angli, i zgjedhur
më 2004,
Victor Friedman (gjuhësi), SHBA, i
zgjedhur më 2004,
Emin Riza (arkitekturë), Shqipëri, i
zgjedhur më 2008,
Françesko Altimari (gjuhësi), Itali, i
zgjedhur më 2008,
Muhamet Mufaku (histori), Jordan, i
zgjedhur më 2008,
Alajdin Abazi (elektroteknikë),
Maqedoni, i zgjedhur më 2012,
Kolec Topalli (gjuhësi), Shqipëri, i
zgjedhur më 2012,
Oliver Schmit (histori), Austri, i
zgjedhur më 2012,
Radoslav Katičić (gjuhësi), Kroaci, i
zgjedhur më 2012,
Bahri Beci (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur
më 2016,
Matteo Mandala (gjuhësi), Itali, i

zgjedhur më 2016,
Mentor Petrela (mjekësi), Shqipëri, i
zgjedhur më 2016,
Kristaq Prifti (histori), Shqipëri, i
zgjedhur më 2016.

ANËTARË NDERI

Ferid Murati, nobelist, jeton në SHBA, i
zgjedhur më 2000.

SHËRBIMI ADMINISTRATIV, PROFESIONAL E TEKNIK

Lendita Juniku Pula, sekretare e
Akademisë,
Vjollca Hykolli, drejtoreshë e
Departamentit për Buxhet dhe
Financa,
Hilmi Zogjani, drejtor i Departamentit
të Bibliotekës dhe Arkivit,
Furtuna Naka, udhëheqëse e
prokurimit,
Xhemshit Brajshori, zyrtar i lartë për
marrëdhënie ndërkombëtare,
Hasime Maliqi, zyrtare certifikuese,
Lirijeta Bunjaku, zyrtare e lartë për
buxhet dhe financa,
Lidije Kelmendi, zyrtare e librarisë,
Rejhane Ajeti Islami, zyrtare e lartë për
bibliografi dhe hulumtim shkencor
Bedri Pllana, zyrtar bibliotekar,
Naime Veliu, zyrtare për arkiv
Taulant Veseli, administrator i lartë i
sistemeve të TIK-ut,
Gerta Çuna, zyrtare e TI- së për
përkrahje,
Burim Rexhepi, zyrtar i lartë për
botime,
Nitë Krasniqi, zyrtare e logjistikës
Dafina Kavaja, asistente ekzekutive
Petrit Bashota, asistent administrativ
Alban Bytyçi, vozitës-korrier,
Valbona Olluri, zyrtare teknike.

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022



RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2022

KUVENDI I AKADEMISË

Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 2022 ka mbajtur tri mbledhje. Mbledhja e parë më 23 shkurt (CVI), mbledhja e dytë më 30 qershor (CVII) dhe mbledhja e tretë, (CVIII) më 27 tetor.

I. Mbledhjen e parë të vitit 2022(CVI) e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja dhe Kuvendi e miratoi rendin e ditës : Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CV të Kuvendit të Akademisë; Miratimi i Raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2021; Miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2021; Miratimi i Planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut 2022-2025; Shqyrtimi dhe miratimi i rregulloreve të ASHAK-ut: Rregullorja për veprimtarinë botuese dhe Rregullorja për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese dhe çështje vijuese.

Para miratimit të procesverbalit diskutoi H. Islami. Ai paraqiti vërejtje për përmbajtjen e procesverbalit dhe tha se sekretarja e Akademisë nuk e ka pasqyruar drejt rrjedhën e mbledhjes në procesverbal, ashtu që nuk e ka përfshirë gjithë diskutimin e tij, por edhe diskutimet e S. Hamitit, R. Ismajlit, Gj. Mushkolaajt dhe A. Bajramit. Ai në vazhdim tha se mbledhjet incizohen dhe sekretarja duhet t'i nxjerrë edhe një herë shënimet dhe ta plotësojë procesverbalin. Kryetari Kraja njoftoi se mbledhjet nuk incizohen, sepse nuk ka vendim për një gjë të tillë dhe se incizimi nuk mund të bëhet pa një vendim të Kuvendit. Ai më pas e hapi diskutimin dhe meqë diskutime nuk pati, Kryetari

propozoi që procesverbalin të plotësohet me vërejtjet e H. Islamit. Propozimi u miratua njëzëri nga Kuvendi. Procesverbalin i mbledhjes CV u miratua me kërkesën që të bëhen plotësimet dhe me to të njoftohet Kuvendi në mbledhjen e radhës. Më pas filloi shqyrtimi i pikës së dytë të rendit të ditës. Fillimisht para fillimit të shqyrtimit të Raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2021, kryetari Kraja paraqiti një rekapitullim të punës gjatë vitit. Ai në fjalën e tij tha:

“Të nderuar akademikë, të nderuar kolegë!

Para se të kalojmë në shqyrtimin e raportit të punës për vitin 2021, më lejoni t'i them disa fjalë, sa të mundem përmbledhëse, për punën e Akademisë gjatë vitit të shkuar.

Viti i shkuar në pikëpamje të masave ndaj pandemisë, ka qenë një vit relativisht më i lehtë, megjithatë nuk mund të themi se ishim të liruar tërësisht në pikëpamje të kufizimeve që u desh të zbatonim në programin tonë të aktiviteteve publike dhe me praninë e audiencës. Por më duhet të them se, me gjithë kufizimet, kemi arritur të realizojmë konferenca, promovime, ekspozita, koncerte më shumë se çdoherë tjetër, më shumë se çdo vit tjetër, të gjitha këto me paraqitje publike të suksesshme, që kanë tërhequr vëmendjen e opinionit shkencor dhe të artdashësve në numër të konsiderueshëm.

Ajo që bie në sy vazhdimisht është se pjesëmarrja e anëtarëve të Akademisë në këto aktivitete vazhdon të jetë relativisht e vogël, pjesëmarrje kjo që kufizohet kryesisht te seksionet përkatëse, duke mos u përfshirë në veprimtari në masë të

mjaftueshme anëtarësia e gjerë e Akademisë.

Megjithatë, ajo që dua të them në këtë rast, është se viti i shkuar ishte vit i zgjedhjeve të brendshme të Akademisë, të cilat, edhe përkundër disa pakënaqësive dhe kontestimeve mbetur në tentativë, u zhvilluan dhe përfunduan me sukses, ashtu siç ishte paraparë dhe ashtu siç e do ligji dhe statuti, edhe aktet e tjera normative.

Më lejoni të them tani se në punën e Akademisë duhet t'i avancojmë disa procese, në mënyrë që si institucion të arrijmë rezultate më të mira, prestigj shoqëror dhe paraqitje publike më dinjitoze. Dhe imazhin negativ që na shoqëron që prej një kohe të gjatë duhet ta mënjanojmë përfundimisht, kryesisht duke vënë nën kontroll daljet e parregullta financiare, intensifikim të aktivitetit në fushat e shkencës dhe të arteve, paraqitje më të mirë publike dhe punë më e mirë profesionale në projektet, në botimet dhe në revistat tona.

Me qëllim që të bëhet një prezantim më i mirë i punës së institucionit, tashmë janë ndërmarrë masat përkatëse për ndryshime përmbajtësore dhe vizuale të faqes sonë të internetit, e cila gjendet tashmë në fazën e ristrukturimit dhe të ngritjes në një standard më të lartë. Në të ardhmen, për mirëmbajtjen dhe përditësimin e përmbajtjeve do të përkujdeset nënkryetarja e Akademisë dhe sekretarët e seksioneve.

Ndërkaq, sa u përket botimeve, njëra nga shtyllat kryesore të punës së Akademisë, viti i shkuar ka qenë më i suksesshmi në historinë e këtij institucioni: janë botuar 24 tituj me afër 10 mijë faqe shkrime origjinale, gjë që e bën Akademinë botuesin më prestigjioz në mbarë hapësirën shqiptare. Ajo që na ka munguar dhe që kërkon punë më

këmbëngulëse, është puna redaktoriale, që është e lidhur me sekretarët e seksioneve, të cilët janë njëkohësisht edhe redaktorë të botimeve. Në të ardhmen redaktuarës së teksteve do t'i kushtohet kujdes i shtuar, në mënyrë që edhe cilësia e botimeve të rritet suksesivisht.

Punë më pak cilësore është bërë me revistat, të cilat, me gjithë ndonjë ndërhyrjeje, nuk po arrijnë të konsolidohen dhe ta marrintribute të revistave të mirëfillta shkencore, sipas standardeve që e kërkon institucioni ynë. Disa përparime janë bërë, por mbetet akoma shumë punë. Përfitoj nga rasti që t'i ftoj seksionet përkatëse që të merren më shumë me revistat, me nxitjen më të madhe të bashkëpunëtorëve dhe me respektimin e standardeve që kërkon botimi i revistave të nivelit akademik. Në të ardhmen, krahas ngritjes së cilësisë, do të bëjmë përpjekje që publikimin e revistave ta bëjmë përmes një platforme digjitale, të cilën do të duhej ta inauguronim në një periudhë jo të largët.

Një problem i mprehtë mbetet çështja e projekteve, të cilët deri tani, për shkak të mungesës së një rregulloreje, kanë qenë burim i daljeve financiare të pakontrolluara, pagesa sipas hamendjes, pa matje të vlerës dhe kohës së punës e kështu me radhë, përfshirë edhe ndonjë rast kur pagesa janë bërë edhe për pjesëmarrës pa asnjë kontribut real. Që ta tejkalojmë edhe këtë situatë jo të mirë për institucionin, në Kryesi do të inicioj menjëherë formimin e një grupi të punës për hartimin e një rregulloreje për projekte, pavarësisht nga vështirësitë që paraqiten për shkak të specifikave të ndryshme që kanë projektet tona. Besoj se në mbledhjen e radhës së Kuvendit, pra në qershor, shpresoj të keni përpara një draft rregulloreje për projektet.

Të nderuar kolegë!

Mbetet që këtë vit, përveç programit të punës, të realizojmë edhe disa nisma të tjera aktiviteteve shkencore dhe artistike, si ekspozita, tryeza shkencore etj. Mendoj se përmes disa tryezave shkencore duhet t'i përgjigjemi aktualitetit shoqëror dhe shkencor, pra do të ishte mirë ta intensifikojmë këtë veprimtari: t'i bëjmë tryezat tona shkencore vend ku debatohet për probleme të mprehta shoqërore dhe për çështje të rëndësishme shkencore, por gjithnjë duke pasur në vëmendje ruajtjen e nivelit shkencor të audiencës dhe të pjesëmarrësve.

Ju faleminderit!”

Në vazhdim u shqyrtua Raporti i punës i ASHAK-ut për vitin 2021, me radhë duke filluar nga Kuvendi, Kryesia, seksionet e deri te Shërbimi profesional, administrativ e teknik. Raporti u miratua njëzëri dhe si i tillë do të botohet në revistën Vjetari 2021.

Edhe Raporti financiar për vitin 2021 u miratua pa vërejtje.

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, M. Limani kryesuese e grupit punues për hartimin e Planit strategjik e njoftoi Kuvendin për ecurinë e punës së hartimit të këtij dokumenti. Ajo tha se pas mbledhjes së Kuvendit të Akademisë, më 30 qershor 2021, në të cilën nuk u miratua Plani strategjik, grupi punues është mbledhur dhe e ka shqyrtuar edhe një herë dokumentin në fjalë. Më pas anëtarëve të Akademisë iu është dërguar ky dokument, por kësaj radhe nuk ka pasur asnjë vërejtje apo sugjerim shtesë. Kryetari Kraja më pas propozoi që Plani strategjik gjithëpërfshirës i ASHAK-ut, 2022-2025 të miratohet nga Kuvendi. Propozimi u miratua njëzëri.

Në kuadër të pikës së pestë të rendit të ditës u shqyrtuan rregulloret e ASHAK-ut: Rregullorja për veprimtarinë botuese dhe Rregullorja për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese. M. Limani kryesuese e grupit punues për plotësimin e rregulloreve e njoftoi Kuvendin për ecurinë e punës. Ajo tha se pas hartimit të drafteve të rregulloreve, ato u janë ndarë të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe janë shqyrtuar nëpër mbledhje të rregullta të seksioneve të ASHAK-ut. Janë paraqitur vërejtje dhe sugjerime, prej të cilave disa janë marrë parasysht nga grupi punues e disa jo, meqë ashtu është vlerësuar. Kryetari Kraja në fjalën e tij tha se rregulloret nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha, por vetëm janë plotësuar aty ku ka pasur nevojë. Ai e hapi diskutimin lidhur me këtë pikë. Lidhur me Rregulloren për veprimtarinë botuese diskutuan S. Hamiti, R. Ismajli dhe B. Krasniqi. S. Hamiti e R. Ismajli thanë se në Seksionin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë është propozuar që te copyright ASHAK, të shtohet edhe viti i botimit, po kjo nuk është marrë parasysht. M. Limani sqaroi se kjo çështje është trajtuar me kujdes nga grupi punues dhe se grupi ka konsideruar se copyright ASHAK duhet të mbetet ashtu siç është paraqitur në Rregullore, sepse autorit nuk i ndalohet të botojë veprën e botuar në ASHAK, vetëm se këtë mund ta bëjë në bazë të marrëveshjes paraprake me ASHAK-un. B. Krasniqi në diskutimin e tij tha se çështja e copyright rregullohet me kontratën e autorit që nënshkruhet nga vetë ai dhe ASHAK-u, prandaj nuk shihet ndonjë pengesë në këtë drejtim.

Pas diskutimeve kryetari Kraja e paraqiti për votim Rregulloren për veprimtarinë botuese. Rregullorja u miratua me shumicë votash.

Më pas u shqyrtua edhe Rregullorja për honorarët e autorëve të veprimtarisë

botuese. Diksutuan J. Bajraktari dhe F. Demaj. J. Bajraktari propozoi që të bëhet një ndryshim, si në vijim:

Te neni 3, paragrafi 1, pjesa e parë e nënparagrafit 1.3, “dokumente arkivore” të bartet te nënparagrafi 1.2 i po këtij neni.

F. Demaj paraqiti arsyetimin se pse duhet të bëhet ky ndryshim.

Pas diskutimeve kryetari Kraja e paraqiti për votim Rregulloren në fjalë me propozimin e J. Bajraktarit dhe F. Demajt. Rregullorja me ndryshimet e propozuara u miratua me shumicë votash.

Neni 3, paragrafi 1 i Rregullores së miratuar tani do të jetë:

“1. Honorari për tabak autori paguhet:

1.1. Për punime origjinale 180€;

1.2. Për përgatitjen e botimeve kritike (që përfshin komentet, bibliografitë, indeksi i emrave, shënimet, përgatitjen dhe kritikën e teksteve, të gjitha punët e nevojshme kur ato i kryen përgatitësi i tekstit, aparatit kritik, tabelat, transkriptimet-transliterimet dhe mjetet e tjera ndihmëse) dhe për dokumente arkivore 145€;

1.3. Për materiale folklorike dhe leksikore, për përmbledhjen e Vjetarit dhe materialeve kompjuterike 30€”.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës H. Islami kërkoi sqarime se pse nuk është nënshkruar ende Protokollin i bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, 2022-2023. Ai tha se seksionet i kanë paraqitur propozimet e tyre me kohë, por nuk ka informacion se a janë marrë parasysht ato propozime. Kryetari Kraja njoftoi se drafti i Protokollit është i gatshëm, por Seksioni i Gjuhës ka caktuar edhe një mbledhje për këtë çështje, ndërsa sa u përket

propozimeve të SSSH dhe seksioneve të tjera, ato janë përfshirë të gjitha në draft. Drafti është miratuar në mbledhjen e Kryesisë dhe është thënë që sekretarët e seksioneve të njoftojnë seksionet e tyre për përmbajtjen e draftit të fundit.

Ai tha se, nëse seksionet e konsiderojnë të nevojshme të shqyrtojnë edhe një herë draftin përfundimtar, mund ta bëjnë një gjë të tillë. Kryesia mund të presë edhe disa ditë dhe më pas të procedohet Protokollin për nënshkrim. U tha që seksionet të veprojnë ashtu siç e shohin vetë të nevojshme.

II. Në mbledhjen e dytë të Kuvendit CVII, para fillimit të shqyrtimit të pikave të rendit të ditës kryetari Kraja paraqiti fjalën hyrëse, si në vijim:

“Të nderuar akademikë, miq dhe kolegë!

Më lejoni t’ju them se gjatë muajve të shkuar, që nga Kuvendi pararendës, marrë në përgjithësi, ne kemi arritur t’i realizojmë objektivat tona kryesore, me aktivitete të ndryshme shkencore dhe artistike, me prezantime botimesh, me konferenca dhe me forma të tjera të punës sonë në vazhdimësi.

Është e radhës të them se Akademia, edhe më shumë se kaq, duhet të bëhet referencë për një prani më të madhe në jetën publike, veçmas kur bëhet fjalë për arritjet më të larta në fushën e shkencës dhe të arteve.

Në këtë pikë mund të them se është arritur një përparim i ndjeshëm, vetëm se disa nga aktivitetet e fundit kanë shtruar nevojën për një kujdes të shtuar, në mënyrë që këto aktivitete publike të mos marrin kuptimin e animit në një krah ose në një krah tjetër politik dhe partiak.

Tani më duhet të them se në fushën e botimit, duke marrë parasysht programin e punës për vitin 2022, ka një ngecje në

kuptimin e dorëzimit të veprave për shtyp, dhe kjo na nxit të mos jemi neglizhentë në tre-katër muajt vijues, në mënyrë që plani botues i Akademisë për vitin 2022 të realizohet i plotë, pa ngecje dhe vonesa të mëdha. Meqë e kemi fjalën te botimet, besoj se në të ardhmen do të duhej të zhvillojmë një diskutim të gjerë, veçmas nëpër seksione, për mënyrën si duhet përfshirë në planin tonë botues veprat e autorëve nga jashtë Akademisë, meqë kjo mënyrë siç e kemi tani lë hapësirë për proteksionizëm dhe subjektivizëm. Gjithashtu, duhet të diskutohet gjerësisht profili i botimeve tona, siç është publikimi i lëndës arkivore, sikundër edhe vetë relevanca e disa projekteve që iu shërbejnë autorëve, por nuk kanë impakt në prestigjin e Akademisë.

Më lejoni të them me këtë rast, se që një kohë relativisht të gjatë, veçmas që nga muaji shtator i vitit të kaluar, kur ka skaduar kontrata me operatorin e përparshëm, kemi bërë përpjekje të pareshtura për ta ridizajnuar dhe për ta bërë më funksionale ueb-faqen e Akademisë, e cila pothuajse asnjëherë nuk ka arritur të marrë një formë të përshtatshme dhe të funksionojë si duhet. Përveç që i është ndryshuar forma dhe dizajni, me vendim të Kryesisë është përcaktuar si obligim i nënkryetares që të marrë nën përkujdesje ueb-in, ndërsa sekretarët e seksioneve kanë marrë përsipër që t'i prezantojnë aktivitetet e seksioneve me dinamikën e zhvillimeve që ndodhin. Mbetet që faja të pasurohet në të ardhmen me vegëzat përkatëse, ku do të përfshihen projektet, botimet dhe revistat, pastaj edhe me vegëzat që mundësojnë leximin e librave ose të punimeve shkencore të anëtarëve të Akademisë, sipas dëshirës dhe vullnetit të tyre.

Një çështje tjetër, që në mënyrë të tërthortë lidhet me këtë problematikë, është paraqitja e në formë digjitale e Fjalorit Enciklopedik të Kosovës. Është marrë një vendim në Kryesi që, pasi të bëhen korrigjimet elementare dhe disa plotësime të domosdoshme, Fjalori të ketë mundësi të shfletohet në ueb-faqen e Akademisë, mirëpo kjo ka dalë e vështirë të realizohet, për shkak të refuzimit të disa redaktorëve, brenda dhe jashtë Akademisë, që të përfshihen në korrigjimet e zërave dhe të lëndës leksikografike.

Gjithashtu duhet të them këtu se Kryesia ka marrë edhe disa vendime që besojmë të ndikojnë në mbarëvajtjen e punëve të Akademisë, të cilat duhet t'i bëj të ditura shkurtimisht: Akademia nuk do të blejë më laptopa, por do të investojë suksesivisht në mirëmbajtjen dhe avancimin e kompjuterëve të zyrave, sepse është vërejtur se pajisja e anëtarëve të Akademisë më kompjuterë portabël është bërë pa ndonjë sistem, madje në mënyrë jo aq të drejtë, prandaj është vendosur që kjo praktikë të ndërpritet.

Lidhur me udhëtimet jashtë vendit, kam obligim t'ju njoftoj sa vijon: pothuajse të gjithë anëtarët e Akademisë marrin ftesa të vazhdueshme për udhëtime, kryesisht për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme shkencore, që mbahen në fushat përkatëse. Tani e tutje, për të vendosur një rend në këtë drejtim, për udhëtimet e këtilla jashtë vendit të anëtarëve të Akademisë duhet të vendosë Kryesia e Akademisë apo, varësisht nga natyra e ftesës, Këshilli për Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Dy fjalë për Bibliotekën e Akademisë. Ne kemi menduar dhe kemi biseduar në Kryesi, se Biblioteka e Akademisë duhet ndryshojë formën e deritashme të punës dhe, përveç që duhet të mbledhë, te

sistemojë botimet tona dhe botimet e anëtarëve të Akademisë, duhet specializohet në drejtim të grumbullimit dhe sistemimit të librave për Kosovën dhe albanologjinë. Pra, të mos mbledhë dhe të mos blejë më libra me një dedikim të përgjithshëm, qoftë shkencor, qoftë artistik, sepse një grumbullim i tillë i librit nuk paraqet interes për institucionin dhe nuk është funksional. Paralelisht me këtë, Kryesia ka marrë vendim që Biblioteka e Akademisë të mos pranojë më librin e falur, nga kushdo që vjen, pa një paraqitje të listës së librave të tillë dhe pa një vendim përkatës të Kryesisë.

Çështja e fundit, të cilën dua të shtroj para jush, ka të bëjë me Enciklopedinë Shqiptare. Besoj se jeni në dijeni se para disa ditësh dy qeveritë, e Republikës së Kosovës dhe e Republikës së Shqipërisë kanë nënshkruar marrëveshje për bashkëfinancim të projektit të përbashkët të Enciklopedisë Shqiptare. Iniciues të marrëveshjes kanë qenë Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Qeveria e Shqipërisë. Para se të nënshkruhej marrëveshja nga Akademia e Shqipërisë ne kemi marrë draftin e propozuar, të cilin, bashkë me platformën tonë ia kemi vënë në dispozicion kabinetit të kryeministrit të Kosovës përmes një këshilltareje të dërguar prej tij. Duke qenë se marrëveshja e nënshkruar na është vënë në dispozicion me vonesë dhe duke qenë se ende nuk janë qartësuar një sërë çështjesh konceptuale dhe organizative për Enciklopedinë Shqiptare (marrëveshja hyn në fuqi nga fillimi i vitit 2023), në Kryesi e kemi prezantuar mundësinë që në tetor të këtij viti të mbahet një mbledhje e veçantë e Kuvendit të Akademisë, në të cilën do të diskutoheshin dokumentet përfundimtare për këtë projekt: Platforma e ASHAK-ut për Enciklopedinë, marrëveshja e dy qeverive, rregullorja e punës dhe çështje të tjera që lidhen me këtë projekt të

rëndësishëm. Tani për tani mund t'ju them, se ne kemi kërkuar që financimi i Enciklopedisë të bëhet ndaras nga financimi i rregullt dhe i programit të punës së Akademisë, gjë që ka hasur në mirëkuptim të Ministrisë së Financave, por është kërkuar që menaxhimi financiar të bëhet nga Akademia, në përputhje me ligjet në fuqi. Meqë në këtë kohë bëhet planifikimi buxhetor për vitin vijues, ne po përpiqemi të analizojmë kërkesat reale financiare për vitin e parë të realizimit të këtij projekti, duke respektuar të gjitha normat dhe parashikimet adekuate financiare. Për të gjitha çështjet rreth këtij projekti anëtarësia e gjerë e Akademisë do të jetë e informuar në mënyrë periodike, sipas rregulloreve tona dhe mënyrës që e përcaktojnë organet vendimmarrëse të Akademisë.

Ju faleminderit!”

Ai më pas e njoftoi Kuvendin se në materialet e kësaj mbledhjeje janë përfshirë dy procesverbale, njëri i mbledhjes CV dhe tjetri i mbledhjes CVI. Procesverbali i mbledhjes CV është miratuar nga Kuvendi, me kërkesë që të plotësohet dhe sot e keni përpara të plotësuar, ndërsa procesverbali i mbledhjes CVI tani paraqitet për miratim. Ai e hapi diskutimin, diskutime nuk pati dhe procesverbali i mbledhjes CVI u miratua pa vërejtje me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Kuvendit, me përjashtim të R. Dhomit.

Kuvendi e shqyrtoi Programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2023. Kryetari Kraja tha se përgatitjet për Programin e punës për vitin 2023 kanë filluar me kohë, janë mbajtur nga dy mbledhje të seksioneve. Programi është shqyrtuar edhe nga Kryesia e Akademisë dhe sot jemi këtu për ta miratuar. Ai filloi paraqitjen e programit me rend sipas seksioneve dhe tha se nëse sekretarët e seksioneve kanë ndonjë

plotësim eventual mund ta paraqesin edhe tani. Programi i punës së ASHAK-ut, për vitin 2023 u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.

Programi i punës së ASHAK-ut për vitin 2023 do të botohet në revistën Vjetari 2023.

Në vazhdim Kuvendi i shqyrtoi rregulloret: Rregullorja për projekte shkencore dhe Rregullorja për organizimin e aktiviteteve shkencore. Kryetari Kraja kërkoi nga J.Sh. Pula, kryesuese e grupit punues për hartimin e rregulloreve që të njoftojë Kuvendim me rrjedhën e punës. J. Sh. Pula njoftoi se grupi punues i ka hartuar draftet e para të rregulloreve, të cilat u janë dërguar të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe u janë lënë në dispozicion për një kohë për të paraqitur vërejtje dhe sugjerime eventuale. Draftet e rregulloreve janë shqyrtuar edhe nëpër seksione. Pas shqyrtimit të tyre kemi pranuar disa vërejtje dhe sugjerime dhe shumicën prej tyre i kemi përfshirë në draftet e fundit që sot do t'i shqyrtojmë. Disa plotësime që janë paraqitur pas shpërndarjes së materialeve të Kuvendit i kemi shqyrtuar po ashtu dhe kemi konstatuar se shumica janë përfshirë.

Rregullorja për projekte shkencore u miratua pa vërejtje me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Kuvendit, me përjashtim të R. Dhomit.

Gjatë shqyrtimit të Rregullores për organizimin e aktiviteteve shkencore, S. Gashi dhe J. Bajraktari propozuan që simpoziumet shkencore të renditen pas konferencave shkencore, ashtu që nenit 3 dhe 4 t'u ndërrohet vendi.

Propozimi u përkrah dhe Rregullorja për organizimin e aktiviteteve shkencore u miratua me plotësimin e lartcekur, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.

III. Mbledhja e tretë (CVIII) e Kuvendit ishte mbledhje e jashtëzakonshme. Kryetari Kraja fillimisht tha:

“Të nderuar kolegë, ju dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Akademisë!

Sikundër që tashmë jeni në dijeni, që në mbledhjen e rregullt të Kuvendit në qershor, ne jemi marrë vesh ta mbajmë këtë mbledhje, për të shqyrtuar dokumentet dhe strukturat organizative, që kanë të bëjnë me Enciklopedinë shqiptare.

Projekti është i një rëndësie të veçantë dhe në këtë kuadër, Akademia merr një përgjegjësi shtesë, për të realizuar një ndërmarrje me një peshë të veçantë në fushën e dijes dhe të shkencës.

Ashtu sikundër edhe ndonjë herë tjetër, nismën për këtë projekt e ka marrë Akademia e Shkencave e Shqipërisë, me një ndryshim se kësaj herë koordinimi ndërmjet dy akademive ka qenë më i mirë, më i plotë dhe, që ka më shumë rëndësi, projekti ka gjetur mbështetjen e dy qeverive, të Kosovës dhe të Shqipërisë.

Tani mund t'ju them se kjo fazë përgatitore, për të arritur në këtë pikë ku jemi tani, me qëndrime të harmonizuara për të gjitha çështjet kryesore, ka zgjatur më shumë se dy vjet.

Harmonizimi i qëndrimeve dhe pikëpamjeve në këtë fazë ka qenë i domosdoshëm, sepse nuk është fshehtësi se kemi koncepte, ide dhe përvoja të ndryshme lidhur me shumë çështje që kanë të bëjnë me dijen enciklopedike dhe me mënyrën e përfshirjes së saj në një vepër të përbashkët.

Tani ju keni përpara dy dokumente, që përbëjnë bazën kryesore të konceptit dhe të mënyrës së punës në hartimin e Enciklopedisë shqiptare, Platformën e

përbashkët dhe Rregulloren për mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të Redaksisë Qendrore, të redaksive vendore dhe të redaksive të fushave të Enciklopedisë shqiptare.

Bashkëngjitur iu kemi vënë në dispozicion edhe propozimin e seksioneve për nga dy anëtarë të Redaksisë vendore, gjithsej tetë, pesë nga të cilët, përfshirë edhe kryeredaktorin, do të përfaqësojnë Akademinë në Redaksinë Qendrore të Enciklopedisë.

Gjithashtu ju kemi vënë në dispozicion propozimin e një Këshilli të ngritur nga Kryesia për kandidatin e mundshëm të kryeredaktorit të Enciklopedisë. Menjëherë më duhet t'ju them se ky Këshill ad hoc u ngrit nga Kryesia, sapo u vu në diskutim një konflikt i mundshëm interesi që Kryesia të bënte propozimin për kryeredaktorin e Enciklopedisë, i cili në këtë rast qëlloi të ishte edhe kryetar i Akademisë. Meqë mori miratimin e Kryesisë, ky Këshill, i përbërë nga përfaqësuesit e të gjithë seksioneve, në të ardhmen do të marrë rolin e një mbikëqyrësi të punëve të përgjithshme rreth Enciklopedisë.

Bashkë me këto dokumente ju kemi vënë në dispozicion edhe marrëveshjen e dy qeverive, të Kosovës dhe të Shqipërisë, në hartimin e së cilës, më duhet t'ju them, ne nuk kemi marrë pjesë, prandaj ndonjë "shkarje" që është vërejtur në Marrëveshje, mund të jetë korrigjuar me Platformën ose me Rregulloren.

Kemi punuar gjatë për t'i harmonizuar këto dokumente, dhe tani që i kemi përpara, duhet ta merrni parasysh se bëhet fjalë për dy shtete, për dy subjekte institucionale, për dy akademi që përfshihen në një projekt të përbashkët: dy shtete që kanë legjislacion të ndryshëm, dy institucione që kanë specifikat e tyre, dy akademi që kanë

subjektivitet të veçantë legjislativ dhe institucional.

Edhe me këtë rast, më lejoni të tërheq vëmendjen tuaj, se bëhet fjalë për Platformë të përbashkët, të harmonizuar tërësisht midis dy palëve dhe për Rregullore, zbatimi i së cilës do të nisë që në fillim të vitit të ardhshëm nga të dy palët bartëse të projektit.

Në fund, më lejoni t'ju them se ndërkohë, bashkë me Akademinë e Shqipërisë, kemi hartuar Protokollin e përbashkët financiar, i cili do të nënshkruhet nga dy ministret e arsimit dhe shkencës, të autorizuar nga qeveritë përkatëse.

Me miratimin e këtyre dokumenteve në këtë Kuvend dhe me nënshkrimin e Protokollit të përbashkët nga ministritë mund të konsiderohet e përmbyllur faza e parë, faza përgatitore e realizimit të projektit Enciklopedia shqiptare.

Ju faleminderit!"

Më pas filloi shqyrtimi i pikave të rendit të ditës. Diskutoi J. Bajraktari dhe tha se ka vërejtje për diskutimin e kryetarit Kraja, faqja 1 e procesverbalit, paragrafi 3 dhe faqja 2, fundi i paragrafit 1. Ai tha se nuk i takon Kryetarit të përzihet në punën e seksioneve, siç ka ndodhur te SSHSH duke bërë pengesa dhe se diskutimi i tillë bart subjektivizëm të theksuar. Ai po ashtu tha se paraqitja publike e fundit e Kryetarit nuk i bën nder as SSHSH e as Akademisë.

Pas diskutimit të J. Bajraktarit, meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetari Kraja propozoi që diskutimi i J. Bajraktarit të përfshihet në procesverbalin e kësaj mbledhjeje dhe e paraqiti për miratim procesverbalin.

Propozimi u miratua njëzëri dhe procesverbali i mbledhjes CVII të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Kuvendi e shqyrtoi Platformën e përbashkët (ASHAK-ASHSH) për

Enciklopedinë shqiptare. Kryetari Kraja e njoftoi Kuvendin se Platforma është shqyrtuar nëpër seksione, janë marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet dhe sot e kemi për diskutim dhe miratim. H. Islami në diskutimin e tij paraqiti disa vërejtje si në vijim:

Tha se ka pritur që me materiale të Kuvendit anëtarëve të Akademisë t'u vihet në dispozicion edhe Marrëveshja e dy qeverive, por kjo nuk ka ndodhur. Ka pritur që t'i bëhet me dije Kuvendit që vërejtjet dhe sugjerimet më kryesore, që tani më janë në Platformë, janë propozuar pikërisht nga SSHSH. Këshilli i Enciklopedisë është propozuar pikërisht nga SSHSH dhe është propozim me vend, sepse Kryetari i Akademisë nuk mund të jetë në krye çdokund. Duhet të definohet pse projekti quhet "Projekt madhor në albanologji"; tha se ky Kuvend nuk është dashur të quhet i jashtëzakonshëm, sepse nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Kuvend të jashtëzakonshëm Akademia ka mbajtur vetëm një herë. Ky nuk është rast i rrallë, meqë ky projekt ka qenë për vite të tëra në programin e punës së Akademisë, ka pasur shumë entuziazëm edhe atëherë, por nuk kanë ecur punët, sepse ka munguar gatishmëria nga ana e ASHSH-së. H. Islami më pas tha se është mirë që tani ka gatishmëri nga qeveritë dhe ASHSH-ja, por se ky është projekt madhor dhe në të nuk punojnë grupet, por punojnë breza të tërë, dhe se nuk e kupton këtë nguti e cila duket shumë populiste. Ne e kemi bërë Fjalorin Enciklopedik pa pasur ndonjë përvojë të madhe dhe ia kemi arritur. Ai po ashtu bëri vërejtje që Rregullorja nuk ka kaluar për shqyrtim nëpër seksione, sepse duhet të dihet kush e ka hartuar atë dhe në fund tha se puna në projekt kërkon mbështetje administrative, prandaj duhet ta aktivizojmë QLE-në, të angazhojmë njerëz, dhe për këtë duhet të kërkohen

mjetet financiare, se pa to nuk mund të ketë punë efektive.

Lidhur me vërejtjet dhe pyetjet e H. Islamit, diskutoi M. Kraja. Ai tha se Marrëveshja e dy qeverive nuk u është ndarë anëtarëve të Akademisë, meqë nuk është dokument i ASHAK-ut, nuk jemi pyetur për të, na ka ardhur i gatshëm dhe nuk kemi pasur pse ta diskutojmë. Sa i përket asaj që propozimet kanë dalë nga SSHSH, ai tha se, që në fillim njoftoi se janë marrë parasysh propozimet e seksioneve dhe se Këshilli i Enciklopedisë është ngritur sipas propozimit të bërë. Emërtimi *projekt* në albanologji është rregulluar në Platformë. Është vendosur nga Kryesia të thirret Kuvend i jashtëzakonshëm për shkak të afateve kohore, sepse këto dokumente, sipas Marrëveshjes së qeverive duhet të dorëzohen më 31 tetor dhe nuk kemi pasur në dispozicion 15 ditë për ta thirrur Kuvendin e rregullt; Platforma është hartuar nga grupi punues, anëtarët e të cilit janë caktuar nga seksionet. Emrat e grupit sipas kërkesës së SSHSH janë përfshirë në Platformë. Ai tha se e ka bërë draftin e Platformës dhe më pas të njëjtin e ka diskutuar me të gjithë anëtarët e grupit. Përpos S. Hamitit që kanë punuar bashkë, nga anëtarët e tjerë të grupit ka marrë mbështetje që ta procedojë tutje; Sa i përket Rregullores ai tha se është hartuar nga grupet punuese të dy akademive (grupi i ASHAK –ut është caktuar nga Kryesia) dhe është në përputhje me Platformën. Nëpër seksione nuk kemi arritur ta kalojmë për shkak të afateve kohore; Dhe në fund për punën e QLE-së M. Kraja tha se nuk mund të hapim njësi të reja, por do të angazhojmë ekspertë shkencorë dhe me punët administrative do të merret administrata e Akademisë.

Në vazhdim diskutuan N. Daci, A. K. Berishaj, S. Hamiti, Z. Rrahmani dhe R. Ismajli.

N. Daci në diskutimin e tij tha se e përkrah projektin e Enciklopedisë Shqiptare dhe se edhe ai vetë në kohën sa ishte Kryetar i Akademisë ka realizuar takime me ASHSH-në për fillimin e këtij projekti. Ai po ashtu përmendi vështirësitë që kanë pasur në të kaluarën dhe përmendi kontributin e madh e të çmuar që H. Islami kishte dhënë në atë kohë, por siç tha ai atëherë ka munguar gatishmëria nga ASHSH-ja. Tani vazhdoi ai, ka gatishmëri dhe ne bashkërisht do t'ia dalim, ashtu siç ia kemi dalë edhe me Fjalorin Enciklopedik. N. Daci e inkurajoi M. Krajën që ta shtyjë përpara projektin dhe e përgëzoi për punën e bërë në këtë fazë. A. K. Berishaj tha se në Platformë figuron emri i tij, por se ai nuk ka marrë pjesë në asnjë takim për hartimin e saj, si anëtar i grupit. Me këtë rast ndërhyri M. Kraja dhe tha se dokumentet e kësaj natyre nuk mund të punohen njëkohësisht nga disa persona. Ai tha se e ka hartuar draftin e Platformës të cilin ua ka ndarë anëtarëve të grupit dhe me të gjithë ka pasur takim për diskutimin e saj në zyrën e tij. Nga të gjithë (N. Daci, R. Dhomi, A. K. Berishaj) ka marrë miratimin, më pas ka punuar në Platformë dhe e ka finalizuar atë bashkë me S. Hamitin.

Më pas diskutoi S. Hamiti i cili tha se kanë qenë katër veta në grup, nga secili seksion nga një. Unë kam qenë në atë grup, kam punuar dhe jam shumë i kënaqur me punën që është bërë dhe me tekstin e Platformës. Pra kush ka dashur të punojë ka punuar, të tjerët e kanë pranuar dhe i falënderoj.

Z. Rrahmani në diskutimin e tij tha se u diskutua çështja e Kuvendit të jashtëzakonshëm, por se tani po dalin edhe gjëra të jashtëzakonshme. Po del

Marrëveshja e qeverive, po del që QLE-nuk mund të funksionalizohet, sepse nuk ka mjete financiare për të. Duhet të kërkohej mjete financiare. Pajtohet me H. Islamin se nuk është dashur të ketë nguti. Ai po ashtu paraqiti vërejtje se pse selia të jetë vetëm në Tiranë, kur ka mundur të bëhet atje dhe këtu në Prishtinë dhe dokumentacioni të ruhet këtu dhe atje. Ai në fund paraqiti edhe disa vërejtje për Rregulloren.

Pas diskutimit të Z. Rrahmanit, M. Kraja tha se për punën emërtimit të mbledhjes së Kuvendit dhe për punën e QLE-së u dhanë sqarimet më parë, ndërsa sa i përket çështjes së selisë ajo mbetet vetëm në Tiranë, nuk mund të ketë dy seli, sepse nisma ka dalë nga ata, ndërsa dokumentacioni do të ruhet njëjtë në të dy akademitë. Lidhur me vërejtjet për Rregulloren, ai tha se Platforma është ajo që përcakton parimet, ndërsa Rregullorja i saktëson gjërat.

Diskutoi më pas R. Ismajli, i cili tha se ka qenë i kyçur edhe në të kaluarën për punën e Enciklopedisë Shqiptare dhe ka përvojë. Në të kaluarën nuk ka pasur bashkëpunim, shpresoj që tani do të jetë ndryshe. Ne kemi vullnet për punë, por duhet të jemi të kujdesshëm që mos të dështojmë, sepse kërkohet shumë punë dhe mund të vijmë në situatë të merremi vetëm me Enciklopedi dhe t'i lëmë anash punët e tjera. R. Ismajli në vazhdim tha se Qeveria ka dhënë urdhër, por tani duhet të japë edhe mjete financiare.

Në fund ai tha se dokumentacioni duhet të ruhet patjetër në Tiranë dhe në Prishtinë.

Pas diskutimeve, Kuvendi me shumicë votash dhe tri abstenime (H. Islami, Z. Rrahmani dhe A. K. Berishaj) e miratoi Platformën e përbashkët (ASHAK-ASHSH) për Enciklopedinë shqiptare.

Në vazhdim u shqyrtua Rregullorja për mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të

Redaksisë qendrore, të redaksive vendore dhe të redaksive të fushave të Enciklopedisë Shqiptare. Kryetari Kraja paraqiti në pika të shkurtra rrjedhën e punës në rregullore. Ai tha se rregullorja ka qenë kërkesë e Marrëveshjes ndërqeveritare. Është hartuar bashkë me ASHSH-në dhe se nuk ka qenë e lehtë të hartohet, marrë parasysh që jemi dy institucione dhe dy shtete me specifika të ndryshme.

Ai e hapi diskutimin dhe meqë diskutime nuk pati, rregullorja u paraqit për miratim. Ajo u miratua unanimisht nga Kuvendi.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kuvendi u njoftua me propozimet e strukturave redaksionale të Enciklopedisë Shqiptare.

Kryetari Kraja e njoftoi Kuvendin se propozimet për anëtarët e Redaksisë qendrore dhe Redaksisë vendore janë paraqitur nga seksionet e ASHAK-ut, ndërsa propozimi për Kryeredaktorin/drejtuesin i është paraqitur Kryesisë nga Këshilli i Enciklopedisë dhe Kryesia e ka proceduar për miratim në Kuvend.

Ai tha po ashtu se seksionet i kanë paraqitur propozimet për Redaksi qendrore dhe atë vendore, pos Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë që i ka paraqitur dy emra, pa bërë ndarjen e tyre sipas redaksive. Lidhur me këtë çështje S. Hamiti propozoi R. Ismajlin për anëtar të Redaksisë Qendrore.

Në diskutimin e tij H. Islami, tha se pajtohet me emrat e propozuar, por tërhoqi vërejtjen se disa nga emrat e propozuar janë anëtarë të Kryesisë dhe mund të kenë angazhime të shtuara. Kryetari Kraja tha se propozimet janë të seksioneve dhe se duhet respektuar.

Më pas Kuvendi unanimisht mori vendim për zgjedhjen e strukturave redaksionale,

Redaksia vendore dhe Redaksia qendrore e Kosovës (ASHAK-ut) për projektin shkencor Enciklopedia Shqiptare, si në vijim:

Redaksia vendore:

1. Akademik Mehmet Kraja
Kryeredaktor/drejtues
2. Akademik Rexhep Ismajli
3. Akademik Jusuf Bajraktari
4. Akademik Nexhat Daci
5. Akademik Rauf Dhomi
6. Akademik Sabri Hamiti
7. Akademik Anton K. Berishaj
8. Akademik Fejzullah Krasniqi
9. Anëtar korrespondent Luan Mulliqi

U tha që anëtarët e Redaksisë vendore, akademikët: Mehmet Kraja, Rexhep Ismajli, Jusuf Bajraktari, Nexhat Daci dhe Rauf Dhomi do të përfshihen (janë anëtarë) të Redaksisë qendrore.

KRYESIA

Gjatë vitit 2022 Kryesia e Akademisë ka organizuar këto aktivitete:

- Pas botimit me propozim të Kryesisë, të librit "Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për Kosovën" është bërë paraqitja e botimit, më 14 prill në mjediset e Akademisë.

- Bazuar në protokollin e bashkëpunimit ASHAK-ASHSH 2022-2023, më 21-25 prill është organizuar Panairi i botimeve akademike-shkencore, aktivitet i përbashkët i dy akademive, ASHAK dhe ASHSH.

- Në mjediset e Akademisë, më 28 shtator është bërë paraqitja e botimeve dhe e dokumenteve për Çamërinë.

Kryesia e Akademisë gjatë vitit 2022 ka mbajtur 24 mbledhje (I -XXIV) në të cilat është marrë me shqyrtimin e çështjeve, duke u bazuar në kompetencat e parapara me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera normative të Akademisë.

I. Kryesia në mbledhjen e parë të vitit 2022, mbajtur më 11 janar pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse e shqyrtoi raportin e punës së profesor Nebi Cakës, për kryerjen e punëve në QLE. Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë së Prof. Cakës i përfundon kontrata më 15 janar 2022. Ai tha se është kërkuar nga Prof. Caka që deri në përfundim të kontratës ta përmbushë edhe detyrën e paraparë në nenin 1, pikën 3 të kontratës:

“ Të bëhen bashkë leksiku i vjelë nga Fjalori i Sokol Dobroshit, leksiku i nxjerrë nga Përparimi dhe leksiku i nxjerrë nga Jeta e Re” dhe ta plotësojë raportin e punës edhe me këtë pikë.

Më pas u shqyrtua kërkesa e akademik Rexhep Ismajlit për realizimin e pagesës për sekretaren e Këshillit organizues të Konferencës shkencore ndërkombëtare “Studimet për shqiptarët në Francë” dhe u vendos të realizohet pagesa. U tha që herëve të tjera në raste të angazhimeve të tilla, kërkesat të parashihen para nisjes së aktiviteteve.

Kryesia e shqyrtoi edhe letrën e akademik Hivzi Islamit, nr. 1056, dt. 14.12.2021. Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se H. Islami e ka dorëzuar letrën më 14 dhjetor para mbledhjes së Kryesisë e cila ishte caktuar ditë më parë të mbahet pikërisht më 14 dhjetor. Letra është shqyrtuar po atë ditë në mbledhjen e Kryesisë dhe më pas H. Islamit i është kthyer një

përgjigje me konstatimin e se: “Kryesia e mori në dijeni letrën e akademik Hivzi Islamit (nr. 1056, dt. 14.12.2021) dhe konsideroi se Shërbimi profesional i Akademisë nuk ka arsye ta bëjë shpërndarjen e saj, duke qenë se bëhet fjalë për një letër personale, ndërsa përmbajtja e saj do të shqyrtohet në Kryesinë me përbërje të re, në një nga mbledhjet e radhës”.

Ai më pas tha se sot e keni përpara një propozim të plotë për përgjigjen në letrën e H. Islamit dhe i ftoi të gjithë anëtarët të paraqesin mendimet e tyre lidhur me propozimin.

Diskutuan të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe pas diskutimeve u tha që të hartohet një draft përgjigje duke u bazuar në aktet normative të ASHAK-ut dhe në bazë të vendimit të Kuvendit zgjedhor të Akademisë, dhe se kjo çështje të shtyhet për shqyrtim në një mbledhje të radhës të Kryesisë së Akademisë.

Në vazhdim kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se me kalimin e kohës është konsideruar e nevojshme të plotësohen rregulloret e ASHAK-ut: Rregullorja për veprimtarinë botuese dhe Rregullorja për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese dhe për këtë arsye Kryesia e Akademisë ka ngritur grupin punues i cili ka bërë disa plotësime në këto rregullore.

Draftet e tyre u janë ndarë të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe tani sekretarët e seksioneve duhet të mbajnë mbledhjet e seksioneve dhe të shqyrtojnë draftet e rregulloreve, ashtu që të merren vërejtjet dhe sugjerimet për plotësimet e tjera të nevojshme të tyre.

Pas shqyrtimit nëpër seksione rregulloret do t'i shqyrtojë edhe një herë grupi punues, i cili do të bëjë

plotësimin e tyre, nëse ka nevojë. Draftet e fundit do t'i shqyrtojë Kryesia e Akademisë dhe në fund shqyrtimin dhe miratimin përfundimtar të tyre do ta bëjë Kuvendi i Akademisë.

Ai kërkoi nga sekretarët e seksioneve që më së largu deri më 28 janar të mbajnë mbledhjet e seksioneve në të cilat do t'i shqyrtojnë rregulloret dhe do t'i shqyrtojnë e miratojnë edhe raportet e punës së seksioneve për vitin 2021.

Kryetari Kraja kërkoi që Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë të diskutojë në mbledhje të Seksionit për mbajtjen e Konferencës shkencore mbarëkombëtare në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit (1972-2022). Kjo konferencë është e paraparë në Protokollin e bashkëpunimit ASHAK-ASHSH 2020-2022, si aktivitet i përbashkët e dy akademive, por nuk është përfshirë në programin e punës së Seksionit të GJL për vitin 2022.

Për çështjen e rregulloreve S. Hamiti kërkoi që anëtarët e Akademisë të kenë shënime plotësuese për plotësimet dhe ndryshimet në rregullore, sepse nga ato që kanë marrë nuk vërehen plotësimet dhe ndryshimet.

Kryetari Kraja kërkoi nga L. Pula të merret me çështjen në fjalë, ashtu që sa më parë të bëhet njoftimi i nevojshëm për plotësimet dhe ndryshimet dhe t'u dërgohet anëtarëve të Akademisë.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

a) Caktoi Komisionin për blerjen e veprave artistike me këtë përbërje:

Luan Mulliqi, kryetar dhe Justina SH. Pula, Xhevdet Xhafa, Nysret Krasniqi e Myzafere Limani, anëtarë;

b) U njoftua me propozimin e Kryetarit Kraja që për nder të 17 shkurtit, ditës së pavarësisë së Republikës së Kosovës, në ambientet e Akademisë, më 16 shkurt të mbahet një koncert festiv me vepra të akademik Zeqirja Ballatës. Koncerti në fjalë ka qenë i paraparë të mbahet në vitin 2020, por për shkak të rrethanave pandemike nuk ka arritur të mbahet. Propozimi i Kryetari u miratua njëzëri dhe u tha që R. Dhomi, L. Mulliqi dhe L. Pula të fillojnë menjëherë përgatitjet për mbajtjen e koncertit;

c) E miratoi propozimin e Kryetarit dhe mori vendim që faqja web e ASHAK-ut të plotësohet në vazhdimësi me aktivitetet e secilit seksion. Sekretarët e seksioneve pas çdo aktiviteti të hartojnë tekstin të cilin ia përcjellin zyrtarit të administratës për publikim. Ky proces të udhëhiqet dhe të mbikëqyret nga nënkryetarja e Akademisë;

d) Vendosi që F. Podvorica të caktohet në cilësinë e njësisë kërkuese për hartimin e specifikave teknike për nisjen e aktivitetit të prokurimit: Shtypja botimeve të ASHAK-ut 2022.

e) U njoftua nga kryetari Kraja për analizën: "Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor". Ai tha se dokumenti tani më u është ndarë anëtarëve të Kryesisë dhe se pret vërejtjet apo sugjerimet eventuale me shkrim nga secili anëtar. Më pas ai kërkoi mendimin e Kryesisë për shpërndarjen apo jo të këtij dokumenti për shqyrtim dhe miratim nga anëtarët e Akademisë.

S. Hamiti propozoi që ky dokument të trajtohet në një mbledhje të radhës. Propozimi u miratua nga Kryesia.

Njëherësh, në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës S. Hamiti propozoi që

të hartohet një rregullore për punën në projekte. Kryetari Kraja tha se pajtohet me propozimin, por tha që fillimisht S. Hamiti të paraqesë propozimet e tij lidhur me projektin: “ Historia e letërsisë shqipe” në mënyrë që të vazhdojë puna e papenguar rreth projektit në fjalë, kurse hartimi i rregullores në fjalë të iniciohet sipas rregullave të ASHAK-ut.

II. Në mbledhjen e mbajtur më 17 janar, Kryesia e shqyrtoi analizën : Synimet destabilizuese të Serbisë në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor. Kryetari Kraja autor i saj, tha se këtë analizë tani më e keni pasur në dispozicion për ta lexuar dhe paraqitur vërejtje e sugjerime eventuale. Nëse Kryesia pajtohet analizën do t’ua dërgojmë të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe do t’ua lëmë në dispozicion për një kohë, ashtu që të kenë mundësi të paraqesin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre me shkrim. Më pas si Kryesi do t’i shqyrtojmë të gjitha propozimet e anëtarëve të Akademisë dhe analizën finale do ta publikojmë.

Diskutuan të gjithë anëtarët e Kryesisë. J. SH. Pula, tha se e ka lexuar analizën, e përkrah si iniciativë dhe se Kryetarit ia ka përcjellë disa sugjerime. L. Mulliqi e R. Dhomi thanë së pajtohen në plotni. S. Hamiti tha se analiza është politike dhe ka karakter të reagimit. Akademia si institucion mund të ofrojë tekst në trajtë të studimit i cili duhet të botohet edhe në gjuhën angleze. Gj. Mushkolaj dhe F. Podvorica, po ashtu thanë se e përkrahin iniciativën dhe analizën e hartuar, por që të dy thanë se duhet të plotësohet me referenca.

Pas diskutimeve kryetari Kraja tha se i mirëpret vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të Kryesisë dhe kërkoi që ato

t’i paraqesin me shkrim, por tha se është i gatshëm edhe të takohen, t’i dëgjojë propozimet dhe së bashku t’i përfshijnë në tekst.

U tha që analiza të plotësohet me vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të Kryesisë dhe më pas t’u dërgohet të gjithë anëtarëve të Akademisë. Kryetari Kraja tha se nëse analiza përkrahet nga shumica e anëtarëve të Akademisë më pas do të vendoset në Kryesi për mënyrën e publikimit të saj.

Në vazhdim Kryesia e shqyrtoi përgjigjen në letrën e akademik Hivzi Islamit, nr. 1056, dt. 14.12.2021, si në vijim:

“AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Kryesia

Prishtinë, 17 janar 2022

Përgjigje e Kryesisë së Akademisë në letrën e akademik Hivzi Islamit, Nr. 1056, dt. 14.12.2021.

Më 17 janar 2022, Kryesia e Akademisë e ka shqyrtuar letrën e akademik Hivzi Islamit dhe ka konstatuar si vijon:

1. Kërkesa e akademik Hivzi Islamit për caktimin e “shkallës së përgjegjësive” për sekretaren e Akademisë nuk ka bazë ligjore dhe statutare .
2. Zgjedhja e Sekretarit shkencor nga Kuvendi i Akademisë më 9 dhjetor 2021 është në përputhje të plotë me Statutin e Akademisë. Statuti i Akademisë, neni 31, paragrafi 7, precizon se: “Kryesia e Akademisë zgjidhet për një periudhë katërvjeçare (4) me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër”.

Kjo nënkupton jo zgjedhje më shumë se dy herë radhazi në të njëjtën detyrë dhe në të njëjtin funksion.

3. Seksioni i arteve e ka caktuar Rauf Dhomin ushtrues të detyrës së Sekretarit për periudhën 4 -vjeçare, por pas diskutimeve dhe vendimit të Kuvendit zgjedhor të Akademisë, Rauf Dhomi është caktuar ushtrues i detyrës së Sekretarit të Seksionit të Arteve për periudhën 6 mujore. Më pas i është lënë Seksionit të caktojë çdo 6 muaj ushtruesin e detyrës së Sekretarit”.

Përgjigjja u miratua nga Kryesia, u tha që ajo të nënshkruhet nga kryetari i Akademisë dhe në formë fizike dhe elektronike t’u dërgohet anëtarëve të Akademisë.

Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se nga ASHSH-ja ka arritur një kërkesë që nga ASHAK-u të paraqiten propozimet për anëtarë të jashtëm të tyre. U tha që kërkesa të diskutohet nëpër seksione dhe secili seksion të propozojë nga një kandidat.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

a) Miratoi raportin e profesor Nebi Cakës, për punët në QLE. U tha se raporti është i plotë, kontrata është përmbushur dhe konsiderohet që faza e parë e projektit :”Shqipja e shkruar në Kosovë” është përmbyllur. Për vazhdimin e punës do të merret vendim i ri, pas paraqitjes së kërkesës nga bartësi i projektit;

b) Miratoi kërkesat për dhurimin e botimeve të ASHAK-ut për MASHTI, për organizatën kulturore “Shtatë Arte-Mitrovicë” dhe u tha që Bibliotekës Ndërkomunale Prizren i dhurohen botimet e ASHAK-ut me automatizëm sipas Rregullores për veprimtarinë botuese;

a) Diskutoi për rregulloren për projekte. M. Kraja tha se në mbledhjen

e kaluar S. Hamiti e ka shtruar nevojën e hartimit të rregullores për projekte. Meqë projektet e ASHAK-ut janë të fushave dhe natyrave të ndryshme ai propozoi që S. Hamiti bashkë me grupin punues për projektin “Historia e letërsisë shqipe” të paraqesin një elaborat për ecurinë e punës, angazhimin e personave, mënyrën e realizimit të pagesave, vlerën e tyre etj.

Njëherësh, në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës S. Hamiti diskutoi për Protokollin e bashkëpunimit ASHAK-ASHSH. Ai tha se protokollin përfundon në fund të këtij muaji dhe çështja e organizimit të Konferencës shkencore mbarëkombëtare në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit (1972-2022) mbetet të diskutohet në SGJL gjatë paraqitjes së propozimeve për protokollin vijues 2022-2024.

Pas diskutimit të S. Hamitit u tha që në mbledhjet e radhës të seksioneve të trajtohet si pikë e veçantë e rendit të ditës paraqitja e propozimeve të seksioneve për Protokollin e bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, 2022-2024.

Në fund të mbledhjes R. Dhomi propozoi që çështjet që trajtohen te pika e fundit e rendit të ditës të përcaktohen paraprakisht.

Kryetari Kraja tha se pajtohet me propozimin dhe se do të bëhen përpjekje të respektohet ky propozim edhe pse në mbledhjet e Kryesisë nganjëherë dalin edhe gjëra aty për aty.

III. Në mbledhjen e mbajtur më 1 shkurt, Kryesia :

Kryesia e shqyrtoi Raportin e punës të ASHAK-ut për vitin 2021 dhe e miratoi njëzëri atë.

Kryesia e shqyrtoi dhe e miratoi edhe Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2021.

U tha që të dy raportet do t'i dërgohen për miratim përfundimtar Kuvendit të Akademisë

Në vazhdim Kryesia:

- Miratoi raportin përfundimtar të projektit: "Modifikimi i sipërfaqes së qymyrit me shtresa të holla organike" (bartës i projektit anëtar korrespondent Fetah Podvorica) dhe vendosi të realizohen pagesat e honorarëve për personat e angazhuar në projekt.

- Miratoi raportin e projektit "Burimet njerëzore dhe zhvillimi i sektorit privat në Kosovë- Hendeuku i shkathtësive dhe kualifikimeve" (bartës të projektit: akademik Isa Mustafa dhe akademike Justina Shiroka Pula) dhe vendosi për realizimin e pagesave të honorarëve për personat e angazhuar në projekt.

- Vendosi të mbahet koncerti me vepra të akademik Zeqirja Ballatës më 16 shkurt 2022, ora 19:00 dhe pjesëmarrësve në koncert t'u realizohen pagesat e honorarëve.

U tha që akorduesit të pianos i realizohet pagesa pas paraqitjes së faturës përkatëse.

- Diskutoi për procedimin e mëtejshëm të drafteve: Plani strategjik gjithëpërfshirës 2022-2025; Rregullorja për veprimtarinë botuese dhe Rregullorja për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese. Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se pas mbledhjes së Kuvendit të Akademisë, grupi punues për hartimin e planit strategjik është

mbledhur, ka diskutuar dhe ka vendosur që draftin e Planit strategjik t'ua dërgojë edhe një herë të gjithë anëtarëve të Akademisë për të paraqitur vërejtje apo sugjerime me shkrim. Nuk ka pasur asnjë reagim nga anëtarët e Akademisë dhe tani është koha që ky draft të procedohet për miratim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Akademisë.

Ai po ashtu njoftoi se pas shqyrtimit të drafteve të rregulloreve të lartpërmendura nëpër seksione është mbledhur grupi punues për plotësimin e tyre dhe i ka shqyrtuar vërejtjet e sugjerimet e seksioneve. Disa janë implementuar e disa jo. Draftet e rregulloreve që sot janë përfshirë nëpër materiale do t'i dërgohen për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Akademisë.

Në diskutimin e tij R. Dhomi propozoi që të saktësohet në Rregulloren për veprimtarinë botuese se veprat e artit muzikor nuk mund të kenë recensentë e as redaktor të botimit.

Kryetari Kraja tha se tani më janë bërë plotësimet e drafteve dhe si të tilla do të procedohen në Kuvend. Propozimet e reja mund të paraqiten edhe gjatë shqyrtimit të drafteve të rregulloreve në Kuvend.

Pas diskutimeve u vendos që draftet e tri dokumenteve të procedohen si të tilla për miratim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Akademisë.

Kryesia më pas vendosi që mbledhja CVI e Kuvendit të Akademisë të mbahet më 23 shkurt 2022, ora 11:00 dhe u propozua ky rend i ditës: miratimi i procesverbalit të mbledhjes CV të Kuvendit të Akademisë; Miratimi i Raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2021; Miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2021; Miratimi i

Planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut 2022-2025; Shqyrtimi dhe miratimi i rregulloreve të ASHAK-ut: Rregullorja për veprimtarinë botuese dhe Rregullorja për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese dhe çështje vijuese.

Në kuadër të pikës vijuese të rendit të ditës, kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se nga seksionet e ASHAK-ut janë paraqitur propozimet për Protokollin e radhës të bashkëpunimit ASHAK-ASHSH. Ai tha se edhe nga ASHSH-ja ka disa propozime dhe tani mbetet të harmonizohen të gjitha, të hartohet drafti i cili do të diskutohet dhe miratohet nga Kryesia e Akademisë. Ai kërkoi nga GJ. Mushkolaj që deri të hënën, më 7 shkurt t'i paraqesë propozimet e SSHSH.

Dhe në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

- a) Vendosi që publikimi i revistave të ASHAK-ut në faqen ueb, të bëhet pasi të ketë dalë botimi në kopje fizike;
- b) E miratoi kërkesën e akademik Rexhep Ismajlit për ribotimin e librit "Drejtshkrimet e shqipes";
- c) Vendosi të blihen mbajtëse/pulte për vendosjen e partiturave muzikore, sipas disponueshmërisë së mjeteve financiare;
- d) Diskutoi për promovimin e botimeve të ASHAK-ut. M. Kraja kërkoi nga sekretarët e seksioneve të caktojnë orarin e promovimeve. Ai po ashtu njoftoi se nga RTK-ja ka pranuar një njoftim që me rastin e promovimeve dhe të organizimit të aktiviteteve të tjera, në programin e mëngjesit mund të marrin pjesë përfaqësues të Akademisë që të flasin për promovimet apo aktivitetet e tjera. U tha që kush

shpreh interesim, përmes asistentes mund të koordinohet për pjesëmarrje në emisionin përkatës;

e) Vendosi të bëhet blerja laptopëve sipas planifikimit për vitin 2022;

f) U njoftua nga M. Kraja se nga seksionet e ASHAK-ut për anëtarë të jashtëm të ASHSH-së janë propozuar akademikët Nexhat Daci dhe Rauf Dhomi.

IV. Në mbledhjen e datës 8 shkurt , Kryesia e shqyrtoi draftin e Deklaratës së ASHAK-ut rreth synimeve të Serbisë për destabilizimin e Kosovës dhe të Ballkanit Perëndimor. Diskutuan të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe u dhanë disa vërejtje e sugjerime. Kryetari Kraja tha se do ta plotësojë draftin e Deklaratës me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që u dhanë dhe pasi të plotësohet Deklarata do të publikohet.

V. Në mbledhjen e mbajtur më 16 shkurt Kryesia:

- E shqyrtoi draftin e Protokollit ASHAK-ASHSH, për periudhën 2022-2023. Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se pas takimit me udhëheqjen e ASHSH-së është hartuar drafti final i Protokollit në të cilin janë përfshirë të gjitha propozimet e ASHAK-ut, disa propozime janë bartur nga Protokollin i kaluar dhe disa të tjera janë shtuar nga ana e ASHSH-së.

Diskutuan S. Hamiti, J. Pula, F. Podvorica dhe pas diskutimeve u miratua drafti i protokollit me disa plotësime të vogla.

- E shqyrtoi kërkesën e akademik Sabri Hamitit, kryetar i Grupit punues të projektit Histori e Letërsisë Shqipe për miratimin e drafteve të Rregullores së

punës dhe Platformës në projektin afatmesëm *Histori e Letërsisë Shqipe*.

Kryetari Kraja në diskutimin e tij tha se një përgjigje me shkrim e ka hartuar dhe ua vuri në dispozicion të gjithëve për diskutim. Miratimi i platformës së projektit të lartpërmendur i takon Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ndërsa i përket Rregullores, ai tha, ato sipas Statutit të Akademisë i miraton vetëm Kuvendi i saj. Dokumenti i paraqitur është më shumë një propozim i konceptit organizativ për realizimin e projektit sesa rregullore dhe ky koncept po ashtu duhet t'i kalojë Seksionit të GJL. Kryesia duhet të njoftohet me të, meqë implikon edhe çështje financiare.

S. Hamiti në diskutimin e tij tha se do t'i ndjekë procedurat ashtu siç parashihet me Statut dhe se në mbledhje të rregullt të Seksionit do ta shtrojë për diskutim çështjen në fjalë.

Në diskutimin e tij F. Podvorica tha se projekti në fjalë është i rëndësishëm së veçantë dhe se duhet të përkrahet, por planifikimi financiar për projekte të tilla duhet të bëhet para se ato të miratohen, ashtu që të bëhet edhe planifikimi i ndarjes së mjeteve financiare.

- E miratoi raportin e udhëtimit të Kryetarit Kraja me bashkëpunëtorë, për qëndrimin e tyre në Tiranë, ASHSH, më 9-11 shkurt 2022;

- Diskutoi për shënimin e përvjetorëve të lindjes të anëtarëve të Akademisë, përfshirë edhe shënimin e përvjetorëve post mortem.

U tha që për anëtarët e Akademisë të shënohen përvjetorët jubilarë të lindjes (80, 90 dhe 100 vjeç), ndërsa për anëtarët post mortem të shënohet vetëm përvjetori i 100-të i lindjes.

-Diskutoi për fillimin e përgatitjeve për hartimin e specifikave teknike për nisjen e aktivitetit të prokurimit: Shtypja botimeve të ASHAK-ut 2022. U tha që sekretarët e seksioneve të paraqesin propozimet e tyre dhe Sekretari shkencor të përfshihet në këtë proces.

VI. Në mbledhjen e mbajtur më 7 mars, pas miratimit të procesverbalit, kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se ashtu siç është biseduar edhe më parë, duhet të fillojë puna për hartimin e rregullores për projekte dhe aktivitete shkencore. Ai propozoi përbërjen e grupit punues për hartimin e rregullores: Justina Sh. Pula, kryesuese dhe Myzaferë Limani, Nysret Krasniqi, Besnik Krasniqi e Lendita Pula, anëtarë. L. Mulliqi në diskutimin e tij tha se në grup punues duhet të jetë edhe një përfaqësues i Seksionit të Arteve, sepse në të ardhmen edhe ky Seksion mund të paraqesë projekte dhe aktivitete shkencore. M. Kraja tha se Seksioni i Arteve nuk ka projekte e aktivitete shkencore, ndërsa për aktivitetet e tyre i ka dy rregullore atë për organizimin e ekspozitave dhe të koncerteve. R. Dhomi në diskutimin e tij paraqiti kritika që në grup punues nuk është propozuar askush nga Seksioni i Arteve dhe tha se ky Seksion nuk po përfillet dhe po lihet anash.

Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe pas diskutimeve u caktua grupi punues me këtë përbërje:

1. Justina Sh. Pula, kryesuese
2. Luan Mulliqi, anëtar
3. Nysret Krasniqi, anëtar
4. Besnik Krasniqi, anëtar
5. Myzaferë Limani, anëtare.

U tha që L. Pula caktohet pjesë e grupit punues për mbështetje juridike dhe administrative.

Në vazhdim Kryesia:

- E shqyrtoi kalendarin e veprimtarive shkencore të ASHSH-së. Kryetari Kraja tha se kalendari është mirë të shqyrtohet me qëllim që të planifikohen aktivitetet e përbashkëta dhe personat që do të marrin pjesë në ato aktivitete. Ai propozoi që sekretarët e seksioneve t'i diskutojnë nëpër seksionet e tyre aktivitetet e përbashkëta ashtu që të caktohen personat që do të marrin pjesë në ato aktivitete. Më pas ASHSH-së do t'i dërgohen emrat e përfaqësuesve të ASHAK-ut. Propozimi u përkrah nga të gjithë.

- Diskutoi për organizimin e panairit të botimeve akademike shkencore, pjesë e Protokollit ASHAK-ASHSH, 2022-2023. Kryetari Kraja tha se panairi do të mbahet në fund të muajit prill. Në panair do të ketë edhe promovim të botimeve të ASHAK-ut, do të promovohen katër botime, nga secili seksion nga një. Ai kërkoi nga sekretarët e seksioneve që gjatë kësaj jave të paraqesin titullin e botimit i cili do të promovohet.

- Diskutoi për blerjen e kompjuterëve. M. Kraja tha se kohë më parë është vendosur të blihen disa laptopë, por duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e kompjuterëve aktualë kanë nevojë të ndërrohen ai propozoi që tani e tutje kabinetet e anëtarëve të Akademisë të kenë gjithnjë kompjuterë të mirë. Akademia nuk ka mjete financiare të mjaftueshme për të pajisur edhe me laptopë të gjithë anëtarët e vet, prandaj ata që kanë laptopë i mbajnë

derisa i kanë funksionalë, ndërsa të tjerë nuk blihen më.

U vendos të blihen 8 kompjuterë, si dhe të blihen kamera dhe dëgjuese, ashtu që të gjithë kompjuterët e anëtarëve të Akademisë të kompletohen me këto pajisje.

Vlera e planifikuar e mjeteve financiare për blerjen e kompjuterëve është 3,000.00€, ndërsa për blerjen e 8 kompjuterëve duhet të shtohen mjete financiare në vlerë prej 1,500.00€, të cilat do të transferohen nga kategoria 13140 (shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit).

Me propozim të Gj. Mushkolajt u tha po ashtu që të bëhet një poster me llogo të Akademisë i cili do të përdoret gjithnjë në parapavijë kur ka pjesëmarrje në aktivitete online.

Në kuadër të pikë së fundit të rendit të ditës Kryesia:

a) Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të anëtarëve të Akademisë: Nexhat Daci, Rauf Dhomi dhe Fetah Podvorica për qëndrimin e tyre në Tiranë me qëllim të pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë të ASHSH-së në të cilën N. Daci e R. Dhomi u zgjodhën anëtarë të jashtëm të ASHSH-së. N. Daci e F. Podvorica kanë qëndruar në Tiranë më 24-26 shkurt, ndërsa R. Dhomi ka qëndruar vetëm më 25 shkurt.

b) U njoftua se MASHTI-t pas kërkesës me shkrim i janë dhuruar 30 libra, Kosova – Monografi, botim i ASHAK-ut, me qëllim që ata libra t'u dhurohen 30 mësuesve me rastin e 7 marsit.

c) Diskutoi për shpalljen e tenderit për shtypjen e librave. Kryetari Kraja kërkoi nga sekretarët e seksioneve dhe nga sekretari shkencor të shpejtojnë me

përgatitjet, ashtu që të mos ketë vonesa.

Në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës kryetari Kraja kërkoi nga sekretarët e seksioneve të merren me përgatitjet për promovimin e botimeve, ashtu që sa më parë të caktohen datat, si dhe kërkoi nga Seksioni i Arteve të merret me organizimin e një ekspozite në pjesën e parë të këtij viti dhe një tjetër në vjeshtë.

Në fund Kryesia u njoftua nga L. Pula se tani e tutje pjesë e dokumenteve për udhëtime zyrtare duhet të jetë edhe një vendim i Kryesisë. Kryetari Kraja tha se në raste kur Kryesia nuk mund të mbledhet vendimin në fjalë ta nënshkruajë Sekretarja e Akademisë. Gj. Mushkolaj propozoi që vendimi të nënshkruhet nga Sekretari shkencor, si anëtar i Kryesisë. Propozimi i fundit u miratua dhe u vendos që L. Mulliqi të nënshkruajë vendimet për udhëtime zyrtare.

VII. Në mbledhjen e datës 17 mars, Kryesia e shqyrtoi Kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH) 2023-2025, të ASHAK-ut. L. Pula me kërkesë të Kryetarit ofroi sqarimet e nevojshme. Diskutuan S. Hamiti, F. Podvorica dhe pas diskutimeve u miratua dokumenti i KASH-it 2023-2025.

Në vazhdim Kryesia:

- Diskutoi për botimet që do të promovohen në Panairin e botimeve akademike e shkencore, në Tiranë, më 22-24 prill 2022 dhe u vendos si në vijim:

a) SGJL, promovohet libri i Sabri Hamitit: "Enigma e poezisë". Për librin flet Nysret Krasniqi;

b) SSHN, promovohet libri i Fejzullah Krasniqi dhe Rexhep Selimajt: "Komfori termik". Për librin flet akademik Isuf Krasniqi;

c) Seksioni i Shkencave Shoqërore, në pritje të propozimit;

d) SA, promovohet libri i Rauf Dhomit: "Vepra për piano". Për librin flet Prof.Ma. Syzana Jakupi.

- Diskutoi për hartimin dhe botimin e katalogut të plotë të botimeve të ASHAK-ut. Kryetari Kraja njoftoi se botimi i fundit është i vitit 2015 dhe nuk është përditësuar. Ai propozoi që botimi të plotësohet me të gjitha botimet nga viti 2015 e deri në vitin 2021 dhe njoftoi po ashtu se J. Sh. Pula ka shprehur vullnet ta përgatitë dorëshkrimin i cili më pas do të botohet. Propozimi u miratua.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

a) U njoftua nga Gj. Mushkolaj për punën e Këshillit për bashkëpunim ndërkombëtar të ASHAK-ut. Ajo njoftoi se Këshilli ka mbajtur mbledhje në të cilën ka vendosur për disa çështje të rregullta të punës, ka caktuar pjesëmarrësit në aktivitetet shkencore fizike dhe online. M. Kraja në diskutimin e tij tha se për pjesëmarrje në aktivitete jashtë vendit duhet të njoftohet Kryesia paraprakisht. Diskutoi edhe L. Mulliqi dhe u tha se një raport i detajuar për punën e këshillit do të duhej t'i paraqitet Kryesisë nga mesi i këtij viti;

b) Vendosi të shtohen mjetet financiare në vlerë prej 7,000.00€ te kodi 14220, botimet e publikimeve, kjo për shkak se

çmimi i letrës në treg është rritur dukshëm dhe mjetet e planifikuara në vlerë prej 35,000.00€ nuk mjaftojnë për realizimin e shtypjes së botimeve të parapara. U vendos që 4,000.00€ të transferohen nga kodit 13142, akomodimi i udhëtimit zyrtar jashtë vendit dhe 3,000.00€ të transferohen nga kodit 13660, akomodimi;

c) U njoftua nga L. Pula se dy zyrtarë të IT-së në ASHAK, kanë paraqitur kërkesë për realizimin e shtesës së IT-së e cila është paraparë me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ajo tha se kjo çështje është marrë parasysht nga ASHAK-u dhe dy herë radhazi MAP-it i është dërguar kërkesë me shkrim, por nuk ka pasur përgjigje. U tha që Kryesia pajtohet të realizohen shtesat në fjalë, nëse ato miratohen nga institucionet përkatëse.

VIII. Në mbledhjen të mbajtur më 28 mars, Kryesia:

-E shqyrtoi Planin e menaxhimit të rrezikut të ASHAK-ut, për vitin 2022-2025. Plani u miratua pa vërejtje bashkë me regjistrin e rrezikut për vitin 2022 dhe më pas Kryesia caktoi grupin punues për menaxhimin e tij, me këtë përbërje: anëtar korrespondent Besnik Krasniqi, koordinator, anëtare korrespondente Myzaferë Limani dhe znj. Vjollca Hykollit, anëtare;

-E shqyrtoi ftesën për pjesëmarrjen e ASHAK-ut në Panairin e librit 2022 në Shkup, më 3- 9 maj 2022. Kryesia vendosi që ASHAK-u të marrë pjesë me botimet e veta në panair dhe u tha që të shikohet mundësia e ndonjë promovimi apo edhe pjesëmarrjeje në ndonjë aktivitet në kuadër të panairit.

Gj. Mushkolaj propozoi që në raste të pjesëmarrjeve në panire të bëhet kumtesë për medie nga ASHAK-u, ashtu që auditoriumi të jetë i njoftuar. Propozimi u përkrah nga të gjithë;

- E shqyrtoi shkresën e akademik Rexhep Ismajlit për udhëtimin e tij në Vjenë dhe në Bruksel. U tha që ASHAK-u t'i mbulojë shpenzimet e udhëtimit (biletën e aeroplanit) dhe akomodimin e mëditjet vetëm për qëndrimin në datat e parapara në ftesat zyrtare. Për ditët e qëndrimit në Akademinë Austriake të zbatohen rregullat e përcaktuara në Marrëveshjen ASHAK-ASHA.

- U njoftua nga R. Dhomi se SA ka paraparë organizimin e dy ekspozitave dhe se Seksioni është pajtuar që me punët e ekspozitës të merret L. Mulliqi. L. Mulliqi më pas njoftoi se një ekspozitë e tij (e mbetur pa realizuar për shkak të pandemisë) do të hapet në Shkup, më 26 prill 2022, ndërsa ekspozita tjetër, me titull: "Ekspozita e femrave" është duke u përgatitur. Seksioni për të dy ekspozitat tani më ka caktuar dizajnerët, kuratorin, hartuesit e parathënies të katalogëve dhe fotografët.

"Ekspozita e femrave" u tha se mund të shoqërohet me një program artistik muzikor.

Kryesia me shumicë votash i miratoi propozimet e paraqitura nga L. Mulliqi. U tha që të gjitha punët e ekspozitave të kryhen në përputhje me Rregulloren e ASHAK-ut, për organizimin e ekspozitave.

- U njoftua nga J. Sh. Pula se punët për përgatitjen e faqesueb të ASHAK-ut po vazhdojnë. Kanë mbetur pa u fotografuar një numër shumë i vogël i anëtarëve të Akademisë. Ditëve në

vijim do të dakordohemi me ta që të paraqiten në Akademi për realizimin e fotografive. Ata që nuk vijnë ju mbetet vetëm emri e mbiemri pa fotografi. Ajo më pas po ashtu njoftoi se biografitë janë përkthyer dhe se tani duhet të bëhet redaktura e tyre.

Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë. U vendos që z. Xhemshiti Brajshori të merret me redakturën e biografive në gjuhën angleze. U tha po ashtu se z. Brajshori një herë e ka refuzuar kërkesën e Kryesisë për përkthimin e biografive dhe nëse një gjë e tillë përsëritet prapë, për redakturë duhet të gjendet një zgjidhje duke angazhuar dikë nga jashtë. Por ndaj z. Brajshori i cili e ka në përshkrim të vendit të punës përkthimin duhet të merren masa përkatëse disiplinore.

IX. Në mbledhjen e datës 12 prill, Kryesia:

- E shqyrtoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 10132/21. L. Pula me kërkesë të Kryetarit e njoftoi Kryesinë se pas padisë së punonjësve të Shërbimit profesional, administrativ e teknik të ASHAK-ut, kemi pranuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Tani ASHAK-u duhet të paraqesë përgjigjen në padi brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe u tha që ASHAK-u nuk mund ta miratojë kërkesën e punonjësve, meqë nuk ka mjete buxhetore për kompensimin e këtyre kërkesave dhe nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për kërkesat e paditësve, dhe se Akademia nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshjeje.

Kryesia vendosi që të kthehet përgjigja në padi me formulimin e lartcekur.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia:

a) E shqyrtoi shkresën e Rektorit të UP-së, nr. 686, dt. 08.04.2022, për bashkëpunim në kuadër të thirrjes "Increasing Research Capacities in Kosovo". U tha se bashkëpunimi ASHAK – UP për projektin në fjalë mund të realizohet duke u bazuar në Memorandumin e mirëkuptimit ASHAK-UP, nr. 450, dt. 28.05.2018. Çështjet ligjore dhe financiare palët do t'i përcaktojnë me marrëveshje të veçantë;

b) U njoftua nga L. Pula se vendimi i Kryesisë për blerjen e 8 kompjuterëve të modelit *all in one* nuk ka mundur të realizohet sepse mjetet financiare që disponon ASHAK-u nuk e mbulojnë blerjen e tyre. U vendos që të blihen 8 kompjuterë të kategorisë më të ulët;

c) Propozoi komisionin e vlerësimit për aktivitetin e prokurimit: Shtypja botimeve të ASHAK-ut 2022, si në vijim: Eqrem Basha, Myzafer Limani dhe Taulant Veseli;

d) Mori vendim të caktohet përkthyes për përkthimin e materialit të katalogut të Ekspozitës personale të L. Mulliqit që do të mbahet në Shkup. PAGESA realizohet në bazë të Rregullores për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese të ASHAK-ut, neni 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.

X. Në mbledhjen e mbajtur më 19 prill, Kryesia:

- Mori vendim të realizohen pagesat për personat e angazhuar për organizimin e ekspozitave dhe përgatitjen e katalogëve të tyre.

XI. Në mbledhjen e mbajtur më 29 prill, Kryesia:

-E shqyrtoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 10042-21 L. Pula me kërkesë të Kryetarit e njoftoi Kryesinë se pas padisë së punonjësve të Shërbimit profesional, administrativ e teknik të ASHAK-ut, kemi pranuar një Aktvendim të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Tani kemi pranuar Aktvendimin e radhës dhe se sigurisht ditëve në vijim do të ketë aktvendime edhe të tjera derisa Gjykata të shqyrtojë të gjitha rastet. ASHAK-u duhet të paraqesë përgjigjen në padi brenda afatit të përcaktuar ligjor në të gjitha rastet.

Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe u tha që ASHAK-u mund ta miratojë kërkesën e punonjësve, meqë nuk ka mjete buxhetore për kompensimin e këtyre kërkesave dhe nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për kërkesat e paditësve, dhe se Akademia nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshjeje.

Kryesia vendosi që edhe për këtë rast dhe për rastet që paraqiten në vijim, të kthehet përgjigja në padi me formulimin e njëjtë.

- E shqyrtoi dhe e miratoi kërkesën e DPPTIK-ut për blerjen e disa kamerave dhe pajisjeve të TIK-ut. U tha se katër kamera dhe disa UPS janë dëmtuar dhe duhet të zëvendësohen.

Në kuadër të pikës së fundit të kësaj mbledhjeje Kryesia:

a) U njoftua nga J. Sh. Pula për rrjedhën e punës për funksionalizimin e faqesueb të ASHAK-ut. Ajo në fjalën e saj tha se me kompaninë e cila është përzgjedhur ka probleme, sepse nuk po punojnë sipas marrëveshjes, ka shumë

vonesa dhe ditëve të fundit ata nuk po përgjigjen as përmes komunikimit elektronik e as në telefon. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe u tha që të ndërmerren veprimet përkatëse, ashtu që të ndërpritet kontrata me ta dhe të fillojnë procedurat për nisjen e aktivitetit të ri të prokurimit;

b) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të anëtarëve të Akademisë dhe zyrtarëve të administratës në Tiranë më 21-26 prill 2022, me qëllim të pjesëmarrjes në Panairin mbarëkombëtar të botimeve akademike e shkencore;

c) U njoftua nga L. Pula se me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës, janë përgatitur për dhurim botimet e Akademisë;

d) U njoftua nga L. Pula se procedurat e tenderimit për shtypjen e botimeve të ASHAK-ut për vitin 2022 kanë përfunduar, ditëve në vijim lidhet kontrata dhe nga pjesa e dytë e muajit maj librat mund të dërgohen në shtyp.

XII. Në mbledhjen mbajtur më 17 maj, Kryesia diskutoi për përgatitjet për programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2023. M. Kraja tha se tani është koha që seksionet të mbajnë mbledhjet e para në të cilat paraqiten propozimet dhe ato të dytat në të cilat miratohet ato. Ai tha se sekretarët e seksioneve të përkujdesen që dorëshkrimet e propozuara të jenë të gatshme me llogaritje të përafërta të tabakëve të autorit, propozimet për projekte dhe aktivitete shkencore të përmbajnë edhe pjesët e shpenzimeve financiare. Në raste kur ka propozime nga jashtë Akademisë, ato të vlerësohen nga seksioni përkatës dhe nëse refuzohen, autorëve t'u kthehet përgjigje me

shkrim nga sekretarët e seksioneve përkatëse.

U tha që mbledhjet e seksioneve në të cilat miratohet programi i punës për vitin 2023 të përfundojnë më së largu deri më 6 qershor 2023, ashtu që më pas të mbetet kohë për përgatitjen e materialeve të cilat i dërgohen Kryesisë për shqyrtim dhe më pas brenda afateve ligjore Kuvendit të Akademisë për miratim.

Në vazhdim Kryesia me kërkesë të kryetari Kraja u njoftua nga L. Pula për procedurën e caktimit të U. D. Sekretarit të Seksionit të Arteve. L. Pula tha se U.D. Sekretarit të tanishëm i përfundon mandati më 30 qershor dhe brenda muajit maj apo javën e parë të muajit qershor duhet të caktohet U. D. Sekretari për periudhën 1 korrik-31 dhjetor 2022.

U tha që të vazhdojnë procedurat e parapara dhe Kryesia të njoftohet në mbledhje të rregullt për caktimin e U. D. Sekretarit të SA.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje, Kryesia:

- a) Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të akademik Rexhep Ismajlit, për qëndrimin e tij në Vjenë dhe Bruksel, më 1-15 maj 2022;
- b) Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të kryetarit Kraja me bashkëpunëtorë, për pjesëmarrje në takimet e përbashkëta ASHAK-ASHSH, në Shqipëri, më 11-14 maj 2022;
- c) E shqyrtoi ftesën për prezantimin e librit të R. Dhomi; “Vepra për piano” në Itali-Firencë. U tha që të kompletohet dokumentacioni i nevojshëm dhe R. Dhomit t’i mbulohen të gjitha shpenzimet e udhëtimit zyrtar.

XIII. Mbledhja e radhës e Kryesisë, u mbajt më 25 maj. Pas miratimit të

procesverbalit të mbledhjes pararendëse Kryesia në këtë mbledhje Kryesia diskutoi rreth punëve organizative për mbajtjen e ekspozitës : “Thurje kosovare”.

U tha që punët e organizmit të ekspozitës kolektive :”Thurje kosovare” i merr përsipër anëtar korrespondent Luan Mulliqi, koordinator i saj.

Vendimi merret bazuar në atë se, Rregullorja për organizmin e ekspozitave të ASHAK-ut, neni 5 paragrafi 1, përcakton detyrimet e ASHAK-ut dhe të autorit.

XIV. Në mbledhjen e mbajtur më 14 qershor, Kryesia e shqyrtoi Programin e punës së ASHAK-ut për vitin 2023. Kryetari Kraja njoftoi se e ka rishikuar programin e hartuar nga seksionet dhe ka bërë disa ndërhyrje, duke i dhënë atij një formë për të gjitha seksionet. Ai tha se vlerat financiare për pagesat në projekte nuk do t’i dërgohen Kuvendit të Akademisë, sepse ato i miraton Kryesia e Akademisë pasi të paraqiten raportet e punës me shënime për punët e kryera.

Ai më pas tha se projektet apo rezultatet e tyre duhet patjetër të botohen. Bartësit e projekteve duhet të paraqesin formën e botimit të projekteve, marrë parasysh specifikat e projekteve sipas seksioneve.

Me këtë rast ai tha se për projektin e SGJL-së *Historia e letërsisë shqipe* deri më tani nuk ka asnjë raport dhe kërkoj nga sekretari i SGJL të paraqesë raport në Kryesi, për të angazhuarit dhe për mënyrën e kompensimit të tyre.

F.Podvorica në diskutimin e tij tha se SSHN i ka paraqitur projektet me arsyetime të qarta ku janë përfshirë edhe vlerat financiare për realizimin e

kompensimit për personat e angazhuar. Ai tha se nuk është korrekte që këto vlera mos të merren parasysht kur të vjen koha e realizimit të pagesave, prandaj kërkoi që Kryesia t'i miratojë në parim edhe vlerat financiare. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe u tha që shënimet për realizimin e pagesave miratohen dhe mbesin në draftin e programit për shqyrtim nga Kryesia, Kuvendit i dërgohet drafti për miratim pa shënime për pagesa. Programi miratohet nga Kuvendi. Më pas bartësit e projekteve pas përfundimit të punës hartojnë raporte të cilat i shqyrtojnë dhe i miratojnë fillimisht nëpër seksione dhe më pas Kryesia i miraton raportet përfundimtare dhe merr vendim për realizimin e pagesave. Por Kryesia vendimin për realizimin e pagesave e merr duke u mbështetur në punën e bërë.

Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se pas shqyrtimit nëpër seksione të drafteve të rregulloreve: Rregullores për projekte shkencore dhe Rregullores për organizimin e aktiviteteve shkencore, ka pasur disa vërejtje dhe sugjerime me shkrim nga anëtarët e Akademisë. Grupi punues është mbledhur, i ka shqyrtuar ato dhe pas shqyrtimit i ka finalizuar draftet e rregulloreve që sot do të shqyrtohen edhe një herë. Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe u vendos që këto dy drafte të rregulloreve të procedohen për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Akademisë.

Në vazhdim u shqyrtua shpërndarja e mjeteve buxhetore, sipas Qarkores 2023/1. Dokumenti në fjalë u miratua me një plotësim, ashtu që në kodin ekonomik nr.13510-blerja e librave dhe

e veprave artistike mbesin mjetet në vlerë prej 8.000.00 € (6.000.00€ për vepra artistike dhe 2.000.00€ për libra) në vend të 12.000.00 € sa kanë qenë. Mjetet në vlerë prej 4.000.00 € transferohen në kodin ekonomik nr. 13503-kompjuterë dhe vlera e mjeteve për blerjen e kompjuterëve bëhet 9.000.00€. Kërkesë për mjete shtesë ka vetëm për një punonjës.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia:

- U njoftua me vendimin e Seksionit të Arteve se akademik Rauf Dhomit është caktuar U. D. Sekretar i Seksionit të Arteve për periudhën 1 korrik deri më 31 dhjetor 2022;

- Vendosi ta thërrasë mbledhjen e Kuvendit të Akademisë, CVII, më 30 qershor 2022, ora 11:00. U caktua ky rend dite: miratimi i procesverbalit të mbledhjes CVI të Kuvendit të Akademisë; miratimi i Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2023; shqyrtimi dhe miratimi i rregulloreve: Rregullorja për projekte shkencore dhe Rregullorja për organizimin e aktiviteteve shkencore dhe çështje vijuese;

- E shqyrtoi shkresën (kërkesën) e anëtarit korrespondent Arsim Bajramit, për pjesëmarrje në takimet e EASA-s në Salzburg. S. Hamiti, në diskutimin e tij tha se kjo shkresë nuk mund të quhet kërkesë, sepse është vetëm njoftim drejtuar administratës;

Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe me shumicë votash kërkesa u refuzua me arsyetimin se ASHAK-u nuk ka bashkëpunim institucional me EASA dhe se përfshirja e A. Bajramit në organet e EASA-s nuk është bërë me propozim të ASHAK-ut;

- E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të kryetarit Kraja me bashkëpunëtorë,

për qëndrimin në Tiranë, më 8-9 qershor 2022, me qëllim të pjesëmarrjes në promovimin e botimit të ASHAK-ut: “Çesk Zadeja në muzikën shqiptare” të akademik Vasil Toles;

- Diskutoi për pasurimin e faqes ueb të ASHAK-ut. U tha që para çdo aktiviteti shkencor administrata ta vendosë njoftimin sipas ftesës përkatëse, ndërsa pasi të kryhet aktiviteti shkencor, sekretarët e seksioneve të hartojnë tekstin të cilin ia procedojnë administratës për publikim, përmes nënkryetares së Akademisë.

XV. Në mbledhjen e mbajtur më 20 qershor, kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se dy ditë më parë janë njoftuar nga kabineti i Kryeministrit të Republikës së Kosovës se dy qeveritë në mbledhjen e tyre që do të mbahet sot do të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit për hartimin e Enciklopedisë Shqiptare. Kjo marrëveshje i ngarkon dy akademitë ASHSH dhe ASHAK për hartimin e Enciklopedisë. Një draft të marrëveshjes që e kemi pranuar nga kabineti i Kryeministrit e keni përpara. Platforma e hartuar nga grupi i punës së ASHAK-ut i është dërguar për shikim ASHSH-së dhe nuk ka pasur ndonjë vërejtje. Tani jemi në pritje të marrëveshjes së nënshkruar nga dy qeveritë dhe sapo ta marrim do të paraqesim kërkesën për mjetet shtesë, të cilat i kalojnë buxhetit të ASHAK-ut për vitin 2023 me destinacion për Enciklopedinë Shqiptare. Në këtë fazë do të paraqesim kërkesën për një vlerë të përafërt, meqë nuk mund të përcaktojmë vlerë reale. Ka shumë punë operacionale që duhet të bëhen bashkë me ASHSH-në, duhet të bëhet edhe një rregullore e përbashkët. Tani

më formalisht janë caktuar tre veta nga ata dhe dy nga ne për hartimin e një draftregulloreje, por ne do të caktojmë edhe anëtarin e tretë. Ai më pas tha se platforma mund t'i paraqitet për miratim Kuvendit të Akademisë në mbledhjen e dt. 30 qershor, ose mund të thirret një mbledhje tjetër e Kuvendit. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe u tha që për shqyrtimin dhe miratimin e platformës për ESH të thirret një mbledhje e Kuvendit në fund të muajit shtator, apo në fillim të tetorit.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje kryetari Kraja foli për ekzpozitën: “Thurje kosovare” e cila u hap në ASHAK, më 26 maj. Ai tha se brenda Akademisë ka pasur reagime jo të mira, por të tilla reagime ka pasur edhe nga jashtë Akademisë. Ai tha se herëve të tjera duhet të jemi më të kujdesshëm në përzgjedhjen e autorëve dhe veprave të ekspozitave dhe si Kryesi do të jemi më të përfshirë në organizimin e tyre.

S. Hamiti në diskutimin e tij tha se aktivitetet në Akademi duhet të planifikohen më herët, ashtu që të mos ketë mbivuarje të tyre, siç ndodhi herën e fundit kur ekspozita ishte e hapur, ndërsa patëm edhe dy konferenca afër njëra-tjetrës.

XVI. Më 28 qershor në mbledhjen e Kryesisë para miratimit të procesverbalit diskutoi L. Mulliqi. Ai propozoi që të riformulohet i gjithë paragrafi te pika e tretë e rendit të ditës, sepse konstatimi i kryetarit Kraja që Kryesia duhet të jetë e përfshirë në organizimin e ekspozitave është ndërhyrje në punën e Seksionit të Arteve. Ai tha se çështja e konceptit dhe e organizimit të ekspozitave nuk i takon Kryesisë.

Kryetari Kraja tha se mbetet pranë asaj që ka thënë lidhur me këtë çështje dhe se kjo duhet të mbetet në procesverbal, sepse procesverbali pasqyron atë që është thënë në mbledhje, ndërsa qëndrimi i L. Mulliqit të shënohet si pjesë e diskutimit të kësaj mbledhjeje.

Procesverbali i mbledhjes XV të Kryesisë së Akademisë u miratua pa vërejtje.

Më pas Kryesia diskutoi për disa çështje të punëve në Akademi, si në vijim:

a) Kryetari Kraja propozoi që në rastet e promovimeve të librave, në drekë të shkojnë: sekretari i seksionit përkatës, autori dhe ata që flasin për librin që promovohet, ndërsa në rast të organizmit të aktiviteteve shkencore (konferenca, tryeza, etj.) në drekë shkojnë vetëm pjesëmarrësit në aktivitetet. Ky propozim bëhet me qëllim të reduktimit të shpenzimeve financiare. Propozimi u miratua njëzëri;

b) U diskutua çështja e lëvizjes së pikturave me rastin e organizimit të ekspozitave. U tha që koordinatori i ekspozitës të merret me lëvizjen e pikturave, ashtu që të organizojë prurjen dhe daljen e tyre. Edhe në rastin e lëvizjes së pikturave brenda Akademisë, sekretari shkencor të përcjellë procesin dhe pas çdo lëvizjeje të pikturave të njoftohet zyrtari i logjistikës dhe i pasurisë, ashtu që të evidencohet çdo ndryshim eventual i vendndodhjes së tyre;

c) U tha të blihet një fotoaparati i ri dhe të blihen tepisonët e rinj në hollin e Akademisë, kati përdhës;

d) Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se në kërkesën drejtuar Ministrisë së Financave për mjete shtesë për projektin Enciklopedia Shqiptare është

paraqitur vlera 150,000.00€. Kjo për fillim si parashikim, meqë është kërkuar nga vetë Ministria, ndërsa më vonë duhet parë rrjedha e punës;

e) L. Pula e njoftoi Kryesinë se ASHAK-u ka pranuar raportin i Auditorit të përgjithshëm. Raporti është i pakualifikuar. Ka vetëm një rekomandim që lidhet me regjistrimin e pasurive, për të cilin kemi reaguar dhe nuk e kemi pranuar, sepse gabimi ka ndodhur jo për shkakun e neglizhencës nga ASHAK-u, por si pasojë e moskryerjes së punës nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike. Ka pasur kontakte të vazhdueshme me ta, por përgjigja ka qenë se nuk kanë kontratë për kryerjen e punëve përkatëse. Tani së fundmi kemi marrë përgjigje se janë në fazën e vlerësimit të tenderit dhe sapo të përfundojnë procedurat tenderuese, do të zgjidhin çështjen në fjalë.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se në takimin që ka pasur me Kryesinë e ASHSH-së, është biseduar për nisjen e punës për hartimin e një rregulloreje për punën në projektin *Enciklopedia Shqiptare*. Ata i kanë propozuar tre veta dhe unë kam paraqitur dy emra, M. Kraja dhe L. Pula. Sot duhet të caktojmë edhe anëtarin e tretë nënkryetaren apo sekretarin shkencor, kjo për të pasur një harmoni me grupin e tyre. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë dhe L. Mulliqi u caktua anëtar i grupit punues.

Dhe në fund Kryesia:

a) U njoftua nga kryetari Kraja se pagesat për projektin e SGJL-së: “Historia e Letërsisë Shqipe”, nuk do të bëhen në këtë fazë. Në fund të vitit bartësi i projektit do të paraqesë raport

me shkrim dhe propozimin për vlerat e pagesave. Pas shqyrtimit nga ana e SGJL-së, vlera e pagesave dhe realizimi i tyre do të bëhet me vendim të Kryesisë;

b) U njoftua nga Kryetari se në Bibliotekën e ASHAK-ut dhurojnë libra anëtarët e Akademisë dhe autorët të jashtëm, porse shpesh ndodh që të paraqitet sasi e madhe e librave për dhurim dhe se si Kryesi duhet të gjejmë mënyrën e pranimit të librave dhuratë. Gj. Mushkolaj propozoi që në rastet kur autorët brenda dhe jashtë Akademisë shprehin dëshirë të dhurojnë më shumë kopje, të librave, t'i paraqesin fillimisht kërkesë me shkrim Kryesisë së Akademisë, bashkë me listën e librave që do të dhurohen. Më pas Kryesia të vendosë për titujt që mund të pranohen. Propozimi u përkrah njëzëri dhe u vendos që përveç anëtarëve të Akademisë librat dhuratë pranohen edhe nga autorët jashtë Akademisë. Në të dy rastet pranohen deri në dy kopje të librave. Në rastet kur autorët shprehin dëshirë të dhurojnë më shumë kopje, ata duhet t'i paraqesin fillimisht kërkesë me shkrim Kryesisë së Akademisë. Kërkesa duhet të shoqërohet me listën e librave që do të dhurohen. Pas miratimit të kërkesës nga Kryesia, librat sistemohen sipas procedurave përkatëse. Në Bibliotekë nuk mund të pranohen më shumë se dy kopje të librave, pa miratim të Kryesisë së Akademisë.

XVII. Në mbledhjen që u mbajt më 31 gusht, kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se auditori i brendshëm ka bërë auditimin e rregullt dhe nga ky auditim kanë rezultuar tri rekomandime, të cilat do të bëjmë përpjekje maksimale t'i evitojmë. Ai më pas kërkoi nga L. Pula

sqarime për raportin në fjalë. L. Pula e njoftoi Kryesinë se rekomandimi i parë ka të bëjë me planifikimin e shpërndarjes së buxhetit dhe se është kërkuar që planifikimi të jetë më i saktë. Rekomandimi i dytë ka të bëjë me menaxhimin e kontratave. Ndër të tjera është kërkuar që çdo shpenzim që duhet të bëhet për organizimin e aktiviteteve shkencore të ketë kërkesë. Tani e tutje për çdo aktivitet sekretarët e seksioneve përkatëse në një formular do të paraqesin kërkesat për aktivitetin që do të mbahet e që lidhen me çështje financiare.

Rekomandimi i tretë ka të bëjë me vulën katrore të Akademisë. Akademia ka në dispozicion katër vula, një të rrumbullakët, një katrore për protokollimin e shkresave, një katrore për pranimin e shkresave dhe një katrore me shënimin dhuratë e cila përdoret për vulosjen e librave që ASHAK-ut i dhurohen dhe atyre që i dhuron.

L. Pula tha se kërkesa e auditorit është që vulat e ASHAK-ut të punohen në përputhje me Ligjin për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës. Ky Ligj precizon formën e dukjes së vulës dhe që vula duhet të jetë në gjuhët zyrtare të RK.

Diskutuan të gjithë anëtarët e pranishëm të Kryesisë dhe u vendos që vula rrethore të mos ndryshohet, por të punohen dy vulat katrore sipas rekomandimit të auditorit dhe legjislacionit përkatës.

Kryesia caktoi Komisionin për zhvillimin e procedurës për marrjen e lejes për punimin e vulave katrore, porositjen e vulave të vulëpunuesi, mbikëqyrjen e punës së vulëpunuesit, arkivimin e vulave, shpalljen e pavlefshme të vulave dhe veprime të tjera të

paraqitura në dispozitat e Ligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 02/L-37 dhe Udhëzimin administrativ Nr. 03/2009-MSHP për formën e vulës katrore si dhe llojin, nuancat dhe parametrat teknikë të ngjyrës së vulës katrore, me këtë përbërje:

1. Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, sekretare e SSHSH;
2. Taulant Veseli, administrator i lartë i sistemeve të TIK-ut;
3. Rejhane Islami, zyrtare e Lartë për Bibliografi dhe Hulumtim shkencor.

Më pas kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se me ASHSH-në do të fillojë puna për hartimin e Rregullore për *Enciklopedinë Shqiptare*. Ai njoftoi se grupet punuese do të takohen në Shqipëri në datat 7-10 shtator për finalizimin e saj dhe finalizimin e Platformës së përbashkët.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

- a) U njoftua se pas kërkesave me shkrim të dorëzuara në ASHAK, u janë dhuruar botimet e ASHAK-ut: Asociacionit të arkitektëve të Kosovës dhe Kolegjit të Kirurgëve të Kosovës;
- b) E shqyrtoi kërkesën për zhvillimin e "Orës kulturore" për disa botime të autorëve nga Çamëria për Çamërinë. Kërkesa u miratua dhe u tha që organizatorit t'i dërgohet njoftimi me shkrim dhe t'i propozohen datat 20-30 shtator. Pas konfirmimit të datës nga ana e tyre, ASHAK-u të bëjë përgatitjet e nevojshme;
- c) E shqyrtoi mundësinë për mbajtjen e ligjëratës së anëtares së jashtme të ASHAK-ut, Irena Sawicka. Kryesia u

pajtua që ligjërata të mbahet më 23 apo 24 nëntor, ashtu siç ka propozuar Prof. Sawicka. Data e saktë do të caktohet në koordinim me sekretarin e SGJL;

d) Diskutoi për rendin shtëpiak në ASHAK. Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se ASHAK-u e ka një Rregullore për rendin shtëpiak në ASHAK dhe ajo duhet të zbatohet. Ai njoftoi më pas se kushdo që hyn në objektin e ASHAK-ut pas orës 16:00 duhet të njoftojë policin që është në ndërrim. Policia e ka për obligim që të mbajë evidencë me shkrim për çdo hyrje dalje pas orës 16:00;

e) U njoftua nga L. Pula se MPB-ja dhe Telekom i Kosovës kanë nënshkruar kontratë për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese (telefonja mobile dhe fikse, internet dhe tv kabllorik), dhe ajo kontratë është e vlefshme edhe për ASHAK-un. Ajo njoftoi se tani e tutje mbushjet merren vetëm në formë elektronike;

f) U njoftua nga kryetari Kraja për aktivitetet shkencore e artistike që do të mbahen gjatë vitit 2022. Ai tha se ka mjaft aktivitete dhe apeloj te sekretarët e seksioneve që të mos caktojnë data për mbajtjen e aktiviteteve pa u koordinuar me administratën, meqë kjo e fundit mban shënime për agjendën e aktiviteteve.

XVIII. Në mbledhjen e Kryesisë që u mbajt më 19 shtator, kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se grupet punuese të ASHAK-ut dhe ASHSH-së kanë hartuar draftin e rregullore për mënyrën e funksionimit të Redaksisë Qendrore, të redaksive vendore dhe të redaksive të fushave të Enciklopedisë Shqiptare, si dhe e kanë finalizuar draftin e Platformës së përbashkët.

Meqë drafti i rregullores është i bazuar në Platformën e përbashkët ai propozoi që Kuvendit të Akademisë t'i paraqitet për miratim Platforma e përbashkët, ndërsa rregulloren ta miratojë Kryesia e Akademisë.

Propozimi u miratua nga të gjithë anëtarët e pranishëm. U tha që Platforma e përbashkët të shqyrtohet në mbledhje të seksioneve të Akademisë, të cilat duhet të mbahen më së largu deri më 30 shtator. Platforma t'u dërgohet nesër të gjithë anëtarëve të Akademisë që ta kenë në dispozicion ta lexojnë dhe të japin vërejtje dhe sugjerime eventuale.

Pas shqyrtimit të Platformës së përbashkët nëpër seksione dhe pas pranimit të vërejtjeve dhe sugjerimeve eventuale, Kryesia do ta shqyrtojë edhe një herë dhe më pas do të thirret mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit të Akademisë për miratimin e saj.

Kryesia në vazhdim diskutoi për përgatitjet për Panairin e librit në Tiranë. U tha që logjistika do të merret me përgatitjet teknike. U vendos që anëtarët e Akademisë të marrin pjesë në Panair më 18-20 nëntor 2022. Atyre u mbulohen shpenzimet e akomodimit për dy netë dhe mëditjet për tri ditë. Shpenzimet e udhëtimit nuk mbulohen nga Akademia.

Dhe në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

a) Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të kryetarit Kraja me bashkëpunëtorë: Justina Sh. Pula, Luan Mulliqi dhe Lendita Pula, për qëndrimin e tyre në Shqipëri me qëllim të pjesëmarrjes në takim me udhëheqjen e ASHSH-së për hartimin e Platformës së përbashkët dhe Rregullores për Enciklopedinë Shqiptare, më 7-10 shtator 2022;

b) Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të Luan Mulliqit për qëndrimin e tij në Mal të Zi (Tuz), me qëllim të pjesëmarrjes në promovimin nga komuna e Tuzit të librit Gjelosh Gjokaj-monografi, më 24 gusht 2022;

c) U njoftua nga L. Pula, se Kuvendit të Republikës së Kosovës, pas kërkesës së tyre u janë dhuruar botimet e ASHAK-ut;

d) Diskutoi për kërkesën e Universitetit të Gjilanit për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të ndërsjellë mes tyre dhe ASHAK-ut. U tha që kjo çështje të diskutohet në një nga mbledhjet e radhës;

e) Diskutoi për kërkesën e L. Mulliqit për ndryshimin e përbërjes së komisionit për blerjen e veprave artistike, ashtu që në vend të anëtar korrespondent Xhevdet Xhafa të caktohet akademik Rauf Dhomi. Për Xh. Xhafën ai tha se për arsye shëndetësore nuk mund të marrë pjesë në mbledhje.

Diskutuan shumica e anëtarëve të pranishëm të Kryesisë dhe u tha që kërkesa nuk mund të realizohet sepse komisioni nuk mund të funksionojë pa një anëtar të fushës së artit pamor, përkatësisht pa piktur.

XIX. Më 30 shtator në mbledhjen e saj Kryesia diskutoi për Platformën e përbashkët ASHAK-ASHSH për *Enciklopedinë Shqiptare*. Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se në mbledhjet e seksioneve në të cilat është shqyrtuar Platforma janë paraqitur disa propozime të cilat do t'i shqyrtojmë me radhë.

Nga SGJL-ja është propozuar që:

1. Faqja 2, (Realizimi i projektit) paragrafi 1, rreshti 3 të hiqet fjala “normative”;
2. Faqja 2, (Përfshirja e lëndës enciklopedike) paragrafi 1, rreshti 3 ku shkruan “pas Kosovës” të shtohet “dhe botën shqiptare”;
3. Faqja 6, pika 4, Rregulloren ta miratojë Kuvendi i Akademisë, jo Kryesia.

Nga SSHSH-ja është propozuar që:

1. Faqja 5 (Redaksitë fushave), te paragrafi 1 të shtohet që redaktorët dhe redaksitë e fushave i propozojnë seksionet dhe i miraton Redaksia vendore;
2. Të përcaktohet me rregullat e brendshme të ASHAK-ut ngritja e këshillit të Enciklopedisë Shqiptare, nga Kryesia e Akademisë i cili do të propozojë kryeredaktorin të cilin e zgjedh më pas Kuvendi i ASHAK-ut;
3. Në platformë të shënohen emrat e grupit punues.

Nga SSHN-ja është propozuar që:

1. Faqja 4 (Redaksia qendrore), paragrafi 5, të shtohet që selia e Redaksisë qendrore të jetë dhe në Prishtinë, e jo vetëm në Tiranë;
2. Faqja 7, pika 10, “caktohen redaktorët e teksteve”, të shtohet “prej të dy redaksive respektive”.

Seksioni i Arteve nuk ka paraqitur vërejtje.

Diskutuan me radhë të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe pas diskutimeve u vendos të merren parasysh këto ndryshime në Platformë:

Propozimi 2 dhe 3 nga SGJL-ja, propozimi 2 dhe 3 i SSHSH.

Propozimi 1 i SGJL-së nuk u pranua (kundër S. Hamiti); Propozimi 1 i SHSSH nuk u pranua meqë u tha se zgjedhja e redaktorëve dhe redaksive të fushave përcaktohet me Rregullore përkatëse të cilën e miraton Kuvendi i Akademisë; Propozimi 1 i SSHN nuk u pranua, sepse u tha që kjo çështje është e rregulluar me Marrëveshjen e dy qeverive, ndërsa propozimi 2 nuk u pranua, sepse u tha që caktimi i redaktorëve të teksteve është kompetencë e Redaksisë qendrore.

Platforma e lartcekur me ndryshimet sipas propozimeve të pranuar nga seksionet u miratua dhe u tha që bashkë me Rregulloren do t’i dërgohen për miratim Kuvendit të ASHAK-ut.

Kryetari Kraja tha se mbledhja e Kuvendit do të thirret pasi të harmonizohen disa pika të Rregullores me palën e ASHSH-së.

Kryetari Kraja po ashtu e njoftoi Kryesinë me emrat e të propozuarve nga seksionet për anëtarë të redaksive të Enciklopedisë Shqiptare, si në vijim: SGJL-ja ka propozuar akademikët Rexhep Ismajli dhe Sabri Hamiti; SHSHS ka propozuar akademikët Jusuf Bajraktari dhe Anton K. Berishaj; SSHN ka propozuar akademikët Nexhat Daci dhe Fejzullah Krasniqi dhe SA ka propozuar akademik Rauf Dhomin dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqin.

Zgjedhja e anëtarëve të propozuar do të bëhet nga Kuvendi i Akademisë në mbledhjen e radhës.

Në vazhdim të mbledhjes Kryesia ngriti Këshillin e *Enciklopedisë Shqiptare*, me këtë përbërje:

1. Akademik Ali Aliu, Kryetar
2. Akademik Feriz Krasniqi, anëtar

3. Akademik Tahir Emra, anëtar
4. Akademik Isa Mustafa, anëtar
5. Akademik Eqrem Basha, anëtar

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

- a) E shqyrtoi kërkesën e anëtarit korrespondent Bardh Rugova për udhëtimin zyrtar në Zarinë. Kërkesa u miratua. U tha që shpenzimet e karburantit (meqë udhëtohet me veturë private) mbulohen pas paraqitjes së faturave përkatëse;
- b) U njoftua për mbajtjen e ligjërates së përfaqësuesit të Akademisë së Shkencave të Austrisë, Mag.dr. Joachim Matzinger. U tha se ligjëratat do të mbahet më 6 tetor. Nga Akademia Austriake vijnë dy veta për të cilët Akademia i mbulon shpenzimet e akomodimit për një natë;
- c) U njoftua me shkresën e akademik Rexhep Ismajlit se anëtari i jashtëm i ASHAK-ut Brian Joseph do të marrë pjesë në promovimin e librit të tij, më 7 nëntor 2022, dhe me këtë rast atij do t'i jepet Fletëdëshmia e zgjedhjes anëtar i jashtëm i ASHAK-ut. Po ashtu edhe anëtarja e jashtme, Irena Sawicka, do ta vizitojë Akademinë më 21-23 nëntor 2022 dhe asaj do t'i dorëzohet Fletëdëshmia e zgjedhjes anëtare e jashtme e ASHAK-ut. U tha që Akademia mbulon vetëm shpenzimet e akomodimit nga dy net për secilin prej tyre;
- d) Mori vendim që me rastin e promovimit të botimit të akademik Vasil S. Tole: "Çesk Zadeja në muzikën shqiptare", të shfaqet një program i shkurtër artistik- ekzekutim i veprave të Zadesë.

- e) U njoftua për rregullimin e oborrit para ndërtesës së ASHAK-ut. Meqë Ministria përkatëse dhe Komuna e Prishtinës nuk janë përgjigjur pozitivisht, kanë filluar procedurat dhe punët për rregullimin e oborrit;
- f) Diskutoi për mbajtjen e mbledhjeve të seksioneve për shqyrtimin e shkallës së realizimit të Programit të punës së tyre për vitin 2022. U tha që mbledhjet me këtë pikë të rendit të ditës të mbahen më së largu deri në javën e parë të muajit nëntor 2022;
- g) U njoftua se janë rirregulluar fotografitë e kryetarëve të ASHAK-ut në katin përdhës.

XX. Mbledhja e radhës së Kryesisë u mbajt më 17 tetor. Në këtë mbledhje u diskutua për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Akademisë. Kryetari Kraja njoftoi se Platforma dhe Rregullorja janë shqyrtuar tani më disa herë nga Kryesia, janë harmonizuar pika kontestuese me ASHSH-në dhe tani janë të gatshme t'i dërgohen për miratim Kuvendit të Akademisë. Ai po ashtu tha se Këshilli i Enciklopedisë ka mbajtur mbledhje në të cilën kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët dhe e kanë bërë propozimin për Kryeredaktorin e Enciklopedisë. Diskutuan shumica e anëtarëve të Kryesisë dhe u vendos që mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Akademisë të mbahet më 27 tetor 2022, ora 11:00, me këtë rend të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CVII të Kuvendit të Akademisë; Miratimi i Platformës së përbashkët (ASHAK-ASHSH) për Enciklopedinë Shqiptare; Miratimi i Rregullores për mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të Redaksisë qendrore, të redaksive

vendore dhe të redaksive të fushave të Enciklopedisë Shqiptare; Zgjedhja e Kryeredaktorit dhe e anëtarëve të Redaksisë qendrore dhe të Redaksisë vendore të Enciklopedisë Shqiptare.

Në vazhdim u shqyrtua ndarja e mjeteve buxhetore sipas Qarkores II buxhetore, 2023-2025. L. Pula me kërkesë të Kryetarit, e njoftoi Kryesinë se ndarja e mjeteve buxhetore është bërë fillimisht sipas Qarkores I buxhetore, por marrë parasysh disa rrethana duhen bërë disa lëvizje, duke marrë mjete nga disa kode e duke i transferuar ato në disa kode të tjera. Duhet shtuar te kodi i drekave zyrtare dhe akomodimi, kjo për arsye se në vitin 2023 janë paraparë më shumë aktivitete shkencore dhe artistike.

S. Hamiti në diskutimin e tij shtroi pyetjen se sa ka mjete të dedikuara për projekte? Ai tha se për projektin e tij ende nuk është realizuar asnjë pagesë. Kryetari Kraja tha se sa u përket pagesave të projektit për këtë vit ato realizohen pasi të paraqitet raporti i punës. Ndërsa sa u përket mjeteve të parapara për vitin 2023, rreth 30 % e buxhetit të ASHAK-ut ndahet për kategorinë shërbime intelektuale këshillëdhënëse dhe se nga ajo kategori realizohen pagesat e honorarëve të autorit dhe pagesat për projekte. Ai tha se vlera është e mjaftueshme, por në rast se nuk mjafton bëhen lëvizje gjithnjë në përputhje me normat ligjore.

Ndarja e mjeteve buxhetore u miratua. Më pas Kryetari e njoftoi Kryesinë se bashkë me këtë dokument që u miratua, në Ministrinë e Financave duhet të paraqesim edhe kërkesën për mjete shtesë për Enciklopedinë Shqiptare. Ai propozoi që vlera e mjeteve shtesë të jetë 250.000.00€ për

vitin 2023. Propozimi u miratua nga anëtarët e Kryesisë dhe u vendos që prej 25.000.00€, në kategorinë mallra dhe shërbime të ndahen 225,000.00€, ndërsa në kategorinë paga dhe mëditje (për kompensimin e stafit nga administrata) të ndahen 25.000€.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia e shqyrtoi kërkesën e akademik Vasil Tole për ribotimin e librit: "Çesk Zadeja në muzikën shqiptare".

Marrë parasysh Rregulloren e ASHAK-ut dhe faktin që ka ende kopje të librit në dispozicion, Kryesia vendosi që kërkesa për ribotim të merret në shqyrtim në vitin 2023.

Dhe në fund Kryesia:

a) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të kryetarit Kraja me bashkëpunëtorë, me rastin e pjesëmarrjes në shënimin e 50-vjetorit të ASHSH-së, në Tiranë, më 9-11 tetor 2022;

b) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të Fetah Podvoricës, me rastin e pjesëmarrjes në Konferencën ndërkombëtare të tendencave në nanoteknologji, më 3-7 tetor 2022;

c) U njoftua nga L. Pula se masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për kursimin e energjisë kanë hyrë në fuqi dhe të gjitha institucionet e vendit duhet t'i zbatojnë. Ajo tha se një zyrtar nga administrata do të caktohet të përcjellë zbatimin e masave, por se obligim i të gjithëve është të kujdesen për zyrat e tyre, duke i fikur dritat, pajisjet kompjuterike, ngrohëset dhe çfarëdo pajisjeje tjetër që shpenzon energji.

XXI. Në mbledhjen e datës 8 nëntor Kryesia e shqyrtoi Aktvendimin e

Gjykatës Themelore Prishtinë, A. nr. 2300/20, të pranuar nga ASHAK-u më 03.11.2022, me nr. 856. Kryetari Kraja tha se lënda ka të bëjë me ankesën e z. Xhemshit Brajshori, punonjës në ASHAK. Ai propozoi që avokati z. Bajram Morina i cili është angazhuar kohë më parë për një lëndë tjetër të ASHAK-ut të caktohet avokat edhe për këtë rast. Propozimi u miratua. U tha që të përgatiten dokumentet e nevojshme për avokatin në fjalë.

Më pas Kryesia:

a) U njoftua nga L. Pula se pas kërkesës së ASHAK-ut drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike për punimin e vulave, Ministria e ka miratuar punimin e vetëm një vule katrore, ndërsa nuk ka dhënë miratimin për punimin e vulës tjetër katrore me shënimin “Dhuratë” e cila u vihet botimeve të Akademisë, sipas Rregullores për veprimtarinë botuese. Marrë parasysh këtë fakt Kryesia vendosi që botimeve të Akademisë në vend të vulës t’u vihet etiketa me logo të saj dhe me shënimin “Dhuratë”;

b) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar për qëndrimin e akademikëve Rexhep Ismajli dhe Sabri Hamiti në Slloveni, më 24-26 nëntor 2022, me ç’rast S. Hamiti mbajti ligjëratën me titull: “ Letërsia shqipe e shekullit XXI”;

c) U njoftua nga L. Pula se në mbledhjen e fundit të Seksionit të Shkencave të Natyrës, akademik Minir Dushi ka propozuar që Kryesia të shqyrtojë mundësinë e blerjes së veprave enciklopedike të ish-Jugosllavisë dhe vendeve të tjera të rajonit, të cilat do të shërbenin në këtë fazë kur po fillon projekti për hartimin e Enciklopedisë Shqiptare. Kryetari Kraja tha se fillimisht zyrtarët e

Bibliotekës të hulumtojnë tregun dhe t’i paraqesin Kryesisë propozimet për veprat në fjalë dhe më pas Kryesia të vendosë për blerjen e tyre;

d) U njoftua nga Gj. Mushkolaj për punën e Këshillit për bashkëpunim ndërkombëtar të ASHAK-ut. Gj. Mushkolaj tha se në një nga mbledhjet vijuese të Kryesisë do të paraqesë raport me shkrim për punën e Këshillit.

XXII. Në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor Kryesia e shqyrtoi shkallën e realizimit të programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2022. Kryetari Kraja njoftoi se shkalla e realizimit të programit të punës është shqyrtuar në mbledhjet e seksioneve përkatëse dhe sot e kemi dokumentin e plotë për të gjitha seksionet. Ai më pas tërhoqi vërejtje për punën e projekteve dhe tha se nuk mund të punohet në projekte të reja pa përfunduar projektet e paraqitura vite më parë. Ai kërkoi nga sekretarët e seksioneve që për të gjitha projektet e papërfunduara të hartojnë raporte me shkrim. Në raporte të paraqitet puna e bërë dhe se çfarë planifikohet të bëhet. Të gjitha këto më pas të paraqiten në raportin vjetor të punës që miratohet në vitin 2023.

Për shkallën e realizimit të programit të punës diskutuan me radhë sekretarët e seksioneve. S. Hamiti tha se programi i SGJL-së ka arritur të realizohet në tërësi, janë dorëzuar të gjitha dorëshkrimet e parapara për botim dhe janë paraqitur raportet e punës së projekteve. Sa u përket raporteve për projektet e papërfunduara, ai tha se do t’i paraqesë në raportin vjetor të punës. Gj. Mushkolaj tha se në SSHSH kanë mbetur pa u dorëzuar dy dorëshkrime dhe nga autorët ka marrë

konfirmimin se do të dorëzohen gjatë kësaj jave. Për raportet e projekteve të papërfunduara edhe ajo tha se do të punojë në këtë drejtim, ashtu që t'i paraqesë në raportin vjetor të punës. F. Podvorica në diskutimin e tij tha se dy dorëshkrime (përmbledhjet e punimeve të tryezës shkencore dhe të konferencës) nuk do të botohen, sepse autorët e tyre nuk mund t'i dërgojnë materialet meqë i kanë botuar më parë dhe nuk u lejohet nga botuesi.

Për realizimin e programit të punës së SA, diskutoi L. Mulliqi. Ai tha se deri në fund të vitit do të realizohen të gjitha pikat e programit të punës, përveç dorëshkrimit të R. Dhomit, meqë autori për arsye shëndetësore nuk po arrin ta përfundojë.

Lidhur me çështjen e botimit të përmbledhjeve të aktiviteteve shkencore u tha që në të ardhmen sekretarët e seksioneve të kenë më shumë kujdes dhe paraprakisht të sqarojnë çështjen e botimit të tyre.

Pas diskutimeve Kryesia e miratoi shkallën e realizimit të programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2022, e cila do të jetë pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Në vazhdim u shqyrtua raporti i projektit Historia e letërsisë shqipe. U tha se raporti është i plotë dhe me të gjitha dokumentet përcjellëse që kërkohen.

Raporti u miratua dhe Kryesia mori vendim për realizimin e pagesave për personat e angazhuar në projekt.

Kryesia e shqyrtoi edhe raportin e projektit "Zhvillimi i aftësive konkurruese të ekonomisë së Kosovës". Diskutuan M. Kraja, J. Sh. Pula dhe F. Podvorica.

M. Kraja tha se raporti është i plotë, por kërkoi sqarime nga J. Sh. Pula për vlerën prej 6.000.00€ për njërin nga të angazhuarit, duke thënë se vlera është e lartë. J. Sh. Pula dha sqarimet e nevojshme duke thënë se personi në fjalë është marrë me zhvillimin e anketës dhe ka pasur punë të shtuara sidomos në terren.

F. Podvorica shtroi pyetjen se a do të jenë vlerat e pagesave njëjtë të larta edhe në fazën e dytë të projektit, meqë siç tha ai, ka shumë projekte dhe duhet planifikuar me kohë realizimin e pagesave. J. Sh. Pula duke iu përgjigjur F. Podvoricës, tha se pagesat për vitin tjetër do të jenë më të ulëta.

Pas diskutimeve Kryesia e miratoi raportin në fjalë dhe mori vendim për realizimin e pagesave për personat e angazhuar në projekt.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje u diskutua për organizimin e koncertit tradicional të fundvitit Kryetari Kraja njoftoi se koncerti do të mbahet më 20 dhjetor, programi i tij është finalizuar dhe janë caktuar interpretët dhe instrumentistët. Pas njoftimit të Kryetarit, Kryesia mori vendim për realizimin e pagesave për pjesëmarrësit në koncert.

Dhe në fund Kryesia :

a) Mori vendim të realizohen pagesat për personat e angazhuar për organizimin e ekspozitës së autorit Eshref Qahili.

b) Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të Rexhep Ismajlit, Bardh Rugovës dhe Shkumbin Munishit për qëndrimin e tyre në Zarë- Kroaci, për punët e projektit Arbnishtja e Zarës, prej 8-15 tetor 2022;

c) Miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të M. Krajës me bashkëpunëtorë, për qëndrimin e tyre në Tiranë, me qëllim të pjesëmarrjes në ceremoninë e shënimit të 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, më 9-11 nëntor 2022.

Njëherësh, në kuadër të po kësaj pike të rendit të ditës, kryetari Kraja foli për blerjen e veprave artistike Ai tha që Komisioni për blerjen e veprave artistike të mbledhet dhe të vendosë për këtë çështje, sepse për vitin 2022 janë planifikuar mjetet financiare në vlerë prej 8.000.00€ dhe deri më tani nuk është shpenzuar asgjë. Ai po ashtu tha se autorit Eshref Qahili, me rastin e ekspozitës së tij personale që e organizon ASHAK-u , t'i blihet një vepër artistike nga mjetet e planifikuara për këtë vit, ndërsa me pjesën tjetër të mjeteve të blihet ndonjë vepër tjetër, sipas përzgjedhjes së komisionit.

L. Mulliqi në diskutimin e tij tha se puna e Komisionit për blerjen e veprave artistike nuk po ecën mirë dhe propozoi të ndryshohet përbërja e tij, duke shtuar edhe ndonjë anëtar jashtë Akademisë.

Kryetari Kraja në fund propozoi që kjo çështje të diskutohet në një mbledhje të radhës të Kryesisë.

XXIII. Në mbledhjen e datës 5 dhjetor Kryesia diskutoi për disa çështje që lidhen me veprimtarinë botuese të ASHAK-ut. Kryetari Kraja tha se ka vërejtur disa raste që redaktorët e dorëshkrimeve caktohen edhe recensentë për të njëjtat dorëshkrime. Ai propozoi që kjo çështje të rregullohet me vendim të Kryesisë. Propozimi u miratua njëzëri dhe Kryesia mori këtë vendim:

I. Redaktorët e dorëshkrimeve të ASHAK-ut (sekretarët e seksioneve) nuk mund

të kenë njëkohësisht dy angazhime brenda një dorëshkrimi;

II. Në rastet kur redaktori i dorëshkrimit caktohet recensent për një dorëshkrim,

seksioni përkatës me vendim vetëm për atë rast, cakton një redaktor tjetër nga radhët e veta;

III. Në rastet kur sekretari i seksionit përkatës është autor i dorëshkrimit, seksioni

me vendim vetëm për atë rast, cakton një tjetër redaktor nga radhët e veta;

IV. Ky vendim zbatohet edhe në raste të tjera, me qëllim që në të gjitha dorëshkrimet e ASHAK-ut një person të mos ketë dy angazhime.

Kryetari Kraja diskutoi edhe për disa botime të fundit të Akademisë dhe tha se sekretarët e seksioneve përkatëse duke qenë edhe redaktorë të dorëshkrimeve të tyre, të merren më shumë me dorëshkrime, në mënyrë që të kemi botime më cilësore, siç i takon institucionit.

Diskutoi edhe F. Podvorica i cili njoftoi se në një mbledhje të radhës do të kemi nevojë të diskutojmë për kriteret e përfshirjes së punimeve në revistat shkencore të Akademisë. Ai më pas njoftoi se MASHTI ka filluar hartimin e një udhëzimi administrativ dhe sapo të kemi njoftim më të saktë duhet të shohim edhe përfshirjen e ASHAK-ut.

Në vazhdim u diskutua çështja e Komisionit të ASHAK-ut për blerjen e veprave artistike. Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë se pas hapjes së ekspozitës së autorit Eshref Qahili, Akademia sipas rregullit do të duhej të

blejë një vepër të tij për pasurimin e fondit artistik të saj. Ai tha se mjete financiare ka, por duhet të shpejtohet me marrjen e vendimit për përzgjedhjen e veprës, meqë deri në fund të javës mbyllen afatet për zotimin e mjeteve financiare. Ai në vazhdim tha se L. Mulliqi është deklaruar se nuk mund të jetë kryesues e komisionit aktual, se nuk mund të punojë me këtë komision dhe se është i gatshëm të japë dorëheqje. Ai propozoi që kësaj radhe të mblidhet komisioni edhe pa L. Mulliqin, por gjithnjë nëse ka kuorum dhe të përzgjedhë një vepër të Qahilit për blerje, ndërsa në fillim të vitit tjetër Kryesia të diskutojë për zgjedhjen e kryesuesit të ri. L. Mulliqi në fjalën e tij tha se qëllimi i kryetarit duket është të ndërrojë kryesuesin e komisionit. Ai më pas tha se ky komision me këtë përbërje nuk mund të funksionojë dhe se ai vetë nuk mund të punojë me amatorë, si dhe propozoi të ndryshohet përbërja e komisionit, ashtu që në vend të Xhevdet Xhafës të zgjidhet Eqrem Basha apo Bardh Rugova. Fjalën e mori S. Hamiti i cili shprehu indinjatë për cilësimin e anëtarëve të komisionit si amatorë, sepse, siç tha ai, në Akademi nuk ka amatorë. L. Mulliqi tha se kërkon falje për këtë shprehje dhe se nuk e ka për qëllim të ofendojë askënd, por se mendon që në komision duhet të ketë njerëz që janë më profesionalë. S. Hamiti e mori prapë fjalën dhe tha se nuk e ndryshon mendimin e tij dhe se në komision ka persona të mirë dhe që dinë të zgjedhin. Ai tha se ekspozita e Qahilit është shumë e mirë dhe se komisioni nuk e ka fare të vështirë të përzgjedhë një vepër për fondin e Akademisë.

Kryetari Kraja tha se nuk ka qëllim ta ndërrojë kryesuesin e komisionit, por

se marrë parasysh që L. Mulliqi nuk është i gatshëm të punojë me këtë komision, propozoi që të mblidhet komisioni pa të dhe të bëjë përzgjedhjen e veprës së Qahilit. Ai tha se tani nuk mund të bëhen ndryshime të komisionit në mënyrë arbitrare, sepse ka mandat trevjeçar dhe duhet konsultuar njerëzit para se t'i ndërrojmë.

F. Podvorica në diskutimin e tij bëri vërejtje që nuk iu dha fjala disa herë edhe pse kërkoi të diskutojë dhe kërkoi nga anëtarët e Kryesisë të kenë respekt për njëri-tjetrin. Sa i përket çështjes së përbërjes së komisionit ai tha se pas diskutimeve që u bënë edhe ai mendon që komisioni të mos mblidhet pa kryesuesin e tij. Ai tha se L. Mulliqi vetë ka kërkuar të dorëhiqet dhe tani qëndrimi i tij për joprofesionalizëm të anëtarëve të komisionit është shqetësues për mbarëvajtjen e punës së tij. Ai propozoi që përzgjedhja për blerjen e veprës së Qahilit të shtyhet për vitin tjetër.

Kryetari Kraja pas diskutimeve propozoi që nëse L. Mulliqi pajtohet, le ta thërrasë mbledhjen e komisionit dhe të bëjnë përzgjedhjen e veprës së Qahilit. L. Mulliqi u pajtua dhe tha se meqë ka mjete Komisioni të mblidhet të bëjë përzgjedhjen për veprën e Qahilit dhe të vendosë për blerjen e veprës së Violeta Xhaferit. Kryetari Kraja me këtë rast ndërhyri dhe tha se Komisioni nuk ka dhënë pëlqim për blerjen e veprës së Violeta Xhaferit, kjo çështje është mbyllur dhe nuk ka pse diskutohet prapë.

L. Mulliqi tha se Komisioni nuk ka marrë vendim dhe e ka lënë të hapur këtë çështje dhe tha se nuk pranon ta mbledhë komisionin me ndërhyrje të tilla.

Pas diskutimeve Kryesia vendosi që çështja e blerjes së veprës së Qahilit dhe përbërja e komisionit të shtyhen për vitin tjetër.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës, Kryesia:

- a) U njoftua nga kryetari Kraja se më 15 dhjetor, ora 12:00 në mjediset e Akademisë do të hapet ekspozita: "Rrugëtimi i abetares shqip 1844-1942". Ekspozita do të organizohet në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe Qendrën kombëtare të librit dhe të leximit të Shqipërisë;
- b) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të anëtarëve të Akademisë dhe stafit të administratës, në Tiranë, me qëllim të pjesëmarrjes në Panairin e librit;
- c) Mori vendim që z. Eshref Qahilit t'i mbulohen shpenzimet ekspozitës së tij personale të organizuar nga ASHAK-u, pas paraqitjes së faturave përkatëse, kjo në përputhje me Rregulloren për organizimin e ekspozitave në ASHAK;
- d) U njoftua nga kryetari Kraja se në fund të dhjetorit do të organizohet dreka festive (për anëtarët e Akademisë dhe stafin e SHPAT) për nder të festave të fundvitit.

XXIV. Mbledhja e fundit e Kryesisë u mbajt më 20 dhjetor. Në këtë mbledhje para fillimit të shqyrtimit të pikave të rendit të ditës kryetari Kraja tha se kjo mbledhje mund të jetë e fundit për këtë vit dhe shtoi se puna gjatë këtij viti në përgjithësi ka ecur mirë, përjashtimisht disa vonesave për dorëzimin e dorëshkrimeve të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe vonesave në blerjen e pikturës së E. Qahilit.

Më pas filloi shqyrtimi i pikave të rendit të ditës.

Procesverbali i mbledhjes XXIII të Kryesisë së Akademisë u miratua pa vërejtje.

Kryesia e shqyrtoi raportin e grupit punues për menaxhimin e rrezikut. Grupi ka konstatuar se nuk ka pasur ndonjë rrezik që lidhet me funksionimin e veprimtarisë së Akademisë. Raporti bashkë me regjistrin e rrezikut u miratua pa vërejtje.

Kryetari Kraja e njoftoi Kryesinë me vendimin e Seksionit të Arteve për caktimin e ushtruesit të detyrës së sekretarit për periudhën janar-qershor 2023. Ai shtroi dilemën e tij që ushtrues detyre është caktuar akademik Rauf Dhomi dhe vendimin e ka nënshkruar ai vetë. L. Pula me kërkesë të Kryetarit e njoftoi Kryesinë me rrjedhën e mbledhjes së Seksionit të Arteve. Ajo tha se kuorum ka pasur, meqë familja e anëtarit korrespondent, Xhevdet Xhafa, ka njoftuar me shkrim se ai për një kohë do të qëndrojë jashtë vendit dhe nuk do të ketë mundësi të marrë pjesë nëpër mbledhje. Seksioni me tri vota për e ka caktuar R. Dhomin ushtrues të detyrës. Vendimin nuk ka pasur kush ta nënshkruajë tjetër, sepse ai është ushtrues detyre edhe tani. Ajo më pas e njoftoi Kryesinë se në fillim të mbledhjes së SA ka sqaruar procedurat e parapara për mbajtjen e mbledhjes dhe se e ka njoftuar Seksionin që ushtruesi i detyrës së sekretarit nuk mund të jetë i njëjti anëtar tri herë radhazi. Në mbledhje siç sqaroi ajo, kanë diskutuar anëtarët e pranishëm dhe që të gjithë janë pajtuar me njoftimin e saj, por që të gjithë kanë deklaruar se në rrethanat aktuale nuk ka zgjidhje tjetër për Seksionin. S.

Hamiti në diskutimin e tij tha se kjo çështje duhet të diskutohet me seriozitet, sepse situatë të njëjtë do të kemi edhe pas 6 muajve. Edhe F. Podvorica po ashtu tha se duhet të diskutohet kjo çështje me të gjithë anëtarët e Seksionit që të mos krijohen situata të pakëndshme.

Në vazhdim Kryesia bazuar në propozimin e Komisionit për blerjen e veprave artistike të ASHAK-ut mori vendim të blihet vepra artistike e autorit Eshref Qahili, me rastin e organizimit të ekspozitës së tij personale nga ASHAK-u: pikturë nga cikli Legjenda e kullave , dimensioni 150x99 cm, vaj në pëlhurë, 2021. U tha që kontrata me autorin për blerjen e veprës lidhet në vitin 2023 dhe pagesa të bëhet nga mjetet e buxhetit të ASHAK-ut për vitin 2023.

Kryesia vendosi të nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit ASHAK-IZUM për krijimin e sistemit bibliografik kombëtar për vlerësimin e rezultateve të kërkimit në Kosovë dhe që znj. Arta Kqiku t'i vazhdohet angazhimi për periudhën 1 janar 2023-31 dhjetor 2023, sipas kushteve të Marrëveshjes së lartpërmendur.

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, Kryesia:

a) Mori vendim që vula katrore e pranuar nga Komisioni për zhvillimin e procedurës për marrjen e lejes për punimin e vulave katrore, porositjen e vulave të vulëpunuesi, mbikëqyrjen e punës së vulëpunuesit, arkivimin e vulave, shpalljen e pavlefshme të vulave dhe veprime të tjera, hyn në përdorim më 21 dhjetor 2022; Znj. Dafina Kavaja, asistente ekzekutive autorizohet për përdorimin e të gjitha vulave të ASHAK-ut (vulës katrore dhe vulës rrumbullake) dhe me hyrjen në

përdorim të vulës katrore (21 dhjetor 2022) hyn në fuqi Vendimi i Kryesisë së Akademisë nr. 871/2, dt. 08.11.2022;

b) Mori vendim që z. Bahri Mjeku të angazhohet për punët teknike të Koncertit festiv që do të mbahet në ASHAK, më 20 dhjetor 2022 .

c) E miratoi raportin e udhëtimit zyrtar të Kryetarit të Akademisë, në Tiranë, më 11-13 dhjetor 2022, me qëllim të pjesëmarrjes në takimin e shpalljes së redaksive të projektit Enciklopedia Shqiptare;

d) U njoh me kërkesën e akademik Ali Aliut, për lejimin e udhëtimit në Shqipëri, më 14 dhjetor, me veturë të Akademisë, të drejtuar nga shoferi i saj.

SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTE

1.*Këshilli Ndërademik për Gjuhën Shqipe.* –Veprimtaria e *Këshillit Ndërademik për Gjuhën Shqipe* u inkuadrua sërish në Protokollin e bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Është vendosur të botohen të gjitha materialet e Këshillit që nga fillimi. Është angazhuar Bardh Rugova për procedim të mëtejshëm. Pritet që materialet të përgatiten sa më parë.

2.*Historia e letërsisë shqipe.* - Projekt afatmesëm për hartimin e Historisë së letërsisë shqipe. Mungesa e një vepre sintetizuese të nivelit akademik për letërsinë shqipe shtron nevojën e

domosdoshme kulturore, për hartimin e një teksti të Historisë së Letërsisë shqipe gjithëpërfshirëse, që nga fillimet deri në kohën e tashme. Trajta e veprës do të jetë e nivelit akademik, duke tejkaluar sprovat e përparme të trajtave të doracakëve shkollorë apo universitarë. Kriteret e hartimit të veprës do të jenë kriteret letrare dhe estetike. Kriteret e parashtruara nënkuptojnë evidencat/të dhënat letrare në një shtrirje kohore pesëshkullore, që nuk do të thotë krijimin e një kronologjie letrare. Kriteret e parashtruara nënkuptojnë trajtim autorësh, veprash e fenomenesh letrare shqipe, që synojnë krijimin e një sistemi letrar. Po këto kriteret bëjnë të mundshme zbulimin e fenomeneve letrare shqipe, trajtimin e shndërrimeve letrare dhe theksimin e përhershëmive letrare, që paraqet një proces letrar të mbrendashkruar. Përfundimisht, një vepër e këtillë sintetizuese e gjithëpërfshirëse përfshin dhe përmban komunikimet e brendshme të letërsisë shqipe dhe komunikimet e jashtme të kësaj letërsie, me letërsitë dhe kulturat e tjera. Përgjatë udhëtimit ditunor vepra *Historia e letërsisë shqipe* rizbulon aktin krijues letrar të letërsisë identitare, për të takuar e sprovuar universalitetin letrar, në nivel të komunikimit, krijimit të formave që shpalojnë idetë e domethëniet/kuptimet. Për realizimin e projektit *kapital Historia e letërsisë shqipe*, në Akademinë e Shkencave e të Arteve të Kosovës është ngritur paraprakisht një Grup i punës, i përbërë nga Sabri Hamiti, Rexhep Ismajli, Ali Aliu, Kujtim Shala e Nysret Krasniqi, për të krijuar themelet/bërthamën e platformës e të kriterëve të hartimit të veprës, po ashtu për të

udhëhequr punën për përfundimin e veprës.

Grupi i punës ka hartuar Platformën dhe Rregullat për punën në Projektin afatmesëm *Historia e letërsisë shqipe*, të cilat janë aprovuar në Seksionin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të ASHAK-ut. Grupi i punës, sipas rregullës ka zgjedhur Redaksinë e Projektit *Historia e letërsisë shqipe*, me këtë përbërje: Sabri Hamiti (kryeredaktor), Rexhep Ismajli, Ali Aliu, Kujtim Shala, Persida Asllani, Dhurata Shehri dhe Nysret Krasniqi (anëtarë të Redaksisë).

Në vijim Redaksia ka funksionalizuar punën duke zgjedhur redaktorët për kapitujt themelorë të Projektit *Historia e letërsisë shqipe*: Rexhep Ismajli për letërsinë e shekujve XVI-XVIII, Persida Asllani për letërsinë e shekullit XIX, Sabri Hamiti për letërsinë e shekullit XX dhe Ali Aliu për letërsinë e shekullit XXI. Deri më tash janë trajtuar tekstet e Historive të letërsisë shqipe, që nga fillimi deri më tash; është hartuar lista e zërave dhe kategorizimi i zërave sipas madhësisë.

Raporti vjetor për punën në projektin *Historia e letërsisë shqipe* është shqyrtuar dhe miratuar në Seksionin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe është miratuar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

3. *Leksikonët e termave të gjuhësisë.* - Projekti do të vazhdohet me Leksikonin e termave të gramatikës që parashihet të realizohet gjatë vitit 2022 dhe të kryhet brenda vitit 2023. Projekti i këtij leksikoni do të jetë më i madhi dhe më kompleksi nga fjalorët e hartuar deri më tash.

Projekti drejtohet nga Rexhep Ismajli, Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi.

4. *Vepra e plotë e Norbert Joklit*. – Viti 2022 parashihet të jetë vit përmbyllës i botimit të veprës së albanologut austriak Norbert Jokl, me veprën IV. Projekti parasheh edhe mbledhjen, sistemimin, përkthimin dhe botimin e artikujve dhe studimeve të Joklit.

Janë mbledhur të gjitha tekstat e Norbert Joklit për vëllimin IV. Përkthimi i tyre në shqip kërkon kohë më shumë. Botimi i vëllimit IV, përmbyllës, parashihet të dalë në pjesën e dytë të vitit 2023.

5. *Arbnishtja e Zarës* – rreziku i zhdukjes dhe gjasat e rimëkëmbjes. - Projekti merret me studimin e gjendjen e të folurit shqip të Zarës. Projekti udhëhiqet nga Bardh Rugova, me mbështetje të Rexhep Ismajlit.

Në këtë vit, nga data 8 nëntor deri në datën 14 nëntor është realizuar ekspedita hulumtuese në Zarë dhe janë grumbulluar materialet e folura për studim. Kërkohet edhe një vizitë hulumtuese në Arkivin e Vjenës. Pritet që studimi do të kryhet në vitin 2023.

6. *Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX*. – Gjatë dy viteve të fundit nuk ka pasur lëvizje rreth këtij projekti.

Nuk ka vazhduar puna me vjelje materialesh të reja. Materialet e skanuara janë në Akademi. Po ashtu vjelja e materialit që e ka kryer Nebi Caka. Bartësit e projektit e vlerësojnë punën e deritashme dhe për kurorëzimin e saj propozojnë krijimin e një ekipi për hartimin e Fjalorit mbështetur në materialet e mbledhura.

Nuk është krijuar ende ekipi i ri.

TUBIME SHKENCORE

1. *Kritika letrare shqipe / Fillimi i shekullit XXI*. - Konferencë shkencore, që do të mbahet në Prishtinë në muajin maj ose në muajin qershor të vitit 2022. Pjesëmarrës do të jenë kritikët shqiptarë bashkëkohorë apo të huaj që merren me letërsinë shqipe. Punimet e Konferencës do të botohen në libër të veçantë.

Konferenca shkencore *Kritika letrare shqipe/ Fillimi i shekullit XXI* është mbajtur 10 qershor 2022 në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Me kumtesa janë paraqitur rreth 20 kritikë dhe studiues të njohur të letërsisë shqipe.

2. Konferencat shkencore me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të drejtshkrimit (1972), të parapara me Protokollin e bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, 2022-2023.

a) Konferenca jubilarë është mbajtur në Tiranë, më 10 nëntor 2022.

b) Konferenca shkencore *Shqipja standarde sot* është mbajtur në Prishtinë, më 17 nëntor 2022. Në Konferencë kanë marrë pjesë studiues albanologë nga bota shqiptare.

Kontributet e Konferencës shkencore pritet të botohen në vitin 2023.

BOTIME

1. *Norbert Jokl, Studime dhe artikuj mbi gjuhën shqipe* - Vëllimi IV i veprave të Norbert Jokl-it është përgatitur në

përmbajtjen e tij, tekstet gjermanisht kryesisht dhe një pjesë e përkthimeve shqip janë gati. Përgatitjen e këtij vëllimi e bën akademik Rexhep Ismajli. Vëllimi pritet të dalë në gjysmën e dytë të vitit 2023.

2. *Kujtim Shala: Kryevepra e Fishtës*-libri është botuar.

3. *Selman Riza, Vepra, Vëllimi VI*. - ASHAK ka botuar deri tash 5 vëllime të veprës së S. Rizës.

Libri Selman Riza, Vepra 6, i përgatitur nga Rexhep Ismajli, është botuar.

4. Sabri Hamiti, *Stilografia (Letërsia e tashme)*. - Studimi për letërsinë aktuale shqipe të shkruar në botën shqiptare e në diasporë, duke përfshirë autorë e vepra të botuara në deceniet e para të shekullit XXI.

Libri i Sabri Hamitit me titull *Stilografia* është botuar.

5. Kujtim M. Shala, *Kënga e cjamin* - Është libër teorik për gjininë e tragjedisë, i shoqëruar dhe me interpretime të veprave konkrete të gjinisë së tragjedisë.

Libri është në përfundim. Është përfshirë në planin botues të vitit 2023.

6. Skënder Gashi, *Shtresime gjuhësore në leksikon e në toponiminë e Kosovës*.

Vepra e Skënder Gashit, *Shtresime gjuhësore në leksikon e në toponiminë e Kosovës*, është e gatshme për botim. Nuk është dorëzuar për shtyp për shkak të rregullimit të dokumentacionit të të drejtave të autorit nga familja.

7. *Kritika letrare shqipe / Fillimi i shekullit XXI*. – Botimi i punimeve të konferencës shkencore, Kritika dhe studimet letrare shqipe.

Vëllimi *Kritika dhe studimet letrare shqipe/ Fillimi i shekullit XXI* me punimet e konferencës së mbajtur më 10 qershor 2022, është botuar.

8. *Studimet albanistike në Francë*. – Konferencë shkencore e mbajtur në fund të tetorit 2021 në ASHAK.

Ka dalë nga shtypi libri *Studimet për shqiptarët në Francë*, që përmban kumtesat e mbajtura në këtë konferencë.

9. *Studime*, nr. 28. – Revista vjetore *Studime* që e boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, me kontribute, studime shkencore e artikuj nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë, në shqip dhe në gjuhë të tjera. Ka dalë numri 28 i revistës *Studime*.

Është i gatshëm për botim numri 29 i revistës *Studime*.

PROMOVIME

1. *Vepra e plotë e Ali Podrimjes*, u promovua në kuadër të Panairit të librit akademik, në Qendrën e librit në Tiranë, më 24 prill 2022.

2. *Studimet për shqiptarët në Francë*, u promovua në mjediset e ASHAK-ut, më 15 qershor 2022.

3. Brian Joseph, *Vështrime albanoballkanologjike*, u promovua në mjediset e ASHAK-ut, më 7 nëntor 2022.

4.Sabri Hamiti, *Stilografia*, u promovua në kuadër të Panairit të librit në Tiranë, më 19 nëntor 2022.

VEPRIMTARI AKADEMIKE TË ANËTARËVE TË SEKSIONIT

1.Rexhep Ismajli ka mbajtur ligjëratat:

-*Dija albanologjike e Joklit një shekull më vonë*, në Konferencën shkencore me rastin e 80-vjetorit të Norbert Joklit, në Univeristetin e Vjenës, më 3 maj 2022.

- *Çështja e periodizimit të historisë së shqipes në vështrimet e Seit Mansakut*, në ASA, në Konferencën shkencore me rastin e 80-vjetorit të Seit Mansakut, në Tiranë, më 27 maj 2022;

-*Prejardhja e shqipes: Ëngjëll Mashi dy shekuj më vonë*, në Konferencën shkencore me rastin e 200-vjetorit të vdekjes së Angelo Mascit, në Universitetin e Napolit, më 20-21 qershor 2022.

-*Studimet albanistike në ish-Jugosllavi*, në ASA, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, në prani të punonjësve dhe kërkuesve shkencorë, në Tiranë, më 20 tetor 2022.

2.Sabri Hamiti ka mbajtur ligjëratat:

-*Ligjërimi poetik katolik i Pjetër Bogdanit*, në Krumë me rastin e përrurimit të përmendores së Pjetër Bogdanit, më 28 prill 2022.

-*Brevarium i letërsisë shqipe*, cikël ligjëratash, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, para studentëve master dhe

doktorantë, në Tiranë, më 8-12 maj 2022.

- *Letërsia shqipe në shekullin XXI*, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë, në Lubjanë, më 25 tetor 2022.

-*Poeta Naturae*, në Konferencën: *Letërsia shqipe dhe natyra*, në Universitetin e Tiranës, më 15 dhjetor 2022.

3.Kujtim Shala ka mbajtur ligjëratat:

- *Retorika: kushtet e ligjërimin*, në Fakultetin e Histori-Filologjisë, Tiranë, më 13 maj 2022.

- *Tat Tanushi... i Kutelit*, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, më 8 korrik 2022.

- *Ideologjia e letërsisë: rasti i Zef Pllumit*, në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsisë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, më 16 gusht 2002.

- *Natura naturata*, në Konferencën ndërkombëtare Letërsia shqipe dhe natyra, Fakulteti i Histori-Filologjisë, Tiranë, më 15 dhjetor 2022.

4. Nysret Krasniqi ka botuar punimet shkencore në revistat shkencore ndërkombëtare:

-*Genuine Hermeneutics in the Canon of Literature*, në revistën *Phainomena – Journal of Phenomenology and Hermeneutics*, Volume 31/12-121, 2022, ff. 399-416, (https://www.phainomena.com/wp-content/uploads/2022/08/18_E-PHI-

120-121_Krasniqi.pdf) e indeksuar në Scopus dhe në Web of Science. Revista Phenomena botohet nga Shoqata e Fenomenologëve të Sllovenisë në kuadër të Institutit Slloven të Humaniteteve.

- Sema and soma in the poems about death by Constantine P. Cavafy, në revisten Anafora, Volume 9, Number 2, 2022, ff. 265-283, (<https://hrcak.srce.hr/en/file/421995>) e indeksuar në Scopus dhe në Web of Science. Revista *Anafora* botohet nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Sociale i Universitetit të Osijekut në Kroaci.

5. Zejnullah Rrahmani ka promovuar veprat letrare: *Djemtë e Ballovcit* dhe *Deti i Zi*, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, më 23 shtator 2022, me pjesëmarrje dhe me ligjërime për veprën e tij, të anëtarëve të ASHAK-ut.

6. Brian Joseph ka mbajtur ligjëratën: *Pse është gjuha shqipe e rëndësishme për gjuhësinë?* në mjediset e ASHAK-ut, me rastin e dorëzimit të Fletëdëshmisë për zgjedhjen e tij anëtar i jashtëm e ASHAK-ut, më 7 nëntor 2022.

7. Irena Sawicka ka mbajtur ligjëratën: *Izokronia në gjuhën shqipe*, në mjediset e ASHAK-ut, me rastin e dorëzimit të Fletëdëshmisë për zgjedhjen e saj anëtare e jashtme e ASHAK-ut, më 22 nëntor 2022.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

PROJEKTE

1. Zhvillimi i aftësive konkurruese të ekonomisë së Kosovës (Projekt dyvjeçar).

Në vitin e parë (2022) është realizuar rishikimi i literaturës dhe dokumenteve relevante, përpilimi i instrumentit hulumtues/pyetësorit, implementimi i hulumtimit në terren ndërtimi i indeksit të konkurrencës së ekonomisë së Kosovës, si dhe hartimi i raportit kërkimor.

Faza e parë e Projektit ka përfunduar dhe se Raporti është miratuar nga Seksioni dhe nga Kryesia e Akademisë.

TUBIME SHKENCORE

1. Tryeza shkencore "Institucionalizimi i Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992" me bartës të aktivitetit, akademik Jusuf Bajraktari dhe anëtar korrespondent Frashër Demaj, është mbajtur më 24 maj 2022.

2. Konferenca shkencore ndërkombëtare "Roli i këmbimit të dhuratave në konstituimin e lidhjeve sociale" është mbajtur më 28 tetor 2022.

Bartës të aktivitetit ishin akademik Anton K. Berishaj dhe akademik Muhamedin Kullashi.

BOTIME

1. Muhamedin Kullashi: "Kosova në fushën e diplomacisë në Francë 2008-2016. Libri është botuar.

2. Akademik Isa Mustafa, akademike Justina Shiroka-Pula, anëtar korrespondent Besnik A. Krasniqi: “Ekonomia në hije: trajtim teorik dhe empirik”. Libri është botuar.

3. Arsim Bajrami: “Aspekte juridike të gjenocidit serb në Kosovë”. Dorëshkrimi është dorëzuar, është lekturuar dhe pritet të shkojë në shtyp.

4. Zhvillimi i aftësive konkurruese të ekonomisë së Kosovës. –Megjithëse fillimisht ishte paraparë që rezultatet e fazës së parë të projektit të botohen në një vëllim në vitin 2022, pas analizës së bartësve të projektit është konstatuar që rezultatet e projektit të botohen pasi të përfundojë e gjithë puna në projekt. Për këtë arsye botimi i dy vëllimeve, në dy gjuhë (shqipe dhe angleze) ka hyrë në programin e punës së Seksionit për vitin 2023.

5. Kontributet e tryezës shkencore:” Institucionalizimi i Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992, janë botuar.

6. Revista “Studime shoqërore”, nr. 9 - revistë vjetore në të cilën botohen studime dhe artikuj shkencor, tekste ligjëratash inauguruese, vështrime, recensione e kritika, etj. nga disiplinat e shkencave shoqërore. Revista është botuar.

Sekretare e Seksionit

Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. Platformë për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik Kosovë-Shqipëri.

Projekt i përbashkët dyvjeçar në mes ASHAK-ut dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në sektorin e energjisë i cili ka filluar së zbatuari në vitin 2022. Ky projekt ka qëllim për të hulumtuar dhe analizuar në shkallë të gjerë kapacitetet prodhuese energjetike në të dy vendet së bashku me ekspertët e lëmive të ndryshme dhe me institucionet relevante qeveritare në mënyrë që pastaj të përgatitet një platformë e përbashkët energjetike për zhvillim të qëndrueshëm të sistemit energjetik në të dy vendet. Gjatë këtij viti, grupet punuese janë takuar 2 herë më 27 maj dhe me 15 tetor 2022 në Prishtinë.

Në takimin e parë janë paraqitur nga të dy palët të dhëna për gjendjen dhe problemet e sistemeve energjetike në të dy vendet dhe për dokumentet strategjike.

Në takimin e dytë është diskutuar për kuadrin ligjor, nevojat për një bashkëpunim të shtuar në mënyrë që të shfrytëzohen maksimalisht burimet e të dy vendeve në kuadër të tranzicionit energjetik. Problem aktualisht për grupin punues të ASHSH-së paraqet mungesa e të dhënave të investimeve të sektorit privat në burime të ripërtritshme, si dhe angazhimi i shtetit shqiptar në iniciativat e ndryshme rajonale dhe më gjerë. Aktualisht janë duke i grumbulluar informacionet nga

subjektet e ndryshme dhe tjetër problem për gjetjen e një opsioni më të mirë për stabilizim të sektorit energjetik të gjendjes e paraqet situata globale në tregun energjetik e cila varet në masë të madhe prej zhvillimeve në luftën në Ukrainë dhe gjetjes së zgjidhjeve për situata emergjente.

Grupet punuese, në vitin 2023, do të vazhdojnë punën dhe do të analizojnë opsionet më të mira për të përgatitur, po qe se do të jetë e mundur, një platformë të përbashkët në sektorin energjetik, duke përfshirë edhe investimet strategjike në Kosovë dhe Shqipëri, e cila do të mundësonte shfrytëzimin e potencialeve energjetike të të dy vendeve dhe rritjen e prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve të ripërtitshme.

2. Pilot projekti “Studimi i ndryshimeve mjedisore me përdorimin e imazheve satelitore në një segment të zonës ndërkufitare Shqipëri – Kosovë” i propozuar si pjesë e Protokollit për Zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shkencor dhe Artistik ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës 2020-22, (pika 14: Studimi i ndryshimeve mjedisore me imazhet satelitore (përfundimi i studimit aktual dhe mundësisht shtrirja në zona të tjera).

Projekti është realizuar për pjesën e Sharrit, Shishtavecit dhe Korabit dhe vë në pah rëndësinë e përdorimit të imazheve satelitore për të përcjellë ndryshimet në mjedis në periudha disavjeçare, sidomos të vegjetacionit. Me anë të përdorimit të metodës së tillë mund të vërehet lehtë ndikimi i zonave urbane në dëm të mjedisit.

Prof. Neki Frashërit si bartës i projektit e ka përgatitur një raport përfundimtar i cili do të prezantohet ndërkohë para grupeve punuese ose do të organizohet një seminar në Tiranë. Në bazë të vlerësimit të rezultateve do të diskutohet edhe mundësia e përdorimit të studimeve të tilla në zona të tjera.

TUBIME SHKENCORE

1. Mundësitë e rishfrytëzueshmërisë së brezave të rinj frekuencorë UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela. Tryezë shkencore.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) nën përkujdesjen e Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut, në Prishtinë organizoi tryezën shkencore njëditore “Rishfrytëzueshmëria e brezave të rinj frekuencorë UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela”, e cila u mbajt me datën 12 shtator 2022, me pjesëmarrjen e studiuesve dhe ekspertëve të kësaj fushe nga Kosova, Italia dhe Shqipëria. Këshillin organizativ të kësaj tryeze e përbënin: prof. Myzafer Limani, anëtarë korrespondente e ASHAK-ut, kryetare, akad. Isuf Krasniqi, prof. Fetah Podvorica, anëtar korrespondent i ASHAK-ut.

Tryeza shkencore është realizuar me qëllim që të prezantohen rezultatet e projektit “Hulumtim mbi mundësitë e rishfrytëzueshmërisë së brezave të rinj frekuencorë UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela në territorin e Kosovës”, projekt ky i mbështetur nga ASHAK-u, i cili është realizuar në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe

Kompjuterike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Universitetin Politeknik të Torinos. Në kuadër të tryezës shkencore, lidhur me këtë temë boshte, u paraqiten dhjetë kumtesa. Anëtare korrespondente Myzafere Limani paraqiti në mënyrë të detajuar rezultatet kryesore të arritura të cilat janë të rëndësishme për mundësinë e rishfrytëzimit të brezave frekuencorë, rezultate këto të publikuara në revista të rëndësishme dhe konferenca ndërkombëtare ndërsa prof. Carla Fabiana Chiasserini nga Universiteti Politeknik i Torinos mbajti një ligjëratë në lidhje me mundësinë e të mësuarit të shpërndarë të makinave bazuar në topologjitë optimale të rrjetit..

Në punën e tryezës me prezantime dhe kumtesa u paraqiten edhe akad. Neki Frashëri nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, dr. Enver Hamiti nga Universiteti i Prishtinës, dr. Francesco Malandrino nga Këshilli Kombëtar i Kërkimeve të Italisë, dr. Mimoza Ibrani, dr. Zana L. Fazliu, dhe dr. Hëna Maloku–Berzati nga Universiteti i Prishtinës, Rrezarta Duraku-Rizaj, përfaqësuese e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Besnik Duriqi nga Telekom i Kosovës, dhe Flamur Gosalci nga kompania 3CIS.

Gjatë tryezës u zhvilluan diskutime të frytshme për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe mundësitë e bashkëpunimit dhe të ndërlidhjes në mes të hulumtimeve shkencore dhe aktiviteteve të kompanive që operojnë në fushën e telekomunikimeve dhe autoriteteve rregullative.

2. Energjia e pastër dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Simpozium shkencor Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) nën përkujdesjen e Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe atij të Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut, në Prishtinë organizoi Simpoziumin shkencor njëditor “Energjia e pastër dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, i cili u mbajt me datën 14 shtator 2022, me pjesëmarrjen e studiuesve dhe ekspertëve nga Kosova, Shqipëria, Kroacia, Zvicra dhe Britania e Madhe. Këshillin organizativ të këtij Simpoziumi e përbënin: akad. Fejzullah Krasniqi, kryetar, aka. Jorgaq Kaçani, akad. Isuf Krasniqi, akad. Justina Pula, prof. Fetah Podvorica, akad. Ilirjan Malollari dhe prof. Myzafere Limani. Në kuadër të Simpoziumit u paraqitën gjithsej 15 kumtesa. Në seancën e parë, të cilën e udhëhoqi akad. Fejzullah Krasniqi, prof. Neven Duić nga Universiteti i Zagrebit të Kroacisë paraqiti prezantimin “Si të bëjmë një transicion të shpejtë të energjisë me sistemet inteligjente”. Ai paraqiti aspekte të përgjithshme të tranzicionit energjetik për vende të ndryshme në botë dhe pastaj tregoi për modelet e suksesshme të integritit të burimeve të ripërtitshme në sisteme të mençura të energjisë. Më tutje prof. Amor Abdelkader, profesor në Universitetin e Bournemouth-it të Britanisë së Madhe kishte prezantimin me titull “Bateritë metalike alkaline për ruajtjen e energjisë së nesërme: përtej sistemeve kimike të litiumit”. Ai tregoi për modelet e reja të baterive alkaline që përmbajnë jone të metaleve alkaline, të cilat kanë performanca pothuajse të njëjta me bateritë e litiumit dhe që është metal që nuk është shumë i pranishëm në kore të tokës. Më pas prezantimin me titull “Rruga drejt dekarbonizimit të sektorit

energjetik” e mbajti prof. Adhurim Haxhimusa nga Universiteti i Grisons në Zvicër. Ai paraqiti të dhëna për mënyrat e tranzicionit energjetik në vende të ndryshme në BE dhe sfidat me të cilat përballet Kosova në këtë proces. Pastaj në seancën e dytë, të cilën e udhëhoqi akad. Jorgaq Kaçani, u paraqitën prezantimet: “Analiza e sistemeve të kapjes së CO2 pas djegies përmes simulimit të procesit duke përdorur Aspen Hysys” nga akademik Ilirjan Malollari, “Energjia dhe ndryshimet klimatike” nga prof. Majlinda Daci, “Analiza energjetike dhe mjedisore e përdorimit aktual të ngrohjes dhe rekomandime për sistemet më të përshtatshme të ngrohjes energjetike dhe mjedisore në qytetin e Korçës” nga prof. Ramadan Alushaj, “Eficienca energjetike e prodhimit të energjisë mekanike nga termocentralet” nga akademik Fejzullah Krasniqi, “Sfidat e tranzicionit energjetik të Kosovës përmes burimeve të ripërtitshme” nga prof. ass. Arben Gjukaj dhe “Development strategies in Kosovo energy sectors toward a sustainable energy system” nga prof. ass. Drilon Meha. Në seancën e tretë, që e udhëhoqi akad. Justina Pula, u paraqitën prezantimet e tyre: Msc. Andi Hida, Msc. Arlinda Bresa, Msc. Elio Voshtina, Msc. Bukuriye Hoxha, Msc. Blerina Bylykbashi dhe prof. ass. Bahri Prebreza. Gjatë simpoziumit u zhvilluan pas secilit prezantim diskutime të frytshme për temat e shtjelluara në kuadër të tranzicionit energjetik. Në fund të prezantimeve prof. Fetah Podvorica, në emër të Këshillit organizues i paraqiti konkluzionet e simpoziumit.

3. Integriteti, etika dhe besueshmëria e institucioneve kërkimore shkencore. Tryezë shkencore e paraparë të organizohet prej të gjitha seksioneve të ASHAK-ut nuk është mbajtur fare.

BOTIME

1. Revista “Resarch-Kërkime” nr. 26 është botuar në nëntor të 2022.
2. Përmbledhja e punimeve të prezantuara në tryezën shkencore me titull “Rishfrytëzueshmëria e brezave të rinj frekuencorë UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela” nuk është përgatitur për arsye se pjesëmarrësit të cilët i kanë prezantuar punimet e tyre në tryezë që kanë qenë të botuara kanë theksuar se nuk kanë të drejtë të ribotojnë pjesë të atyre punimeve as edhe si përmbledhje e punimit për shkak të të drejtave autoriale të botuesve.
3. Përmbledhja e punimeve të prezantuara në Simpoziumin “Energjia e pastër dhe zhvillimi i qëndrueshëm” është duke u përgatitur, por edhe aty kemi pengesa për arsyet e njëjta si të tryeza shkencore për shkak se pjesëmarrësit të cilët i kanë prezantuar punimet e tyre në tryezë që kanë qenë të botuara, kanë theksuar se nuk kanë të drejtë të ribotojnë pjesë të atyre punimeve as edhe si përmbledhje e punimit për shkak të të drejtave autoriale të botuesve.

AKTIVITETE TË TJERA

1. Anëtarët e Seksionit të ShN kanë marrë pjesë në kuadër të aktiviteteve

të përbashkëta shkencore me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë që janë në kuadër të bashkëpunimit të rregullt midis tyre:

Organizim dhe kontribut në kuadër të Konferencës ndërkombëtare për nanoteknologji me titull “Trendet në nanoteknologji” të organizuar prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit NanoAlb prej 3 deri më 7 tetor 2022 në Tiranë. Prof. Fetah Podvorica, anëtar korrespondent i ASHAK-ut ka mbajtur ligjëratën me titull “Control of the composition of the grafted organic layer by diverting the reactivity of aryl radicals” në cilësinë e ligjëruesit të ftuar. Në konferencë kanë marrë pjesë rreth 250 shkencëtarë nga 25 vende të botës.

2. Seksioni i Shkencave të Natyrës më 19 maj 2022, me iniciativë të prof. Arsim Morinës, anëtar korrespondent e ka organizuar ligjëratën e akademikut sloven, prof. Vinko Dolenc me titull “Erërat, ujërat dhe mendimet nuk i respektojnë kufijtë”.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent
Fetah Podvorica, d.v.

SEKSIONI I ARTEVE

BOTIME

1. Akademik Rauf Dhomi: Tituj të veprave kamerale. Dorëshkrimi nuk është dorëzuar, për arsye objektive.

2. Akademik Zeqirja Ballata: “Punime studimore për artin muzikor”. - Titull pune. Dorëshkrimi nuk është dorëzuar për arsye shëndetësore të autorit.

3. Akademik Vasil Tole: “Zadeja, fenomeni muzikor shqiptar”.

Libri është botuar. Promovimi i tij është bërë në Tiranë, në mjediset e ASHSH-së, më 8 qershor 2022 dhe në Prishtinë, në mjediset e ASHAK-ut, më 4 tetor 2022. Promovimi në ASHAK u përcoll me një program të shkurtër artistik, me ç’rast u ekzekutuan në piano nga pianistja Lirika Pula, vepra të zgjedhura të Zadesë.

4. Katalogu i ekspozitës së Luan Mulliqit u botua me rastin e ekspozitës që u hap në Shkup.

5. Katalogu i ekspozitës së Eshref Qahilit po ashtu u botua me rastin e hapjes së ekspozitës së tij në ASHAK.

AKTIVITETE ARTISTIKE

ESKPOZITA

1. Është realizuar Ekspozita e L. Mulliqit në Shkup. Ekspozita ishte paraparë të hapej më 26 prill 2022, por për shkak të disa rrethanave organizative ajo u hap më 5 shtator 2022.

2. Është realizuar ekspozita kolektive *Thurrje Kosovare*. Ajo u hap në mjediset e Akademisë, më 26 maj 2022. U prezantuan vepra artistike të artisteve tona të njohura.

Ekspozita u përcoll me program të shkurtër artistik me vepra të interpretuara nga grupi “Zana” të

shoqëruara me piano nga pianisti Edon Ramadani.

3. Me datë 1 dhjetor 2022 në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në prani të një numri akademikësh dhe artdashësish të tjerë, u hap ekspozita personale e piktorit Eshref Qahili. Ekspozitat e prezantuara në ekspozitë përbëjnë një retrospektivë të punës krijuese të Qahilit, të përfshirë në disa cikle, që autori i ka përmbledhur me titullin e përbashkët “Muzeu i fëmijërisë”.

KONCERTE

1. Koncert artistik me vepra të akademik Zeqirja Ballatës. Koncerti u mbajt më 16 shkurt 2022. Veprat e akademik Ballatës u ekzekutuan nga interpretët e solistët e mirënjohur të Kosovës, si: Adhurim Grezda-Bariton, Lirika Pula-Piano, Lule Ballata-Flaut, Shkumbin Bajraktari-Klarinet, Meriton Ferizi – Fagot, Visar Kuçi- Violinë, Antonio Gashi- Violonçel, Avni Krasniqi-Trumpetë, Ardit Pira-Trumpetë, Betim Krasniqi-Trombon, Bledar Bujupi-Kornë, Meriton Ferati-Tubë dhe Tringa Sadiku –Kitarë.

2. Më 20 dhjetor u mbajt koncerti tradicional i fundvitit, i përgatitur nga akademik Rauf Dhomi, me koordinatort Meriton Ferizi. Koncerti përmbledhi vepra të zgjedhura të kompozitorëve të njohur e që u interpretuan nga solistët e instrumentistët të mirënjohur nga Kosova, si: Lule Elezi, Lirika Pula, Pranvera Hoxha, Alba Muçolli Dehiri, Syzana Jakupi, Zana Badivuku Basha, Besa Llugiqi, Adelina Paloja, Zana Ramadani, Arta Jashari, Adhurim Grezda, Nikollë Gjini, Arstina Kelmendi, Elikona Hysaj, Sihana Badivuku, Antonio Gashi, Enkelelda Gorani.

U. D. Sekretari i Seksionit

Akademik Rauf Dhomi, d.v.

SHËRBIMI PROFESIONAL, ADMINISTRATIV E TEKNIK

Shërbimi Administrativ, Profesional e Teknik (SHPAT) i ASHAK-ut, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale, administrative e teknike u angazhua dhe punoi në realizimin e Programit të punës të Akademisë.

DEPARTAMENTI PËR BUXHET DHE FINANCA – DBF

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit Nr.08/L-143 për ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2022 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ka qenë në vlerë totale prej 1,137,180.00 €.

(Shihni tabelën Nr.1 të ndarjeve buxhetore në kategori ekonomike)

| Buxheti fillestar i ASHAK-ut sipas Ligjit Nr.08/L-143 (1,137,180.00€) | | | |
|--------------------------------------------------------------------------|---------------------|--------------------|---------------------------|
| Pagat dhe mëditjet | Mallra dhe shërbime | Shpenzime komunale | Subvencione dhe Transfere |
| 155,224.00 € | 281,797.00 € | 5,000.00 € | 695,159.00 € |

Me Ligjin Nr:08/L-143 për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2022, të realizuar në muajin gusht 2022, buxheti i Institucionit tonë nuk ka pasur ndryshime. (Shihni tabelën Nr.2)

| Buxheti sipas Ligjit Nr. 08/L-143– Rishikimi buxhetor (1,137,180.00€) | | | |
|-----------------------------------------------------------------------|-------------------|--------------------|---------------------------|
| Pagat dhe mëditjet | Mallra e shërbime | Shpenzime komunale | Subvencione dhe Transfere |
| 155,224.00 € | 281,797.00 € | 5,000.00 € | 695,159.00 € |

Buxheti final për ASHAK-un për vitin 2022, ka qenë gjithsej 1,136,997.25 €.

Në kategorinë paga dhe mëditje nuk kanë qenë të alokuara mjetet financiare në vlerë prej 182.75 €.

(Shihni tabelën Nr.3 të ndarjeve finale buxhetore në kategori ekonomike)

| Buxheti final për ASHAK-un, për vitin 2022 - mjetet në dispozicion (1,136,997.25 €) | | | |
|----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|--------------------|-----------------------------|
| Pagat dhe mëditjet | Mallra e shërbime | Shpenzime komunale | Subvencionet dhe transferet |
| 155,041.25.00 € | 281,797.00 € | 5,000.00 € | 695,159.00 € |

Përpos mjeteve nga Fondi i Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, ASHAK-u ka pasur depozita mjeteve nga Donatori Salbatring Internacional të bartura nga viti 2022 në vlerë prej 8,636.99€, si dhe donacionin nga IZUM Slloveni në vlerë prej 6,000.00 € për pagesën e punonjësës së angazhuar rreth programit COBIS. (Shihni tabelën Nr.4)

| Mjetet në dispozicion - të përfituara nga donacionet | | |
|-------------------------------------------------------------|------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Salbatring Internacional | 8,636.99€ | 4,636.99€ - për blerjen e librave; 4,000.00€ - për ndarjen e Shpërblimeve mbështetëse; |
| IZUM - Slloveni | 6,000.00€ | Biblioteka e ASHAK-ut – kompensimi financiar për punonjësën e angazhuar rreth Programit COBISS |

DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT E KOMUNIKIMEVE - DPPTIK

Departamenti i Përkrahjes Profesionale dhe i Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve – DPPTIK i ASHAK-ut, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të teknologjisë së informacionit e komunikimeve, dhe të veprimtarisë botuese, përpunoi rreth 282.5 tabakë shtypi (4413 faqe), dhe organizoi botimin e 16 titujve të librave e publikimeve, me 5150 kopje.

DPPTIK ka përditësuar vazhdimisht regjistrin e veprimtarisë botuese.

| Faqe | Tabakë shtypi | Kostoja në € | Tabakë autori | Kostoja në € | Tabakë shtypi i autorit, gjithsej € | Tirazhi |
|-------------|----------------------|---------------------|----------------------|---------------------|--------------------------------------------|----------------|
| 4413 | 282.5 | 26,458.00 | 367.79 | 55,946.09 | 82,404.09 | 5150 |

DPPTIK-u ndërlidhur me veprimtarinë botuese, aktivitetet e së cilës i përkrahu drejtpërsëdrejti dhe për shërbimet e tjera profesionale e teknike ia doli të angazhojë rreth 82,404.09 € të të gjithë buxhetit të ASHAK-ut në kategorinë Mallra e Shërbime. DPPTIK-u mbikëqyri dhe u përkujdes për funksionimin normal të sistemeve dhe të shërbimeve të TIK-ut dhe multimedive, si dhe për funksionimin normal të faqesueve duke e mirëmbajtur dhe populluar atë me të dhënat e përditësuara. Gjithashtu u angazhua në zhvillimin dhe dizajnimin e faqesueve të re të ASHAK-ut.

DPPTIK-u përkrahu profesionalisht punën e akademikëve dhe të Administratës. Në bashkërenditje me shërbimet e tjera të ASHAK-ut, DPPTIK-u përkrahu profesionalisht drejtpërsëdrejti 34 (tridhjetë e katër) aktivitete të Akademisë (promovime, konferenca, tubime, ekspozita, koncerte, ligjërata, ceremoni, etj.).

DPPTIK-u përgatiti specifikimet teknike dhe inicoi rreth 15 aktivitete prokurimi të ASHAK-ut dhe menaxhoi 10 kontrata afatgjate dhe kontratat e tjera, të cilat kishin të bëjnë me aktivitetet e DPPTIK-ut.

DPPTIK-u mirëmbajti dhe realizoi projektin e përditësimit të sistemit të vëzhgimit me kamera.

DPPTIK-u realizoi lidhje virtuale komunikuese të drejtpërdrejta online me bashkëpunëtorë dhe pjesëmarrës të jashtëm sipas nevojave të ASHAK-ut.

DPPTIK-u u përkujdes për rrjetin strukturor kabllor qeveritar dhe për funksionimin e sistemeve e të shërbimeve qeveritare.

DPPTIK-u administroi dhe mirëmbajti domenin qeveritar të stafit administrativ dhe domenin e ASHAK-ut të stafit akademik.

DPPTIK-u mirëmbajti Sistemin e evidencimit të ardhjes në punë të ASHAK-ut.

DPPTIK-u realizoi lidhje të reja në rrjetin telefonik sipas kërkesave dhe nevojave të stafit akademik.

DPPTIK-u vazhdoi me organizimin dhe rregullimin e depove të librit, si dhe të materialeve të tjera të harxhimit të nevojshme për funksionimin normal të Administratës dhe të Akademisë. Gjithashtu, shpërndau librin sipas kërkesave dhe nevojave të ASHAK-ut. Organizoi dhe mbikëqyri edhe mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të shërbimeve logjistike për Administratën dhe për Akademinë.

DPPTIK-u vazhdoi të kontribuojë në standardizimin e mëtejshëm të bërjes së Librit të ASHAK-ut dhe përgatiti specifikimet teknike të produkteve të veçanta të nevojshme për punën e ASHAK-ut. DPPTIK-u shtyu aktivitetet në drejtim të përgatitjes profesionale të shkresave zyrtare duke ndihmuar me gjedhet përkatëse dhe me udhëzimet profesionale.

DPPTIK-u u angazhua në kryerjen e punëve dytësore e alternative profesionale për departamentet e tjera të Administratës sipas vendimeve përkatëse.

DPPTIK-u mori pjesë në të gjitha aktivitetet profesionale të Administratës dhe të ASHAK-ut, nëpër komisione profesionale, të pranimit të mallit, të përcaktimit të cilësisë etj.

DPPTIK-u me përpjekje të vazhdueshme për ndërtimin dhe mbindërtimin e kapaciteteve lokale profesionale zbatoi metodat e përkrahjes së drejtpërdrejtë dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe të baraspeshuar me akademikët dhe me departamentet e tjera, si edhe me operatorët ekonomikë të jashtëm duke e përmirësuar dhe ngritur vazhdueshëm cilësinë e shërbimeve teknike profesionale dhe të shërbimeve të tjera të përkrahjes profesionale.

DEPARTAMENTI I BIBLIOTEKËS DHE I ARKIVIT – DBA

Aktivitetet kryesore të Departamentit të Bibliotekës dhe të Arkivit (DBA) gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, ishin:

- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e bibliotekës dhe sallës së leximit;
- Pasurimi i fondit të bibliotekës;
- Katalogimi sipas sistemit COBISS dhe regjistrimi i bibliografive;
- Projekti “Botimet për Kosovën në gjuhët e huaja”;

- Këmbimi me akademi dhe institucione të ndryshme në Kosovë dhe jashtë saj;
- Arkivimi profesional i dokumentacionit zyrtar;
- Trajnimet dhe aktivitetet dytësore të stafit të DBA-së.

- Mirëmbajtja e bibliotekës dhe sallës së leximit, si dhe pasurimi i fondit të bibliotekës

Gjatë vitit 2022 kanë vazhduar aktivitetet e rregullta që lidhen me menaxhimin, mirëmbajtjen dhe riorganizimin e bibliotekës. Ka vazhduar riorganizimi i fondit bibliotekar sipas kodeve të katalogimit të sistemit COBISS. (Për shkak të nevojës së vendosje së materialit bibliotekar sipas kodeve unike të sistemit COBISS, i gjithë fondi i bibliotekës është zhvendosur në raftë të reja). Ka vazhduar regjistrimi i të gjithë librave dhe revistave që janë blerë, këmbyer apo të pranuar në rrugë të ndryshme (kryesisht dhurata).

Gjatë vitit 2022, biblioteka e ASHAK-ut është pasuruar me rreth 1700 tituj të rinj. Më shumë se 1000 libra janë dhuruar nga akademik Jusuf Bajraktari . Te gjitha janë përpunuar dhe regjistruar në inventarin aktual. Të njëjtat do të katalogohen sipas sistemit COBISS.

Biblioteka është pasuruar po ashtu me një numër të konsiderueshëm të revistave.

- Katalogimi sipas sistemit COBISS dhe regjistrimi i bibliografive

Ka vazhduar katalogimi sipas sistemit COBISS dhe regjistrimi i bibliografive dhe përpunimi bibliografik në bazën Conor i fondit bibliotekar nga zyrtarët e licencuar nga Instituti i Shkencave të Informacionit (IZUM) nga Sllovenia:

- Në bazën e përbashkët të katalogimit COBISS.KS janë kryer 3786 regjistrime bibliografike;
- Rreth 4,500 libra janë inventarizuar;
- Në bazën lokale BASHAK janë shkarkuar 1585 regjistrime bibliografike;
- Në bazën Conor janë regjistruar 1472 autorë;
- Në bazën për regjistrimin e termave të njësuar CONOR janë kryer 406 regjistrime;
- Ka vazhduar katalogimi i revistave/serialeve dhe artikujve më qëllim të krijimit të bibliografive tematike. Ka përfunduar katalogimi i revistave të ASHAK-ut *Kërkime, Studime dhe Studime Shoqërore*;
- Në kuadër të projektit të krijimit të bibliografive të akademikëve, është kryer pjesa me e madhe e krijimit të bibliografisë së Akademik Rexhep Ismajlit dhe pjesërisht e Muhamedin Kullashit dhe Fetah Podvoricës. (Do të vazhdohet me krijimi e bibliografive të të gjithë anëtarëve të ASHAK-ut);
- Për nevoja të krijimit të bibliografive në sistemin COBISS.KS janë krijuar listat lokale të kodeve për renditjen e kontributeve sipas fushave nëpër bibliografi. Në të njëjtin sistem janë krijuar edhe listat lokale të kodeve për renditjen e materialeve nëpër raftë sipas fushave, përkatësisht sipas numrit të KDU-së;
- Është përditësuar procesverbali për ndarjen e sektorëve në bibliotekë dhe renditja e materialeve sipas klasifikimit lëndor decimal (KDU);
- Është aplikuar moduli “Koleksionet e bibliotekës” dhe printeri për shtypjen e etiketave (vendndodhjen e materialeve, numri i KDU, autori) dhe janë krijuar rreth 3000 etiketa për modulën “Koleksionet e bibliotekës”;

- Është aktivizuar moduli COBISS3/huazimi dhe është regjistruar një video për t'u ndihmuar përdoruesve të bibliotekës të krijojnë profilin në M-COBISS (COBISS mobile), të shkarkojnë aplikacionin në telefona celularë, të kërkojnë në katalogun online dhe të rezervojnë materialet apo të shtypin afatin e huazimit;

- Rreth 70 anëtarë të rinj janë regjistruar në COBISS-KS;

- Është përditësuar moduli COBISS3-huazimi dhe moduli COBISS-3 raportet;

- Është përditësuar dhe testuar platforma ECRIS.KS dhe është përkthyer në ndërfaqen e saj në gjuhën shqipe.

- Projekti: Botimet për Kosovën në gjuhë të huaj ka vazhduar, edhe pse me ritëm me të ngadaltë sesa është pritur. Procesi ka vazhduar përmes blerjes, këmbimit, dhurimit, fotokopjimit, etj.

Janë blerë 20 libra në gjuhët e huaja përmes aktivitetit të prokurimit. Fokusi kryesor gjatë vitit 2022 ka qenë identifikimi i botimeve për Kosovën në gjuhë të huaja të cilat mund të shkarkohen nga interneti dhe të shtypen. Deri me tani janë mbledhur rreth 800 tituj në gjuhë të ndryshme.

- Revistat dhe shtypi ditor

As gjatë vitit 2022 nuk është botuar asnjë gazetë ditore në Kosovë, prandaj regjistrimi i artikujve që lidhen me Akademinë nuk ka mundur të vazhdojë.

- Panairet

DBA ka përgatitur dhe menaxhuar pjesëmarrjen në panairin i librit Salon d'Livres në Paris dhe Panairin ndërkombëtar i Librit në Shkup. Ndërsa Panairi i Librit në Prishtinë, Panairi ndërkombëtar i librit në Frankfurt, Panairi ndërkombëtar i Librit në Tiranë janë menaxhuar nga stafi i logjistikës, ndërsa dy zyrtarë të stafit të DBA-së kanë marrë pjesë në prezantimin e botimeve të ASHAK-ut në panairot përkatëse.

- Këmbimi më institucione të Kosovës dhe jashtë saj.

Ka vazhduar këmbimi i botimeve me shtëpi botuese dhe biblioteka të akademive të ndryshme dhe më institucione kosovare dhe të vendeve të rajonit. Me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë dhe Qendrën për Studime Albanistike të Shqipërisë janë këmbyer shumica e botimeve të reja.

U janë dërguar disa nga botimet e reja të ASHAK-ut Akademive të Shkencave të Arteve Maqedonisë, Sllovenisë, Kroacisë, Malit të Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Hungarisë, Austrisë, Zvicrës dhe British Library Slavonic and East European Collections.

Me shtëpinë botuese "Faik Konica" nga Prishtina janë këmbyer 50 titujt.

- Arkivi

Zyrtarja e Arkivit ka vazhduar procesin e arkivimit të dokumentacionit zyrtar të ASHAK-ut sipas strukturës organizative të ASHAK-ut, të miratuar nga kryesia e ASHAK-ut (klasifikimit bazik i dokumenteve zyrtare të papërpunuar; ndarja e kopjeve origjinali dhe të fotokopjuara; ndarja sipas viteve, klasifikimi sipas shenjave unike, regjistrimi në tabelat Excel.

Stafi i DBA-së u angazhua edhe për kryerjen e punëve të tjera në ASHAK.

Shënim plotësues: Shënimet e SHPAT-it janë marrë nga drejtorët e departamenteve përkatëse.

Sekretare e Akademisë

Lendita Pula, d.v.

PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2023



SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTE

1. Historia e letërsisë shqipe. - Projekt afatmesëm për hartimin e Historisë së Letërsisë Shqipe (HLSH). Ky është projekt i ASHAK-ut, i miratuar në Seksionin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe nga Kuvendi i Akademisë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës krijon kushte materiale për punë dhe hulumtime shkencore për realizimin e projektit. ASHAK-u merr përsipër botimin e tekstit përfundimtar të HLSH-së.

Mungesa e një veprë sintetizuese e nivelit akademik për letërsinë shqipe shtron nevojën e domosdoshme kulturore për hartimin e një teksti të Historisë së Letërsisë Shqipe, gjithëpërfshirëse, që nga fillimet deri në kohën e tashme. Trajta e veprës do të jetë e nivelit akademik, duke tejkaluar sprovat e përparme të niveleve të doracakëve shkollorë apo universitarë. Kriteret e hartimit të Historisë së Letërsisë Shqipe do të jenë letrare dhe estetike. Kriteret e parashtruara nënkuptojnë evidencat / të dhënat letrare në një shtrirje kohore pesëshkullore, që nuk do të thotë krijimin e një kronologjie letrare. Kriteret e parashtruara nënkuptojnë trajtim autorësh, veprash e fenomenesh letrare shqipe, që synojnë krijimin e një sistemi letrar. Po këto kritere bëjnë të mundur zbulimin e

fenomeneve letrare shqipe, trajtimin e shndërrimeve letrare dhe theksimin e përhershmerive letrare, që paraqet një proces letrar të brendashkruar. Përfundimisht, një vepër e këtillë sintetizuese e gjithëpërfshirëse përfshin dhe përmban komunikimet e brendshme të letërsisë shqipe dhe komunikimet e jashtme të kësaj letërsie, me letërsitë dhe kulturat e tjera.

Ka filluar puna në projektin afatmesëm për hartimin e Historisë së Letërsisë Shqipe të ASHAK-ut. Grupi i punës i përbërë nga Sabri Hamiti, Rexhep Ismajli, Ali Aliu, Kujtim Shala e Nysret Krasniqi ka hartuar Platformën e kësaj veprë dhe ka hartuar Rregullat e punës në këtë projekt, që janë aprovuar në mbledhjen e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të ASHAK-ut. Sipas Rregullave të Punës, është zgjedhur kryeredaktori, redaksia dhe përgjegjësit për pjesët e veprës Historia e Letërsisë Shqipe. Redaksia, si përgjegjëse e këtij projekti ka nisur punën me trajtimin dhe analizën e veprave të mëhershme në fushë të historisë së letërsisë, për të vijuar me caktimin e zërave dhe paraqitjen e strukturës themelore të veprës.

Në vitin 2023 do të vijojë puna intensive për të hartuar dhe redaktuar artikujt në kontinuitet, në bashkëpunim me autorët e caktuar nga redaksia. Vëllimi i punës ka filluar të zgjerohet, prandaj pritet që Kryesia e Akademisë dhe Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë të krijojë kushtet e punës, duke paraparë edhe kompensimin material

për angazhimet kërkuese të redaksisë dhe të bashkëpunëtorëve. Drejtues i projektit, Sabri Hamiti.

2. Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe. - Veprimtaria e Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe u inkadrua sërish në Protokollin më të ri të bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në takimet e dy kryesive që vendosur që Këshilli të ketë 15 anëtarë, 7 nga ASHSH-ja, 7 nga ASHAK-u dhe një përfaqësues nga Maqedonia e Veriut. ASHAK-u tashmë ka zgjedhur anëtarët e vet në përbërje: akademik Rexhep Ismajli, bashkëkryetar, anëtarët korrespondentë Mehmet Halimi, Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi, profesorët Rrahman Paçarizi, Naim Berisha, Imri Badallaj si dhe Lumnije Jusufi nga Maqedonia e Veriut. Është diskutuar edhe Rregullorja e punës së Këshillit. Megjithatë, përpjekjet për “rithemelim” nuk rezultuan të frytshme dhe kontaktet nuk kanë qenë shumë aktive. Propozohet: të botohen materialet e deritashme të Këshillit brenda vitit 2022. Pastaj mund të rimendohet e tërë nisma.

3. Leksikonët e termave të gjuhësisë. - Projekti është inkadruar në programin e punës së Seksionit që në vitin 2018. Rëndësia e tij mbështetet te shpjegimi dhe interpretimi i termave të gjuhësisë. Krijimi i fjalorëve (leksikonëve) të gjuhësisë me vështrim enciklopedik, duke e pasur në mend të parë gjuhësinë shqiptare, ndihmon normëzimin e terminologjisë së gjuhësisë në gjuhën shqipe. Deri tash janë botuar Leksikoni i termave të fonetikës dhe të fonologjisë (2019), hartuar nga Bardh Rugova dhe Leksikoni i termave të sociolinguistikës, (2021), me autorë

Rexhep Ismajlin, Bardh Rugovën dhe Shkumbin Munishin. Projekti do të vazhdohet me Leksikonin e termave të gramatikës që parashihet të realizohet gjatë vitit 2022 dhe të botohet në vitin 2023. Deri tash janë identifikuar më shumë se 1300 zëra. Janë caktuar edhe hartuesit e zërave dhe po vijon puna e hartimit të tyre. Drejtues të këtij projekti janë Rexhep Ismajli, Bardh Rugova dhe Shkumbin Munishi.

4. Vepra e plotë e Norbert Jokl-it. - Botimi i veprës së plotë të albanologut austriak Norbert Jokl do të përmbillet me vëllimin e katërt, që parasheh mbledhjen, sistemimin, përkthimin dhe botimin e artikujve dhe studimeve të Jokl-it, të cilët do të jepen në përkthim me qëllim që të përmbledhen edhe kontributet e tjera të tij në një vëllim. Është caktuar përmbytja e këtij vëllimi. Një pjesë e teksteve të botuara në shqip në periodikun e para LDB-së duhet të skanohen në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë. Pritet vëllimi i teksteve të botuara gjermanisht, të skanuara, që ndodhen në Vjenë e në të cilat mund të ketë edhe shënime të Jokl-it. Për këtë është angazhuar edhe instituti përkatës në Vjenë. Për përkthimet e teksteve është marrë kontakti me përkthyes të Departamentit të Gjermanishtes, ku është përfshirë edhe Shkumbin Brestovci. E gjithë kjo do të përmbillet deri në gjysmën e vitit 2023. Botimi i përgatitur nga Rexhep Ismajli parashihet në fund të vitit 2023.

5. Arbnishtja e Zarës - rreziku i zhdukjes dhe gjasat e rimëkëmbjes. - Arbnishtja e Zarës është një varietet i rrezikuar i shqipes. Kjo gjendje e bën këtë varietet përfundimisht të rrezikuar të zhdukët. Gjasat për rimëkëmbjen e këtij varieteti varen nga gjasat që fëmijët e

komunitetit të nisin ta mësojnë ta flasin. Arbneshët e Zarës janë një komunitet që ka migruar nga zonat shqiptare të territoreve përreth Liqenit të Shkodrës e që tash gjenden brenda kufijve shtetërorë të Malit të Zi. Komuniteti është i vendosur në një pjesë të Zarës dhe, sipas regjistrimeve jozyrtare, ka rreth 2000 pjesëtarë. Sipas vlerësimeve të mbështetura në vëzhgimet në terren rreth 250 syresh ende e flasin arbnishten, kryesisht si gjuhë komuniteti dhe për nevoja të amvisërisë. Të gjithë folësit e arbnishtes janë, së paku, bilingjë (kroatishtja) ose trelingjë (kroatishtja dhe italishtja). Ndonëse kanë identitet të fortë etnik arbnesh, njëherësh e ndiejnë edhe identitetin shtetëror kombëtar kroat, sidomos pas luftës në Kroaci në vitet '90. Vitet e fundit ka pasur përpjekje për rikëndjelljen e arbnishtes, përmes hapjes së kurseve për mësimin e arbnishtes, përpilimin e një teksti mësimor, të fjalorit dhe të ligjëratave që janë mbajtur për komunitetin. Ende nuk mund të flitet për rezultate të dukshme. Projekti parashih realizimin e një vizite kërkimore në terren gjatë vitit 2022 për të vjelë një sërë intervistash me pjesëtarë të komunitetit në Zarë dhe në Arkivin e Vjenës. Një studim që do të nxjerrë në pah gjasët dhe mundësitë e rimëkëmbjes së këtij varieteti do të dorëzohet për botim në vitin 2023. Bartës të projektit janë Bardh Rugova e Rexhep Ismajli.

6. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. –Skanimi, digjitalizimi i materialeve dhe puna rreth Korpusit të shqipes së shkruar në Kosovë ka kërkuar angazhime të specialistëve të fushave dhe kompletimin e kushteve teknike. Tashmë rezultojnë e përmbyllur edhe puna e skanimit, digjitalizimit të

materialeve dhe botimit të fjalorëve të lematizuar të Fjalorit serbo-kroatisht-shqip të Sokol Dobroshit dhe të revistës *Përparimi*. Janë skanuar edhe materialet e revistës *Jeta e re*, si dhe disa botimeve të tjera. Në periudhën në vazhdim parashihet ngritja e grupit të punës dhe hartimi i Fjalorit të shqipes së shkruar në Kosovë në shekullin XX, që paraqet fazën e dytë të këtij projekti.

TUBIME SHKENCORE

1. Drama shqipe, fillimi i shekullit XXI – Konferencë shkencore, njëditore, me rreth 30 pjesëmarrës do të mbahet në Prishtinë në muajin maj të vitit 2023. Pjesëmarrës do të jenë kritikë, teatrologë dhe dramaturgë, shqiptarë dhe të huaj, që merren me dramën dhe teatrin shqiptar. Në thelb të kërkimeve do të jenë trajtimi i teksteve dramatike bashkëkohore, format e reja dramatike, inskenimet e dramës kombëtare në teatrot shqiptare, shfaqjet e dramës shqipe në skenat e huaja. Dhe në fund, prova e sistematizimit vlerësues të kësaj gjinie të ndërligjshme në letërsinë e tashme shqipe. Punimet e Konferencës do të botohen në një libër të veçantë, siç janë paraqitur edhe konferencat pararendëse të kësaj Akademie: Romani shqiptar, fillimi i shekullit XXI, Poezia shqipe, fillimi i shekullit XXI dhe Kritika letrare shqipe, fillimi i shekullit XXI. Këshilli organizues i Konferencës: Sabri Hamiti, Eqrem Basha, Nysret Krasniqi.

2. Studimet për shqiptarët në Britani dhe në vendet e Europës Veriore. - Në kuadër të konferencave tematike që vijon të organizojë ASHAK-u për studimet albanologjike në rajone të

ndryshme të botës, në fund të muajit tetor 2023 do të organizohet, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temën “Studimet për shqiptarët në Britani dhe në Europën e Veriut”. Në këtë konferencë dyditore do të ftohen 50-60 studiues nga e gjithë bota me synim që të shqyrtohen tematikat, historia e interesimeve dhe e studimeve për shqiptarët në Britaninë e Madhe dhe në vendet Skandinave, përfshirë Holandën, Belgjikën, vendet baltike, në mënyrë që të krijohet një pasqyrë më e qartë për historikun dhe aktualitetin e interesimeve të këtyre vendeve për botën shqiptare. Britania e Madhe, Danimarka, Suedia, Holanda, Belgjika, po edhe vendet baltike kanë shfaqur interes për njohjen e botës shqiptare mjaft herët. Në ato hapësira ka tashmë një traditë të shkëlqyer të këtyre studimeve me emra të njohur si Pedersen, Svane, Bugge, Leake, Durham, Mann, apo shkrimtarësh si Byron, duke vazhduar edhe në kohët tona me autorë të ndryshëm. Kohët e vona, me lëvizjet për çlirimin e Kosovës, këto interesime morën një hov edhe më të madh, kështu që tashmë e kemi një varg studiuesish me ndihmesa të rëndësishme për botën shqiptare dhe në mënyrë të veçantë për Kosovën. Punimet e Konferencës do të botohen në një vëllim të veçantë. Këshilli organizues i Konferencës përbëhet nga : Rexhep Ismajli, Shkumbin Munishi-sekretar, Sabri Hamiti dhe dy anëtarë nga ASHSH-ja.

BOTIME

1. Norbert Jokl, Studime dhe artikuj mbi gjuhën shqipe - Vëllimi IV i veprave

të Norbert Jokl-it është përgatitur në përmbajtjen e tij, tekstet gjermanisht kryesisht dhe një pjesë e përkthimeve shqip janë gati. Është biseduar me disa prej përkthyesve të mundshëm dhe materialet do t'u ndahen. Për ta çuar botimin në shtyp ka nevojë që një pjesë e teksteve të skanuara të riskanohen. 2-3 prej teksteve të përkthyer janë vetëm shqip, duhet skanimi i origjinalit. Gjithsej gjermanisht do të jenë rreth 400-450 f. Po të llogaritet edhe përkthimi shqip, vëllimi IV mund të shkojë deri në 800-900 f. Për ta bërë gati tërë vëllimin nevojiten skanimet e disa prej teksteve që nuk i kemi këtu. Me përgatitjen e këtij vëllimi, ashtu si te tre vëllimet e mëhershëm, do të merret akademik Rexhep Ismajli.

2. Kujtim M. Shala: “Kënga e cjamin” - Është libër teorik për gjininë e tragjedisë, i shoqëruar dhe me interpretime të veprave konkrete të gjinisë së tragjedisë. Trajton tragjedinë nga pozicioni i filozofisë së letërsisë, pastaj si një ontos letrar, në të gjitha rrafshet gjinore, me një përqendrim te tematika, e cila cilësohet si një manifestim letrar ontologjik i tragjedisë. Trajtimi teorik shtrihet nga teoria estetike e Platonit e këndeje, me referenca themelore pikëpamjet e Aristotelit, Horacit, teoritë e Rilindjes, klasicizmin frëng, në radhë të parë veprën e Bualosë, pastaj klasikën gjermane e Niçen, teoritë angleze etj. Provat konkrete të teorisë, në nivel interpretimi, lidhen me veprën e Eskilit, të Sofokliut, tragjeditë romake, “Makbethin” e Shekspirit, tragjedi të klasicizmit frëng etj. Po ashtu, libri trajton edhe vepra shqipe, nga De Rada te Hamiti, përfshirë Fishtë, Haxhiademin, Pashkun etj. Libri ka 350 faqe.

3. Nysret Krasniqi: *Ekuilibri letrar* – Libri *Ekuilibri letrar* është rezultat i kërkimeve studimore disavjeçare të autorit. Në këtë studim diskutohen ligjësitë specifike të letërsisë, të cilat shpeshherë vihen nën presion nga format e autoritetit. Analizohen format, doktrinat e fenomenet autoritare, të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë në dëmtimin e ekuilibrit vetërregullues e autonom të procesit letrar. Ruajtja e ekuilibrit letrar është filozofemë themelore e studimit. Libri *Ekuilibri letrar*, përmban tre kapituj themelorë. Në pjesën e parë: Fenomene letrare shqipe analizohen specifikat e letërsisë shqipe, siç janë: Mënia, Metaforika, Imagjinimi, Metafizika, Refuzimi, Aporitë e Gjenujia duke pasur gjithnjë për burimësi autorë dhe vepra të zgjedhura, me synimin që çdonjëri tekst të ndërlidhet me konceptin e përgjithshëm të ekuilibrit, por edhe të qëndrojë si specifike e një studimi të veçantë për topinë e synuar për ta analizuar. Në pjesën e dytë: Fenomene letrare, analizohen filozofemat e dala nga qarqet evropërimore të filozofisë, në tekstet siç janë: *Mea Culpa*, *Ideologemat*, *Përhershmeria* dhe *Ekuilibri*, në të cilat hetohen e argumentohen problematikat ndikuese të koncepteve të tyre në evolucionin letrar, autorësinë e letërsisë, krijimtarinë letrare, leximin letrar si dhe statusin e letërsisë. Në pjesën e tretë: Hermeneutikë analizohet Kanuni shqiptar duke ruajtur konceptet e tij dokjesore, por duke e vrojtuar metafizikën e tij si ligjësi e raportit spiritual të njeriut me eternalen, e kthyer në ligjësi kodifikuese, e parë mbi parimet krahasuese e hermeneutike. Libri *Ekuilibri letrar* synon ruajtjen e ligjësisë autonome estetike të letërsisë,

si dhe parimin themelor të letërsisë: kujtesën e shpirtërores. Libri (dorëshkrimi) ka rreth 300 faqe.

4. Leksikoni i termave të gramatikës – Është i treti në serinë e leksikonëve të gjuhësisë – pas atij të Fonetikës dhe fonologjisë dhe Sociolinguistikës. Deri tash janë identifikuar më shumë se 1300 zëra. Janë caktuar edhe hartuesit e zërave. Aktualisht është duke vazhduar hartimi i zërave. Planifikohet që hartimi i zërave të përfundojë në qershor të vitit 2023 dhe të botohet brenda këtij viti kalendarik.

5. Nazim Lleshi, Bardh Rugova: *Fjalori i turqizmeve në gjuhën shqipe* – Është një libër reference, me gjithsej 10.800 zëra - fjalë, që kanë hyrë në shqipen përmes turqishtes. Në këtë rrafsh janë futur edhe fjalë arabe e perse, por që për nga analiza fonetike dalin të kenë hyrë përmes turqishtes. Në Fjalori janë përfshirë, si aneks, edhe emra patronime. Dorëshkrimi që ka gjithsej 497 faqe të formatit a4, hartuar me times new roman 12 - në format fjalori, sipas rregullave të thyerjes grafike të ASHAK-ut pritet të ketë rreth 600 faqe. Tri vepra të rëndësishme, klasike, për turqizmat (ose siç i quajnë disa - orientalizmat) janë vlerësuar deri tash: Shkalliq për turqizmat në gjuhët e Ballkanit, Borecki, si edhe Dizdari për orientalizmat në gjuhën shqipe. Megjithatë, dorëshkrimi "Fjalori i turqizmeve në gjuhën shqipe" është shumë më gjithëpërfshirës dhe më i plotë. Sa për ilustrim, derisa Dizdari ofron pak më shumë se 4000 fjalë, ky dorëshkrim ofron më shumë se dyfishin.

6. Drama shqipe, fillimi i shekullit XXI – Botimi i materialeve të Konferencës shkencore *Drama shqipe*, fillimi i shekullit XXI që do të mbahet gjatë

muajit maj të vitit 2023. Parashihet një vëllim prej rreth 200 faqeve, duke marrë parasysh edhe vëllimet e tri konferencave të mëhershme.

7. Shqipja standarde sot – Materialet e Konferencës njëditore shkencore organizuar me rastin e 50 -vjetorit të Kongresit të drejtshkrimit që do të mbahet në nëntor të vitit 2022. Do të marrin pjesë studiues, albanologë nga Kosova, Shqipëria dhe bota shqiptare, si dhe albanologë të huaj. Temë themelore do të jetë *Shqipja standarde sot*. Kumtesat e kësaj konference do të përmbliken në një vëllim rreth 200 faqesh.

8. Studime, nr. 29 – Revista “Studime” që boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, me kontribute, studime shkencore e artikuj nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë, në shqip dhe në gjuhë të tjera, del një herë në vit. Përmbillet në fund të vitit kalendarik dhe del në muajt e parë të vitit. Përgatitet nga redaksia e drejtuar nga kryeredaktori Zejnullah Rrahmani. Numri 28 tashmë ka dalë nga shtypi. Pritet që edhe numri i ardhshëm, i paraparë për vitin 2023, të arrijë me kohë. Revista publikohet edhe në faqen ueb të Akademisë.

Sekretari i Seksionit

Akademik Sabri Hamiti, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

PROJEKTE

1. Kosova 1966-2008: - Projekti synon të ndriçojë ngjarjet historike duke filluar që nga Plenumi i Brionëve (1966) deri te shpallja e Pavarësisë së Kosovës (2008). Brenda këtij harku kohor do të studiohet pozita e shqiptarëve dhe popujve të tjerë në Kosovë, zhvillimet politike dhe mohimi i të drejtave kombëtare të shqiptarëve, statusi politik i Kosovës, arsimiti, kultura dhe shkenca, demonstratat e vitit 1968, Kushtetuta e vitit 1974, demonstratat e vitit 1981, suprimimi i autonomisë së Kosovës dhe protestat popullore, shpallja e Deklaratës Kushtetuese më 2 korrik 1990, Kushtetuta e Kaçanikut (7 shtator 1990), Referendumi për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur (1991), zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale më 1992, qeveria në ekzil, periudha e ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës, lufta e UÇK-së, sulmet e NATO-s ndaj caqeve ushtarake e policore serbe, çlirimi i Kosovës, periudha e IPVQ, roli i NATO-s, ndërtimi i kapaciteteve politike dhe institucionale dhe në fund shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Projekti do të ketë disa faza, duke filluar nga grumbullimi i dokumenteve arkivore nëpër arkiva të Kosovës, të Shqipërisë dhe të vendeve të rajonit, seleksionimin dhe klasifikimin e tyre, pastaj grumbullimi i literaturës shkencore dhe trajtimi përmes metodave shkencore dhe botimi i këtyre rezultateve në një vëllim të veçantë me rreth 450-500 faqe. Studimi dhe përpunimi i këtyre materialeve përfshin periudhën janar

2023-maj 2024, ndërsa botimi i studimit planifikohet të bëhet në vitin 2024. Bartës të projektit: akademik Jusuf Bajraktari dhe anëtar korrespondent Frashër Demaj, bashkëpunëtor në projekt: dr. Fehmi Rexhepi.

2. Zhvillimi i aftësive konkurruese të ekonomisë së Kosovës (projekt dyvjeçar). Projekt që ka hyrë në programin e punës së Seksionit në vitin 2022 dhe vazhdon edhe në vitin 2023. Në vitin e dytë do të realizohet hulumtimi cilësor me grupe të fokusit të bizneseve dhe politikëbërësve, analiza e rasteve dhe përvoja ndërkombëtare, organizimi dhe diskutimi i rezultateve, finalizimi i raportit të dytë kërkimor. Arsytimi i projektit është paraqitur i plotë në programin e punës së Akademisë për vitin 2022 dhe si i tillë është miratuar në Kuvendin e Akademisë. Pas përfundimit të projektit (faza I dhe II) rezultatet e tij, si dhe analizat me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë do të botohen në vëllime të veçanta. Bartës të projektit: akademik Justina Shiroka-Pula, akademik Isa Mustafa dhe anëtari korrespondent Besnik Krasniqi.

TUBIME SHKENCORE

1. Konferencë shkencore: Sfidat dhe perspektiva e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rajon: - Konferenca është paraparë të mbahet në Prishtinë dhe është përfshirë në kuadër të Protokollit për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor shkencor dhe artistik ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (për periudhën

2022-2023). Konferenca do të trajtojë aspekte dhe fusha të ndryshme të bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rolin sinergjik të tij për rritjen e bashkëpunimit me vendet në rajon dhe me ato të tregut unik të BE-së. Konferenca synon të identifikojë hapësirat kryesore për bashkëpunim dhe nevojat për ristrukturim ekonomik që do të kenë efekte në rritjen e konkurrueshmërisë, rritjen e punësimit dhe shfrytëzimin komplementar të kapaciteteve teknologjike, burimeve natyrore, fuqisë së aftë për punë dhe dijes teknologjike. Konferenca do të zgjasë një ditë dhe në të do të marrin pjesë përfaqësues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe vendet e tjera të rajonit, si dhe studiues ndërkombëtarë nga vendet e zhvilluara. Pritet të ketë rreth 15 prezantime të punimeve nga fusha të ndryshme. Konferenca parashihet të mbahet në tetor të vitit 2023. Pas mbajtjes së Konferencës do të botohen punimet shkencore të prezantuara në një përmbledhje të veçantë. Këshilli organizues: Akademik Isa Mustafa, akademik Justina Shiroka Pula, akademik Anastas Angjeli, akademik Adrian Civici dhe anëtari korrespondent Besnik Krasniqi.

2. Konferencë shkencore: Filozofia dhe poezia - Është paraparë të mbahet në Prishtinë, në kuadër të Protokollit për bashkëpunim ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (për periudhën 2022-2023). Konferenca do të trajtojë raportet midis filozofisë dhe poezisë që janë tematizuar gjatë shekujve nga filozofë, poetë e kritikë letrarë të vendeve të ndryshme. Në kërkimet dhe studimet mbi këto raporte është vënë në pah shpesh gërshetimi midis të menduarit

filozofik dhe vizioneve poetike, por edhe tensionet midis tyre. Ky gërshetim është shoqëruar në vepra të ndryshme edhe me dallimet midis filozofisë poetike dhe poezisë filozofike, midis ligjërimit filozofik dhe ligjërimit poetik. Numri i pjesëmarrësve nga Kosova do të jetë rreth 15, prej tyre nga jashtë Kosovës do të marrin pjesë edhe akademik Jean-Yves Tilliette, anëtar i Akademisë së Francës (AIBL) dhe Gérard Raulet, specialist i filozofisë gjermane dhe studiues i njohur i lidhjeve midis filozofisë dhe poezisë. Konferenca parashihet të mbahet në muajin maj të vitit 2023. Pas mbajtjes së konferencës do të botohen punimet shkencore të prezantuara në një përmbledhje të veçantë. Këshilli organizues: akademik Muhamedin Kullashi, prof. dr. Hasnije Ilazi, akademik Kujtim Shala, si dhe dy përfaqësues nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

3. Konferencë shkencore: Harmonizimi i legjislacionit mes Kosovës dhe Shqipërisë në kuadër të integritimit evropiane. Konferenca është paraparë të mbahet në Prishtinë në muajin maj të vitit 2023 dhe është përfshirë në Protokollin e bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (për periudhën 2022-2023). Harmonizimi i legjislacionit, si kusht për anëtarësim në BE kërkon miratim të një korpusi të gjerë të legjislacionit. Shtetet që aspirojnë të bëhen anëtarë të BE-së duhet të inkorporojnë në sistemet e tyre ligjore *acquis* përpara se të anëtarësohen në BE dhe ta bëjnë ligjin e BE-së pjesë të legjislacionit të tyre kombëtar. Miratimi dhe zbatimi i *acquis* janë baza e negociatave të anëtarësimit. Duke pasur parasysh

përmasat herkuliane të kësaj detyre, do të ishte shumë me vlerë që Shqipëria dhe Kosova të harmonizonin legjislacionin e tyre për të mbështetur njëra-tjetrën për ndërmarrje të suksesshme të masave legjislative për integritet evropiane. Kjo konferencë do të jetë një kontribut i rëndësishëm për mbështetjen e vendimmarrësve të Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë për integritet evropiane. Pas mbajtjes së Konferencës do të botohen punimet shkencore të prezantuara në një përmbledhje të veçantë. Këshilli Organizues: anëtari korrespondent Arsim Bajrami, akademik Aurela Anastasi (Akademia e Shkencave e Shqipërisë) dhe anëtare korrespondent Gjyljeta Mushkolaj.

4. Simpozium shkencor: Masakrat e luftës në Kosovë në kujtesën e të mbijetuarve. -

Simpoziumi planifikohet të mbahet në prill të vitit 2023, me pjesëmarrjen e studiuesve dhe me paraqitjen e 10-15 kumtesave shkencore dhe 2-3 video nga 5-7 minuta me intervista nga të mbijetuarit e masakrave në Kosovë. Këshilli organizues: akademik Isa Mustafa, akademik Jusuf Bajraktari, anëtar korrespondent, Arsim Bajrami, Ramë Manaj dhe anëtar korrespondent, Frashër Demaj.

5. Konferencë shkencore: 110 -vjetori i Konferencës së Ambasadorëve në Londër. - Konferenca është paraparë të mbahet në shtator të vitit 2023 në Prishtinë, në kuadër të Protokollit për bashkëpunim ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (për periudhën 2022-2023). Do të marrin pjesë rreth 17 studiues me kumtesa shkencore, prej tyre nga jashtë Kosovës do të jenë 7 studiues.

BOTIME

1. Rezultatet e projektit: “Zhvillimi i aftësive konkurruese të ekonomisë së Kosovës”: Botimi do të bëhet në dy vëllime të veçanta: në vëllimin e parë do të botohen analizat e ekspertëve vendorë, ndërsa në të dytin analizat e ekspertëve ndërkombëtarë, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Botimet do të përmbajnë hulumtimin kuantitativ të bazuar në anketë dhe mostër reprezentative sektoriale për të vlerësuar ku qëndron Kosova sa i përket aftësisë konkurruese, duke përfshirë treguesit e produktivitetit si dhe inovacioneve. Do të përfshihet gjithashtu analiza se cili është potenciali konkurrues dhe inovativ i sektorëve të caktuar më qëllim të identifikimit të sektorëve /degëve/grupacioneve që kanë ose mund të ndërtojnë kapacitete të veçanta, të dallueshme (distinktive) për konkurrencë; sa është i përshtatshëm mjedisi biznesor dhe sa janë konsistente dhe të qëndrueshme (dhe jo të fragmentuara) politikat ekonomike; cili është niveli i inovacioneve në ndërmarrjet Kosovare; burimet e subvencioneve/donacioneve publike apo të donatorëve; cili është niveli i bashkëpunimit midis institucioneve politikëbërëse, institucioneve akademike e kërkimore dhe bizneseve dhe si mund të krijohet një qasje e përbashkët dhe sinergjike në këtë relacion.

2. Gjyljeta Mushkolaj: “Dizajni kushtetues i qeverisjes lokale, e drejta e komunave në liri të asociimit dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje në Republikën e Kosovës”. - Punimi do të shtrihet mbi themelet intelektuale të literaturës që e zhvillon konceptin e përfitimit të

pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, e që i ka rrënjët në literaturën e demokracisë “deliberative”. Në çdo vend, qeverisja ka natyrë juridike të veçantë, që varet nga rrethanat politike, struktura e vendit, zhvillimi historik dhe kombëtar, rrethanat gjeografike, si dhe nga parimet që dominojnë në shoqëri, e që janë të përcaktuara nga ai që ka kontroll mbi pushtetin. Kosova i ka veçoritë e saj, që ndikojnë të ketë sistem të veçantë juridik të vetëqeverisjes lokale dhe strukturë unike të organizimit të raporteve midis nivelit qendror dhe lokal të pushtetit shtetëror. Megjithatë, është një karakteristikë tjetër që e bën Kosovën më të veçantë, e kjo është rruga drejt shpalljes së pavarësisë, procesi i kushtetutëbërjes dhe shtetndërtimit, ku dizajni kushtetues i vetëqeverisjes lokale ishte dhe vazhdon të jetë i rëndësishëm qendror.

Marrëdhëniet, midis niveleve të pushtetit shtetëror, përkatësisht të pushtetit qendror dhe lokal janë marrëdhënie dinamike, e jo statike. Gjithashtu, nocionet që zënë vend në Kushtetutë dhe në akte ligjore, e madje edhe në marrëveshjet e arritura gjatë procesit të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian me Serbinë, si nocioni “shtet unitar”, ose termi “partneritet i komunave”, e “lidhje horizontale”, nuk janë nocione që vetvetiu e përcaktojnë marrëdhënien e vërtetë midis “pushtetit qendror” dhe “pushtetit lokal”. Ekzistojnë një varg parametrash të tjerë, si kushtetues dhe “krahas-kushtetues” që ndikojnë në ato marrëdhënie. Gjithashtu, vetëm tekstet e dokumenteve si kushtetuese, por edhe ligjore nuk janë vendimtare. Marrëdhëniet midis pushtetit qendror dhe atij lokal, janë marrëdhënie shumë

dinamike që pandërprerë ndikojnë për ta zhvilluar dhe ka mundësi edhe për ta ndryshuar formën e pushtetit shtetëror në Kosovë. Me këtë punim, nëpërmjet studimit dhe analizës së sistemeve të pushtetit shtetëror që sot ekzistojnë në Europë dhe në botë, do të mundohemi që të japim kontributin tonë në hapjen e shtigjeve të reja për analizimin e marrëdhënieve midis pushtetit qendror dhe lokal, gjë që do të na jep mundësi që të analizojmë edhe gjendjen në të cilën është sot Republika e Kosovës.

3. Materialet e konferencës shkencore ndërkombëtare: "Roli i këmbimit të dhuratave në konstituimin e lidhjeve sociale" e cila do të mbahet gjatë vitit 2022 do të botohen në vëllim të veçantë në vitin 2023.

4. Materialet e konferencës shkencore: "Filozofia dhe poezia", do të botohen në vëllim të veçantë.

5. Materialet e konferencës shkencore: "Harmonizimi i legjislationit mes Kosovës dhe Shqipërisë në kuadër të integriteteve evropiane" do të botohen në vëllim të veçantë.

6. Materialet e tryezës shkencore: "Masakrat e luftës në Kosovë në kujtesën e të mbijetuarve", po ashtu do të botohen në vëllim të veçantë.

7. Revista "Studime shoqërore", nr. 10 - Revistë vjetore që do të botohet gjatë vitit 2023. Në të do të botohen studime dhe artikuj shkencorë, tekste ligjërimesh inauguruese, vështrime, recensione e kritika, etj. nga disiplinat e shkencave shoqërore.

Sekretare e Seksionit

Anëtare korrespondente Gjyljeta
Mushkolaj, d.v.

SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. Trajtimi i sistemeve ujore me procese të integruara/hibride, i paraqitur nga anëtar korrespondent Salih Gashi, është projekt 2 -vjeçar, në kuadër të fushës së shkencave të natyrës dhe mjedisit. Objektivat kryesorë të projektit janë: Kombinimi i proceseve të ndryshme për të eliminuar ndotësit e ndryshëm nga sistemet ujore. Në kuadër të këtyre proceseve së pari do të përdoren substanca të ndryshme me prejardhje bimore të cilët shërbejnë si ndajthithës (adsorbentë) për eliminim paraprak të substancave inorganike dhe organike deri në një masë të caktuar. Gjetja e ndajthithësve efikas, të cilët kanë kosto të lirë do të jetë një kontribut i rëndësishëm në kuadër të projektit. Më tutje për eliminim të plotë të substancave që janë ndotës të ujërave do të përdoren proceset membranore. Ato kanë përparësi ndaj teknologjive ekzistuese konvencionale për shkak të selektivitetit, shpenzimit të vogël të energjisë, produktivitetit të lartë, kostonë të moderuar të raportit të performancës dhe ndërtimi modular kompakt, por që kanë sfidë kryesore shtupimin ose mbylljen e poreve të tyre. Për ta eliminuar ose zvogëluar atë është i mundur kombinimi i dy ose më shumë proceseve do të thotë përdorimi i proceseve të integruara/hibride. Gjatë studimit do të zhvillohen këto aktivitete: a) Studimi i biosorbentëve me veti hidrofiliqe dhe hidrofobike; b) Karakterizimi i biosorbentëve me metoda të ndryshme: spektroskopia e absorbimit ATR-FTIR, X-Ray, etj.; c) Testimi i

biosorbentëve individualisht; ç) Studimi i parametrevave termodinamikë në përmirësimin e vetive të membranave asimetrike heterogjene acetat celuloze-qymyr i modifikuar; d) Testimi i vetive të këtyre membranave; dhe e) Testimi i procesit hibrid (biosorbent-osmozë e kundërt.).

2. Vazhdim i projektit “Platformë për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik Kosovë-Shqipëri”. Projekt i përbashkët dyvjeçar në mes ASHAK-ut dhe ASHSH-së në sektorin e energjisë për vitet 2022-2023. Dy akademitë do të punojnë në një projekt të përbashkët fillestar dyvjeçar, për të hulumtuar dhe analizuar në shkallë të gjerë kapacitetet prodhuese energjetike në të dy vendet së bashku me ekspertët e lëmenjve të ndryshëm dhe me institucionet relevante qeveritare me qëllim të përgatitjes së një platforme të përbashkët energjetike për zhvillim të qëndrueshëm të sistemit energjetik në të dy vendet. Shpenzimet e secilit grup punues në kuadër të projektit do të mbulohen nga akademitë respektive.

TUBIME SHKENCORE

1. Tryezë shkencore “Shndërrimi elektrokimik i energjisë dhe ruajtja e saj” .

Prodhimi i energjisë elektrike prej burimeve të ripërtitshme të energjisë (BRE) si p.sh. energjia e erës, fotovoltaiçet, biomasat etj. është përgjigjja më adekuate në kërkesat për zvogëlim të përqendrimit të gazrave që e shkaktojnë efektin serrë. E metë e BRE-së është se ato nuk janë përherë prezente me intensitet të njëjtë dhe për këtë arsye konsiderohen edhe si

burime të paparashikueshme ose intermitente. Ndryshimet e paparashikueshme në rrjet elektrik shkaktojnë mungesë të stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit. Për këtë arsye është e nevojshme që të përdoren sisteme të qëndrueshme të ruajtjes së energjisë. Energjia mund të ruhet në formë mekanike, elektrokimike, kimike ose termike, si dhe në formë të fushës magnetike ose elektrike. Në këtë tryezë shkencore ndërkombëtare do të diskutohet për sistemet elektrokimike të ruajtjes së energjisë, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në shndërrimin, ruajtjen dhe përdorimin e energjisë elektrike të prodhuar prej pajisjeve të ndryshme si celulat karburante, fotovoltaiçet, bateritë, katalizatorët dhe elektrolizerët e ndryshëm si dhe superkondensatorët. Bateritë mundësojnë jo vetëm ruajtjen e energjisë elektrike, por edhe zvogëlimin e sasisë së CO₂ që lirohet prej mjeteve të transportit nëse do të hyjnë në përdorim veturat elektrike. Temat që do të trajtohen janë: llojet e ndryshme të baterive, superkondensatorët, materialet e ndryshme kompozite që i përbëjnë elektodat dhe që mundësojnë përmirësim të cilësisë së pajisjes, katalizatorët dhe elektroliza e ujit, prodhimi i hidrogjenit dhe shfrytëzimi i tij në celulat karburante, fotovoltaiçet, sistemet hibride etj. Tryeza propozohet të organizohet në prill të vitit 2023. Me organizimin e saj do të merret këshilli organizues në përbërje: akademik Isuf Krasniqi, akademik Fejzullah Krasniqi, anëtar korrespondent Fetah Podvorica, anëtare korrespondente Myzafere Limani dhe prof. dr. Enver Hamiti.

2. Tryezë shkencore “Ndotja e mjedisit nga materialet plastike dhe substancat

organike rezistente dhe metodat e trajtimit”: - Materialet plastike janë produkte kimike të krijuara nga industria kimike të cilat kanë gjetur përdorim shumë të gjerë në shumë degë të industrisë, si dhe në jetën e përditshme për shkak të vetive të tyre fiziko-kimike: janë të qëndrueshme ndaj faktorëve të ndryshëm në mjedis, kanë peshë të vogël dhe kosto të ulët të prodhimit. Rezistenca e tyre ndaj zbërthimit të tyre në elementet përbërëse ka bërë që sot të gjenden kudo nëpër botë qindra miliona tonelata të këtyre materialeve të cilat varësisht prej dimensioneve të pjesëve të mbetura mund të ndahen në makro-, mikro- dhe nanogrimca. Prania e këtyre grimcave kudo ka pasojë të drejtpërdrejta për shëndetin e njeriut dhe të organizmave të tjerë. Qëllimi i tryezës shkencore, e cila propozohet të mbahet në muajin shtator të vitit 2023, është vënia në pah e efektit ndotës të materialeve plastike dhe substancave të tjera rezistente organike, si dhe diskutimi i metodave fiziko-kimike dhe biologjike që ekzistojnë për eliminimin e plotë të tyre. Në kuadër të tryezës do të diskutohet për përdorimin e materialeve plastike dhe të substancave organike rezistente, mënyrën e ndotjes dhe efektet e ndryshme që i kanë në organizëm të njeriut dhe ekosistem, si dhe për metodat e ndryshme që përdoren për shkatërrimin e tyre duke përfshirë edhe proceset e oksidimit të avancuar. Tryeza do të organizohet në muajin shtator, 2023. Me organizimin e saj do të merret Këshilli organizues në përbërje: akademik Nexhat Daci, anëtar korrespondent Fetah Podvorica, anëtar korrespondent Salih Gashi dhe një ekspert nga jashtë Akademisë.

BOTIME

1. Fejzullah Krasniqi dhe Naser Sahiti: “Proceset dhe ciklet termodinamike”.

Materiali i kompiluar paraqet një analizë të detajuar energjetike dhe eksergjetike të proceseve dhe cikleve të punës, të cilat realizohen në stabilimentet e prodhimit të energjisë mekanike dhe i njëjti do të jetë një ndihmesë e caktuar si në rrafshin teorik ashtu edhe për aplikim praktik në fushën e inxhinierisë. Në kuadër të kreut të parë jepen njohuri të përgjithshme për energjinë, eksergjinë dhe anergjinë; në kreun e dytë jepen informacione për ciklet e punës së termocentraleve me avull uji, ndërsa në kreun e tretë përfshihen ciklet e motorave me djegie të brendshme dhe turbinave me gaz, në kreun e katërt paraqiten ciklet e sistemeve me kogjenerim, kurse në kreun e pestë ciklet e ftohjes dhe pompave të nxehtësisë. Në kreun vijues, të gjashtin me radhë, paraqitet analiza energjetike dhe eksergjetike e proceseve psikometrike, kurse në të shtatin sistemet e energjisë së ripërtirshme. Dorëshkrimi është përgatitur në masën deri 70 %, ndërsa materiali i plotë në formën e kërkuar do të dorëzohet më së largu deri në qershor të vitit 2023. Pas kompletimit të plotë të materialit sipas formatit të botimeve të ASHAK-ut, libri mund të arrijë deri në rreth 40 tabakë.

2. Isuf Krasniqi dhe Avni Alidemaj: “Ndërprerësit e tensionit të lartë (110, 220 dhe 400) kV me gaz SF₆ – proceset tranzitore”. Sistemi elektroenergjetik i Kosovës karakterizohet me një rrjet të fortë ndërlidhës prej 400 kV në rrjetin rajonal. Problemet me të cilat ballafaqohet sistemi elektroenergjetik i

Kosovës janë vjetërsia e nënstacioneve, linjave energjetike, ndërprerësve, pajisjeve ndihmëse etj. Mosfunksionimi i këtyre elementeve është rezultat i punës së tyre të gjatë dhe tejkalimit të jetëzgjatjes së tyre, gjë që redukton besueshmërinë e sistemit. Sistemi elektroenergjetik është në të ashtuquajturën "stres", sepse gjithnjë priten ndërprerje të papritura, të reja në sistem. Ulja e besueshmërisë të pajisjeve është rezultat i një numri të madh të operimeve të ndërprerësve gjatë operimit në punë normale, si edhe për shkak të prishjeve të shpeshta (proceseve tranzitore) që ndikojnë në dëmtimin e ndërprerësve të tensionit të lartë të përcjella me procese tranzitore në to. Në libër përshkruhet sistemi elektroenergjetik i Kosovës, problemet që ndodhin në të, sikundër që janë paraqitur edhe ndërprerësit në mënyrë të përgjithshme, si dhe roli dhe rëndësia e tyre në sistemin elektroenergjetik, pastaj janë analizuar ndërprerësit me gas SF₆, funksionimi dhe problemet me të cilat ballafaqohet sistemi elektroenergjetik në Kosovë, sikundër edhe problemi specifik, i cili ka ndodhur në sistemin elektroenergjetik të Kosovës. Në një kapitull më vete është dhënë modeli matematikor që paraqet sjelljen e parametrave elektrikë (tension dhe rrymë) gjatë ngjarjeve tranzitore (para, gjatë dhe pas ngjarjeve) dhe vlerat që mund të përdoren për simulime të ndryshme, pastaj është paraqitur paketa softuerike që është përdorur për analizën e fenomeneve që ndodhin në sistemin elektrik të Kosovës etj. Dorëshkrimi është përgatitur në masën deri 70 % ndërsa materiali i plotë në formën e kërkuar do të dorëzohet më së largu deri në qershor të vitit 2023. Pas kompletimit të plotë të materialit

sipas formatit të botimeve të ASHAK-ut, libri mund të arrijë deri në rreth 30 tabakë.

3. Salih Gashi: "Proceset konvencionale membranore dhe të integruara - parimet dhe zbatimet" - Në këtë libër janë shtjelluar proceset konvencionale, membranore dhe të integruara / hibride. Ai përmban teorinë dhe zbatimin e një numri të proceseve dhe sistemeve. Zbatimi në veçanti u kushtohet sistemeve ujore. E tërë fusha e kimit të ujërave dhe trajtimit të tyre është proces dinamik. Konceptet, njohuritë dhe zgjidhjet ndryshojnë me kohën. Studiuesit, inxhinierët dhe studentët iu përshtatën këtyre ndryshimeve dhe në vazhdimësi përditësojnë njohuritë e tyre. Edhe pse bëhet fjalë për disiplina të ndryshme, autori është përpjekur që ato t'i paraqesë në mënyrë të qartë dhe koncize, që të kuptohen lehtë dhe të përfshijë tërë subjektin dhe zhvillimet më të reja në këtë fushë në mënyrë të duhur. Në libër së pari trajtohen karakteristikat kryesore të ujit, pastaj proceset konvencionale dhe lloje të trajtimit të ujit të ndotur, proceset konvencionale të trajtimit të ujit, jonkëmbimi dhe më pas flotimi dhe ndajthithja. Në një kapitull më vete trajtohet biothithja, kurse më tej trajtimi elektrokimik i ujit, përfshirë edhe proceset membranore, pastaj proceset e ndajthithjes membranore, si dhe proceset hibride të trajtimit të ujit të ndotur. Libri ka përafërsisht 22 tabakë autori.

4. Myzafere Liman: "Akustika, të folurit dhe muzika" - Ky libër i përmban dhjetë kapituj. Në kapitullin e parë paraqitet hyrje në akustikë kurse në atë të dytin rrezatimi dhe përhapja e valëve akustike, në atë të tretin shpjegohen

valët akustike në hapësirë të mbyllur, kurse në të katërtin akustika fiziologjike dhe psikologjike, në të pestin paraqitet të folurit dhe muzika, kurse në të gjashtin përpunimi i sinjaleve audio ndërsa në shtatin analogjitetë elektroakustike dhe elektromekanike, në kapitullin e tetë paraqitet ultratingulli, kurse në të nëntin akustika arkitektonike për të vazhduar në kapitullin e dhjetë me mbrojtjen nga zhurmat e ambientit. Libri përmban 240-270 faqe dhe do të jetë gati deri në muajin prill të vitit 2023.

5. Materialet e tryezës shkencore “Shndërrimi elektrokimik i energjisë dhe ruajtja e saj” do të botohen në një vëllim të veçantë.

6. Revista “Resarch-Kërkime” nr. 27. Aktualisht është në përgatitje botimi i numrit 26 të kësaj reviste, i cili do të botohet deri në gjysmën e dytë të vitit 2022. Numri 27 i revistës “Research-Kërkime” mendohet të botohet në gjysmën e dytë të vitit 2023. Në këtë revistë botohen punimet origjinale shkencore të cilat i përkasin Seksionit të Shkencave të Natyrës.

LIGJËRATA

Ligjërata të ndërsjella të akademikëve ASHAK-ASHSH.

Ligjëratë e Pierre Corvol, ish- kryetar i Akademisë së Shkencave të Francës në lidhje me integritetin akademik.

PROMOVIME

Seksioni do të bëjë promovimin e veprave të botuara të anëtarëve të Akademisë.

AKTIVITETE TË TJERA

Vazhdohet me realizimin e aktiviteteve të Protokollit të bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në projektet të cilat janë në kuadër të fushëveprimtarisë të Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Fetah Podvorica, d.v.

SEKSIONI I ARTEVE

Seksioni i Arteve për vitin 2023 do të zhvillojë aktivitete artistike, që do të përqendrohen kryesisht në format manifestuese dhe prezantuese nga fusha e arteve pamore dhe të muzikës. Duke qenë se Seksionit të Arteve të ASHAK-ut i bie roli kryesor në organizimin e manifestimeve artistike, me programin e punës të vitit 2023 synohet që Akademia të hapë ambientet e saj për një audienca më të gjerë artdashësish.

EKSPOZITA

Parashihet që gjatë vitit 2023 të organizohen dy ekspozita të arteve pamore të autorëve nga brenda ose jashtë vendit, njëra në sezonin e pranverës dhe tjetra në sezonin e vjeshtës. Ekspozitat do të pajisen me materialin përcjellës promovues, përfshirë edhe katalogun, ndërsa Akademia me anë të komisionit të saj do të bëjë pasurimin e fondit të veprave artistike përmes përzgjedhjes profesionale.

KONCERTE

Gjatë vitit 2023 Seksioni arteve, duke vazhduar traditën e nisur, do të organizojë dy koncerte me vepra artistike të autorëve tanë dhe të huaj dhe me solistë të përzgjedhur brenda dhe jashtë vendit. Koncerti i parë do të mbahet më 17 shkurt, ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ndërsa koncerti i dytë, gjithashtu tradicional, parashihet të mbahet në vigjilje të festave të fundvitit.

U. D.Sekretari i Seksionit
Akademik Rauf Dhomi d.v.

PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS



PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

PROCESVERBAL

Nga mbledhja CVI e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 23 shkurt 2022, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Edi Shukriu, Eqrem Basha, Fejzullah Krasniqi, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Jusuf Bajraktari, Justina Sh. Pula, Kujtim Shala, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Muhamedin Kullashi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Bardh Rugova, Besnik Krasniqi, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Luan Mulliqi, Nysret Krasniqi, Mehmet Halimi, Myzafere Limani, Qamil Haxhibeqiri dhe Shkumbin Munishi.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja.

Kuvendi e miratoi këtë

rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CV të Kuvendit të Akademisë;
2. Miratimi i Raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2021;

3. Miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2021;
4. Miratimi i planit strategjik gjithëpërfshirës të ASHAK-ut 2022-2025;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i rregulloreve të ASHAK-ut: Rregullorja për veprimtarinë botuese dhe Rregullorja për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese;
6. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Para miratimit të procesverbalit diskutoi H. Islami. Ai paraqiti vërejtje për përmbajtjen e procesverbalit dhe tha se sekretarja e Akademisë nuk e ka pasqyruar drejt rrjedhën e mbledhjes në procesverbal, ashtu që nuk e ka përfshirë gjithë diskutimin e tij, por edhe diskutimet e S. Hamitit, R. Ismajlit, Gj. Mushkolajt dhe A. Bajramit. Ai në vazhdim tha se mbledhjet incizohen dhe sekretarja duhet t'i nxjerrë edhe një herë shënimet dhe ta plotësojë procesverbalin. Kryetari Kraja njoftoi se mbledhjet nuk incizohen, sepse nuk ka vendim për një gjë të tillë dhe se incizimi nuk mund të bëhet pa një vendim të Kuvendit. Ai më pas e hapi diskutimin dhe meqë diskutime nuk pati, Kryetari propozoi që procesverbali të plotësohet me vërejtjet e H. Islamit. Propozimi u miratua njëzëri nga Kuvendi. Procesverbali i mbledhjes CV u miratua me kërkesën që të bëhen plotësimet

dhe me to të njoftohet Kuvendi në mbledhjen e radhës.

Ad. 2.-

Pra fillimit të shqyrtimit të Raportit të punës të ASHAK-ut për vitin 2021, kryetari Kraja paraqiti një rekapitullim të punës gjatë vitit. Ai në fjalën e tij tha:

“Të nderuar akademikë, të nderuar kolegë!

Para se të kalojmë në shqyrtimin e raportit të punës për vitin 2021, më lejoni t’i them disa fjalë, sa të mundem përmbledhëse, për punën e Akademisë gjatë vitit të shkuar.

Viti i shkuar në pikëpamje të masave ndaj pandemisë, ka qenë një vit relativisht më i lehtë, megjithatë nuk mund të themi se ishim të liruuar tërësisht në pikëpamje të kufizimeve që u desh të zbatonim në programin tonë të aktiviteteve publike dhe me praninë e audiencës. Por më duhet të them se, me gjithë kufizimet, kemi arritur të realizojmë konferenca, promovime, ekspozita, koncerte më shumë se çdoherë tjetër, më shumë se çdo vit tjetër, të gjitha këto me paraqitje publike të suksesshme, që kanë tërhequr vëmendjen e opinionit shkencor dhe të artdashësve në numër të konsiderueshëm.

Ajo që bie në sy vazhdimisht është se pjesëmarrja e anëtarëve të Akademisë në këto aktivitete vazhdon të jetë relativisht e vogël, pjesëmarrje kjo që kufizohet kryesisht te seksionet përkatëse, duke mos u përfshirë në veprimtari në masë të mjaftueshme anëtarësia e gjerë e Akademisë.

Megjithatë, ajo që dua të them në këtë rast, është se viti i shkuar ishte vit i zgjedhjeve të brendshme të

Akademisë, të cilat, edhe përkundër disa pakënaqësive dhe kontestimeve mbetur në tentativë, u zhvilluan dhe përfunduan me sukses, ashtu siç ishte paraparë dhe ashtu siç e do ligji dhe statuti, edhe aktet e tjera normative.

Më lejoni të them tani se në punën e Akademisë duhet t’i avancojmë disa procese, në mënyrë që si institucion të arrijmë rezultate më të mira, prestigj shoqëror dhe paraqitje publike më dinjitoze. Dhe imazhin negativ që na shoqëron që prej një kohe të gjatë duhet ta mënjanojmë përfundimisht, kryesisht duke vënë nën kontroll daljet e parregullta financiare, intensifikim të aktivitetit në fushat e shkencës dhe të arteve, paraqitje më të mirë publike dhe punë më e mirë profesionale në projektet, në botimet dhe në revistat tona.

Me qëllim që të bëhet një prezantim më i mirë i punës së institucionit, tashmë janë ndërmarrë masat përkatëse për ndryshime përmbajtësore dhe vizuale të faqes sonë të internetit, e cila gjendet tashmë në fazën e ristrukturimit dhe të ngritjes në një standard më të lartë. Në të ardhmen, për mirëmbajtjen dhe përditësimin e përmbajtjeve do të përkujdeset nënkryetarja e Akademisë dhe sekretarët e seksioneve.

Ndërkaq, sa u përket botimeve, njëra nga shtyllat kryesore të punës së Akademisë, viti i shkuar ka qenë më i suksesshmi në historinë e këtij institucioni: janë botuar 24 tituj me afër 10 mijë faqe shkrime origjinale, gjë që e bën Akademinë botuesin më prestigjioz në mbarë hapësirën shqiptare. Ajo që na ka munguar dhe që kërkon punë më këmbëngulëse, është puna redaktoriale, që është e lidhur me sekretarët e seksioneve, të

cilët janë njëkohësisht edhe redaktorë të botimeve. Në të ardhmen redaktuarës së teksteve do t'i kushtohet kujdes i shtuar, në mënyrë që edhe cilësia e botimeve të rritet suksesivisht.

Punë më pak cilësore është bërë me revistat, të cilat, me gjithë ndonjë ndërhyrjeje, nuk po arrijnë të konsolidohen dhe ta marrin attribute të revistave të mirëfillta shkencore, sipas standardeve që e kërkon institucioni ynë. Disa përparime janë bërë, por mbetet akoma shumë punë. Përfitoj nga rasti që t'i ftoj seksionet përkatëse që të merren më shumë me revistat, me nxitjen më të madhe të bashkëpunëtorëve dhe me respektimin e standardeve që kërkon botimi i revistave të nivelit akademik. Në të ardhmen, krahas ngritjes së cilësisë, do të bëjmë përpjekje që publikimin e revistave ta bëjmë përmes një platforme digjitale, të cilën do të duhej ta inauguronim në një periudhë jo të largët.

Një problem i mprehtë mbetet çështja e projekteve, të cilët deri tani, për shkak të mungesës së një rregulloreje, kanë qenë burim i daljeve financiare të pakontrolluara, pagesa sipas hamendjes, pa matje të vlerës dhe kohës së punës e kështu me radhë, përfshirë edhe ndonjë rast kur pagesat janë bërë edhe për pjesëmarrës pa asnjë kontribut real. Që ta tejkalojmë edhe këtë situatë jo të mirë për institucionin, në Kryesi do të inicioj menjëherë formimin e një grupi të punës për hartimin e një rregulloreje për projekte, pavarësisht nga vështirësitë që paraqiten për shkak të specifikave të ndryshme që kanë projektet tona. Besoj se në mbledhjen e radhës së Kuvendit, pra në qershor,

shpresoj të keni përpara një draftregulloreje për projektet.

Të nderuar kolegë!

Mbetet që këtë vit, përveç programit të punës, të realizojmë edhe disa nisma të tjera aktiviteteve shkencore dhe artistike, si ekspozita, tryeza shkencore etj. Mendoj se përmes disa tryezave shkencore duhet t'i përgjigjemi aktualitetit shoqëror dhe shkencor, pra do të ishte mirë ta intensifikojmë këtë veprimtari: t'i bëjmë tryezat tona shkencore vend ku debatohet për probleme të mprehta shoqërore dhe për çështje të rëndësishme shkencore, por gjithnjë duke pasur në vëmendje ruajtjen e nivelit shkencor të audiencës dhe të pjesëmarrësve.

Ju faleminderit!"

Në vazhdim u shqyrtua Raporti i punës i ASHAK-ut për vitin 2021, me radhë duke filluar nga Kuvendi, Kryesia, seksionet e deri te Shërbimi profesional, administrativ e teknik. Raporti u miratua njëzëri dhe si i tillë do të botohet në revistën "Vjetari 2021".

Ad. 3.-

Edhe Raporti financiar për vitin 2021 u miratua pa vërejtje.

Ad. 4.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës, M. Limani kryesuese e grupit punues për hartimin e Planit strategjik e njoftoi Kuvendin për ecurinë e punës së hartimit të këtij dokumenti. Ajo tha se pas mbledhjes së Kuvendit të Akademisë, më 30 qershor 2021, në të cilën nuk u miratua Plani strategjik, grupi punues është mbledhur dhe e ka

shqyrtuar edhe një herë dokumentin në fjalë. Më pas anëtarëve të Akademisë iu është dërguar ky dokument, por kësaj radhe nuk ka pasur asnjë vërejtje apo sugjerim shtesë. Kryetari Kraja më pas propozoi që Plani strategjik gjithëpërfshirës i ASHAK-ut, 2022-2025 të miratohet nga Kuvendi. Propozimi u miratua njëzëri.

Ad. 5.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës u shqyrtuan rregulloret e ASHAK-ut: Rregullorja për veprimtarinë botuese dhe Rregullorja për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese. M. Limani kryesuese e grupit punues për plotësimin e rregulloreve e njoftoi Kuvendin për ecurinë e punës. Ajo tha se pas hartimit të drafteve të rregulloreve, ato u janë ndarë të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe janë shqyrtuar nëpër mbledhje të rregullta të seksioneve të ASHAK-ut. Janë paraqitur vërejtje dhe sugjerime, prej të cilave disa janë marrë parasysh nga grupi punues e disa jo, meqë ashtu është vlerësuar. Kryetari Kraja në fjalën e tij tha se rregulloret nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha, por vetëm janë plotësuar aty ku ka pasur nevojë. Ai e hapi diskutimin lidhur me këtë pikë. Lidhur me Rregulloren për veprimtarinë botuese diskutuan S. Hamiti, R. Ismajli dhe B. Krasniqi. S. Hamiti e R. Ismajli thanë se në Seksionin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë është propozuar që të copyright ASHAK, të shtohet edhe viti i botimit, po kjo nuk është marrë parasysh. M. Limani sqaroi se kjo çështje është trajtuar me kujdes nga grupi punues dhe se grupi ka konsideruar se copyright ASHAK duhet të mbetet ashtu siç është paraqitur në Rregullore, sepse autorit nuk i ndalohe

të botojë veprën e botuar në ASHAK, vetëm se këtë mund ta bëjë në bazë të marrëveshjes paraprake me ASHAK-un. B. Krasniqi në diskutimin e tij tha se çështja e copyright rregullohet me kontratën e autorit që nënshkruhet nga vetë ai dhe ASHAK-u, prandaj nuk shihet ndonjë pengesë në këtë drejtim.

Pas diskutimeve kryetari Kraja e paraqiti për votim Rregulloren për veprimtarinë botuese. Rregullorja u miratua me shumicë votash.

Më pas u shqyrtua edhe Rregullorja për honorarët e autorëve të veprimtarisë botuese. Diskutuan J. Bajraktari dhe F. Demaj. J. Bajraktari propozoi që të bëhet një ndryshim, si në vijim:

Te neni 3, paragrafi 1, pjesa e parë e nënparagrafit 1.3, “dokumente arkivore” të bartet te nënparagrafi 1.2 i po këtij neni.

F. Demaj paraqiti arsyetimin se pse duhet të bëhet ky ndryshim.

Pas diskutimeve kryetari Kraja e paraqiti për votim Rregulloren në fjalë me propozimin e J. Bajraktarit dhe F. Demajt.

Rregullorja me ndryshimet e propozuara u miratua me shumicë votash.

Neni 3, paragrafi 1 i Rregullores së miratuar tani do të jetë:

“1. Honorari për tabak autori paguhet:

1.1. Për punime origjinale 180€;

1.2. Për përgatitjen e botimeve kritike (që përfshin komentet, bibliografitë, indeksi i emrave, shënimet, përgatitjen dhe kritikën e teksteve, të gjitha punët e nevojshme kur ato i kryen përgatitësi i tekstit, aparatin kritik, tabelat, transkriptimet-translimerimet dhe mjetet e tjera ndihmëse) dhe për dokumente arkivore 145€;

1.3. Për materiale folklorike dhe leksikore, për përmbledhjen e Vjetarit dhe materialeve kompjuterike 30€”

Ad. 6.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës H. Islami kërkoi sqarime se pse nuk është nënshkruar ende Protokollin e bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, 2022-2023. Ai tha se seksionet i kanë paraqitur propozimet e tyre me kohë, por nuk ka informacion se a janë marrë parasysh ato propozime. Kryetari Kraja njoftoi se drafti i Protokollit është i gatshëm, por Seksioni i Gjuhës ka caktuar edhe një mbledhje për këtë çështje, ndërsa sa u përket propozimeve të SSHSH-së dhe seksioneve të tjera, ato janë përfshirë të gjitha në draft. Drafti është miratuar në mbledhjen e Kryesisë dhe është thënë që sekretarët e seksioneve të njoftojnë seksionet e tyre për përmbajtjen e draftit të fundit.

Ai tha se, nëse seksionet e konsiderojnë të nevojshme të shqyrtojnë edhe një herë draftin përfundimtar, mund ta bëjnë një gjë të tillë. Kryesia mund të presë edhe disa ditë dhe më pas të procedohet Protokollin për nënshkrim. U tha që seksionet të veprojnë ashtu siç e shohin vetë të nevojshme.

Mbledhja u mbyll në orën 12:20

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmeta Kraja

PROCESVERBAL

Nga mbledhja CVII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 30 qershor 2022, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Anton K. Berishaj, Edi Shukriu, Eqrem Basha, Fejzullah Krasniqi, Feriz Krasniqi, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Justina Sh. Pula, Kujtim Shala, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata, Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Bardh Rugova, Besnik Krasniqi, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Luan Mulliqi, Nysret Krasniqi, Mehmet Halimi, Myzafere Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi, Shkumbin Munishi dhe Xhevdet Xhafa.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CVI të Kuvendit të Akademisë;
2. Miratimi i Programit të punës të ASHAK-ut për vitin 2023;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rregulloreve: Rregullorja për projekte shkencore dhe Rregullorja për organizimin e aktiviteteteve shkencore;
4. Çështje vijuese.

Pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës kryetari Kraja paraqiti fjalën e hapjes dhe tha:

“Të nderuar akademikë, miq dhe kolegë!

Më lejoni t’ju them se gjatë muajve të shkuar, që nga Kuvendi pararendës, marrë në përgjithësi, ne kemi arritur t’i realizojmë objektivat tona kryesore, me aktivitete të ndryshme shkencore dhe artistike, me prezantime botimesh, me konferenca dhe me forma të tjera të punës sonë në vazhdimësi.

Është e radhës të them se Akademia, edhe më shumë se kaq, duhet të bëhet referencë për një prani më të madhe në jetën publike, veçmas kur bëhet fjalë për arritjet më të larta në fushën e shkencës dhe të arteve.

Në këtë pikë mund të them se është arritur një përparim i ndjeshëm, vetëm se disa nga aktivitetet e fundit kanë shtruar nevojën për një kujdes të shtuar, në mënyrë që këto aktivitete publike të mos marrin kuptimin e animet në një krah ose në një krah tjetër politik dhe partiak.

Tani më duhet të them se në fushën e botimit, duke marrë parasysh programin e punës për vitin 2022, ka një ngecje në kuptimin e dorëzimit të veprave për shtyp, dhe kjo na nxit të mos jemi neglizhentë në tre-katër muajt vijues, në mënyrë që plani botues i Akademisë për vitin 2022 të realizohet i plotë, pa ngecje dhe vonesa të mëdha. Meqë e kemi fjalën te botimet, besoj se në të ardhmen do të duhej të zhvillojmë një diskutim të gjerë, veçmas nëpër seksione, për mënyrën si duhet përfshirë në planin tonë botues veprat e autorëve nga jashtë Akademisë, meqë kjo mënyrë siç e kemi tani lë hapësirë për proteksionizëm dhe subjektivizëm. Gjithashtu, duhet të diskutohet gjerësisht profili i botimeve tona, siç është publikimi i lëndës arkivore,

sikundër edhe vetë relevanca e disa projekteve që u shërbejnë autorëve, por nuk kanë impakt në prestigjin e Akademisë.

Më lejoni të them me këtë rast, se që një kohë relativisht të gjatë, veçmas që nga muaji shtator i vitit të kaluar, kur ka skaduar kontrata me operatorin e përparshëm, kemi bërë përpjekje të pareshtura për ta ridizajnuar dhe për ta bërë më funksionale ueb-faqen e Akademisë, e cila pothuajse asnjëherë nuk ka arritur të marrë një formë të përshtatshme dhe të funksionojë si duhet. Përveç që i është ndryshuar forma dhe dizajni, me vendim të Kryesisë është përcaktuar si obligim i nënkryetares që të marrë nën përkujdesje ueb-in, ndërsa sekretarët e seksioneve kanë marrë përsipër që t’i prezantojnë aktivitetet e seksioneve me dinamikën e zhvillimeve që ndodhin. Mbetet që faqja të pasurohet në të ardhmen me vegëzat përkatëse, ku do të përfshihen projektet, botimet dhe revistat, pastaj edhe me vegëzat që mundësojnë leximin e librave ose të punimeve shkencore të anëtarëve të Akademisë, sipas dëshirës dhe vullnetit të tyre.

Një çështje tjetër, që në mënyrë të tërthortë lidhet me këtë problematikë, është paraqitja e në formë digjitale e Fjalorit Enciklopedik të Kosovës. Është marrë një vendim në Kryesi që, pasi të bëhen korrigjimet elementare dhe disa plotësime të domosdoshme, Fjalori të ketë mundësi të shfletohet në ueb-faqen e Akademisë, mirëpo kjo ka dalë e vështirë të realizohet, për shkak të refuzimit të disa redaktorëve, brenda dhe jashtë Akademisë, që të përfshihen në korrigjimet e zërave dhe të lëndës leksikografike.

Gjithashtu duhet të them këtu se Kryesia ka marrë edhe disa vendime që besojmë të ndikojnë në mbarëvajtjen e punëve të Akademisë, të cilat duhet t'i bëj të ditura shkurtimisht: Akademia nuk do të blejë më laptopa, por do të investojë suksesivisht në mirëmbajtjen dhe avancimin e kompjuterëve të zyrave, sepse është vërejtur se pajisja e anëtarëve të Akademisë më kompjuterë portabël është bërë pa ndonjë sistem, madje në mënyrë jo aq të drejtë, prandaj është vendosur që kjo praktikë të ndërpritet.

Lidhur me udhëtimet jashtë vendit, kam obligim t'ju njoftoj sa vijon: pothuajse të gjithë anëtarët e Akademisë marrin ftesa të vazhdueshme për udhëtime, kryesisht për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme shkencore, që mbahen në fushat përkatëse. Tani e tutje, për të vendosur një rend në këtë drejtim, për udhëtimet e këtilla jashtë vendit të anëtarëve të Akademisë duhet të vendosë Kryesia e Akademisë apo, varësisht nga natyra e ftesës, Këshilli për Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Dy fjalë për Bibliotekën e Akademisë. Ne kemi menduar dhe kemi biseduar në Kryesi, se Biblioteka e Akademisë duhet ta ndryshojë formën e deritashme të punës dhe, përveç që duhet të mbledhë, të sistemojë botimet tona dhe botimet e anëtarëve të Akademisë, duhet specializohet në drejtim të grumbullimit dhe sistemimit të librave për Kosovën dhe albanologjinë. Pra, të mos mbledhë dhe të mos blejë më libra me një dedikim të përgjithshëm, qoftë shkencor, qoftë artistik, sepse një grumbullim i tillë i librit nuk paraqet interes për institucionin dhe nuk është funksional. Paralelisht me këtë, Kryesia ka marrë

vendim që Biblioteka e Akademisë të mos pranojë më librin e falur, nga kushdo që vjen, pa një paraqitje të listës së librave të tillë dhe pa një vendim përkatës të Kryesisë.

Çështja e fundit, të cilën dua të shtroj para jush, ka të bëjë me Enciklopedinë Shqiptare. Besoj se jeni në dijeni se para disa ditësh dy qeveritë, e Republikës së Kosovës dhe e Republikës së Shqipërisë kanë nënshkruar marrëveshje për bashkëfinancim të projektit të përbashkët të Enciklopedisë Shqiptare. Inicues të marrëveshjes kanë qenë Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Qeveria e Shqipërisë. Para se të nënshkruhej marrëveshja nga Akademia e Shqipërisë ne kemi marrë draftin e propozuar, të cilin, bashkë me platformën tonë ia kemi vënë në dispozicion kabinetit të kryeministrit të Kosovës përmes një këshilltareje të dërguar prej tij. Duke qenë se marrëveshja e nënshkruar na është vënë në dispozicion me vonesë dhe duke qenë se ende nuk janë qartësuar një sërë çështjesh konceptuale dhe organizative për Enciklopedinë Shqiptare (marrëveshja hyn në fuqi nga fillimi i vitit 2023), në Kryesi e kemi prezantuar mundësinë që në tetor të këtij viti të mbahet një mbledhje e veçantë e Kuvendit të Akademisë, në të cilën do të diskutoheshin dokumentet përfundimtare për këtë projekt: Platforma e ASHAK-ut për Enciklopedinë, marrëveshja e dy qeverive, rregullorja e punës dhe çështje të tjera që lidhen me këtë projekt të rëndësishëm. Tani për tani mund t'ju them, se ne kemi kërkuar që financimi i Enciklopedisë të bëhet ndaras nga financimi i rregullt dhe i programit të punës së Akademisë, gjë që ka hasur në mirëkuptim të

Ministrisë së Financave, por është kërkuar që menaxhimi financiar të bëhet nga Akademia, në përputhje me ligjet në fuqi. Meqë në këtë kohë bëhet planifikimi buxhetor për vitin vijues, ne po përpiqemi të analizojmë kërkesat reale financiare për vitin e parë të realizimit të këtij projekti, duke respektuar të gjitha normat dhe parashikimet adekuate financiare. Për të gjitha çështjet rreth këtij projekti anëtarësia e gjerë e Akademisë do të jetë e informuar në mënyrë periodike, sipas rregulloreve tona dhe mënyrës që e përcaktojnë organet vendimmarrëse të Akademisë.

Ju faleminderit!”

Ad. 1.-

Para miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse kryetari Kraja e njoftoi Kuvendin se në materialet e kësaj mbledhjeje janë përfshirë dy procesverbale, njëri i mbledhjes CV dhe tjetri i mbledhjes CVI. Procesverbali i mbledhjes CV është miratuar nga Kuvendi, me kërkesë që të plotësohet dhe sot e keni përpara të plotësuar, ndërsa procesverbali i mbledhjes CVI tani paraqitet për miratim. Ai e hapi diskutimin, diskutime nuk pati dhe procesverbali i mbledhjes CVI u miratua pa vërejtje me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Kuvendit, me përjashtim të R. Dhomit.

Ad. 2.-

Në vazhdim filloi shqyrtimi i Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2023. Kryetari Kraja tha se përgatitjet për Programin e punës për vitin 2023 kanë filluar me kohë, janë mbajtur nga dy mbledhje të seksioneve. Programi është shqyrtuar edhe nga Kryesia e Akademisë dhe sot jemi këtu për ta

miratuar. Ai filloi paraqitjen e programit me rend sipas seksioneve dhe tha se nëse sekretarët e seksioneve kanë ndonjë plotësim eventual mund ta paraqesin edhe tani. Programi i punës së ASHAK-ut, për vitin 2023 u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.

Programi i punës së ASHAK-ut për vitin 2023 do të botohet në revistën *Vjetari 2023*.

Ad. 3.-

Kuvendi i shqyrtoi rregulloret: Rregullorja për projekte shkencore dhe Rregullorja për organizimin e aktiviteteve shkencore. Kryetari Kraja kërkoj nga J.Sh. Pula, kryesuese e grupit punues për hartimin e rregulloreve që të njoftojë Kuvendin me rrjedhën e punës. J. Sh. Pula njoftoi se grupi punues i ka hartuar draftet e para të rregulloreve, të cilat u janë dërguar të gjithë anëtarëve të Akademisë dhe u janë lënë në dispozicion për një kohë për të paraqitur vërejtje dhe sugjerime eventuale. Draftet e rregulloreve janë shqyrtuar edhe nëpër seksione. Pas shqyrtimit të tyre kemi pranuar disa vërejtje dhe sugjerime dhe shumicën prej tyre i kemi përfshirë në draftet e fundit që sot do t'i shqyrtojmë. Disa plotësime që janë paraqitur pas shpërndarjes së materialeve të Kuvendit i kemi shqyrtuar po ashtu dhe kemi konstatuar se shumica janë përfshirë.

Rregullorja për projekte shkencore u miratua pa vërejtje me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Kuvendit, me përjashtim të R. Dhomit.

Gjatë shqyrtimit të Rregullores për organizimin e aktiviteteve shkencore, S. Gashi dhe J. Bajraktari propozuan që

simpoziumet shkencore të renditen pas konferencave shkencore, ashtu që nenit 3 dhe 4 t'u ndërrohet vendi.

Propozimi u përkrah dhe Rregullorja për organizimin e aktiviteteve shkencore u miratua me plotësimin e lartcekur, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.

Mbledhja u mbyll në orën 11: 50.

Procesmbajtëse
Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmet Kraja

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme CVIII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 27 tetor 2022, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Anton K. Berishaj, Eqrem Basha, Fejzullah Krasniqi, Feriz Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Jusuf Bajraktari, Justina Sh. Pula, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Muhamedin Kullashi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Zeqirja Ballata, Zejnullah Rrahmani dhe anëtarët korrespondentë: Arsim Bajrami, Arsim Morina, Bardh Rugova, Besnik Krasniqi, Fetah Podvorica, Frashër Demaj, Gjyljeta Mushkolaj, Luan Mulliqi, Nysret Krasniqi, Mehmet Halimi, Myzafer Limani, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi dhe Shkumbin Munishi.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja.

Kuvendi e miratoi këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes CVII të Kuvendit të Akademisë;
2. Miratimi i Platformës së përbashkët (ASHAK-ASHSH) për Enciklopedinë Shqiptare;
3. Miratimi i Rregullores për mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të Redaksisë qendrore, të redaksive vendore dhe të redaksive të fushave të Enciklopedisë Shqiptare;
4. Zgjedhja e kryeredaktorit dhe e anëtarëve të Redaksisë qendrore dhe të Redaksisë vendore të Enciklopedisë Shqiptare;

Para shqyrtimit të pikave të rendit të ditës kryetari Kraja në fjalën e tij tha:

“Të nderuar kolegë, ju dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Akademisë!

Sikundër që tashmë jeni në dijeni, që në mbledhjen e rregullt të Kuvendit në qershor, ne jemi marrë vesh ta mbajmë këtë mbledhje, për të shqyrtuar dokumentet dhe strukturat organizative, që kanë të bëjnë me Enciklopedinë Shqiptare.

Projekti është i një rëndësie të veçantë dhe në këtë kuadër, Akademia merr një përgjegjësi shtesë, për të realizuar një ndërmarrje me një peshë të veçantë në fushën e dijes dhe të shkencës.

Ashtu sikundër edhe ndonjë herë tjetër, nismën për këtë projekt e ka marrë Akademia e Shkencave të Shqipërisë, me një ndryshim se kësaj here koordinimi ndërmjet dy akademive ka qenë më i mirë, më i

plotë dhe, që ka më shumë rëndësi, projekti ka gjetur mbështetjen e dy qeverive, të Kosovës dhe të Shqipërisë.

Tani mund t'ju them se kjo fazë përgatitore, për të arritur në këtë pikë ku jemi tani, me qëndrime të harmonizuara për të gjitha çështjet kryesore, ka zgjatur më shumë se dy vjet. Harmonizimi i qëndrimeve dhe pikëpamjeve në këtë fazë ka qenë i domosdoshëm, sepse nuk është fshehtësi se kemi koncepte, ide dhe përvoja të ndryshme lidhur me shumë çështje që kanë të bëjnë me dijen enciklopedike dhe me mënyrën e përfshirjes së saj në një vepër të përbashkët.

Tani ju keni përpara dy dokumente, që përbëjnë bazën kryesore të konceptit dhe të mënyrës së punës në hartimin e Enciklopedisë Shqiptare, Platformën e përbashkët dhe Rregulloren për mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të Redaksisë qendrore, të redaksive vendore dhe të redaksive të fushave të Enciklopedisë Shqiptare. Bashkëngjitur iu kemi vënë në dispozicion edhe propozimin e seksioneve për nga dy anëtarë të Redaksisë vendore, gjithsej tetë, pesë nga të cilët, përfshirë edhe kryeredaktorin, do të përfaqësojnë Akademinë në Redaksinë qendrore të Enciklopedisë. Gjithashtu ju kemi vënë në dispozicion propozimin e një Këshilli të ngritur nga Kryesia për kandidatin e mundshëm të kryeredaktorit të Enciklopedisë. Menjëherë më duhet t'ju them se ky Këshill ad hoc u ngrit nga Kryesia, sapo u vu në diskutim një konflikt i mundshëm interesi që Kryesia të bënte propozimin për kryeredaktorin e Enciklopedisë, i cili në këtë rast qëlloi të ishte edhe kryetar i Akademisë. Meqë mori miratimin e Kryesisë, ky Këshill, i përbërë nga përfaqësuesit e të gjithë seksioneve, në të ardhmen do të

marrë rolin e një mbikëqyrësi të punëve të përgjithshme rreth Enciklopedisë.

Bashkë me këto dokumente ju kemi vënë në dispozicion edhe marrëveshjen e dy qeverive, të Kosovës dhe të Shqipërisë, në hartimin e së cilës, më duhet t'ju them, ne nuk kemi marrë pjesë, prandaj ndonjë "shkarje" që është vërejtur në Marrëveshje, mund të jetë korrigjuar me Platformën ose me Rregulloren.

Kemi punuar gjatë për t'i harmonizuar këto dokumente, dhe tani që i keni përpara, duhet ta merrni parasysh se bëhet fjalë për dy shtete, për dy subjekte institucionale, për dy akademi që përfshihen në një projekt të përbashkët: dy shtete që kanë legjislacion të ndryshëm, dy institucione që kanë specifikat e tyre, dy akademi që kanë subjektivitet të veçantë legjislativ dhe institucional.

Edhe me këtë rast, më lejoni të tërheq vëmendjen tuaj, se bëhet fjalë për Platformë të përbashkët, të harmonizuar tërësisht midis dy palëve dhe për Rregullore, zbatimi i së cilës do të nisë që në fillim të vitit të ardhshëm nga të dy palët bartëse të projektit.

Në fund më lejoni t'ju them se ndërkohë, bashkë me Akademinë e Shqipërisë, kemi hartuar Protokollin e përbashkët financiar, i cili do të nënshkruhet nga dy ministret e arsimit dhe shkencës, të autorizuara nga qeveritë përkatëse.

Me miratimin e këtyre dokumenteve në këtë Kuvend dhe me nënshkrimin e Protokollit të përbashkët nga ministritë mund të konsiderohet e përmbyllur faza e parë, faza përgatitore e realizimit të projektit Enciklopedia Shqiptare.

Ju faleminderit!

Ad. 1.-

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutoi J. Bajraktari dhe tha se ka vërejtje për diskutimin e kryetarit Kraja, faqja 1 e procesverbalit, paragrafi 3 dhe faqja 2, fundi i paragrafit 1. Ai tha se nuk i takon kryetarit të përzihet në punën e seksioneve, siç ka ndodhur te SSHSH-ja duke bërë pengesa dhe se diskutimi i tillë bart subjektivizëm të theksuar. Ai po ashtu tha se paraqitja publike e fundit e kryetarit nuk i bën nder as SSHSH-së e as Akademisë.

Pas diskutimit të J. Bajraktarit, meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetari Kraja propozoi që diskutimi i J. Bajraktarit të përfshihet në procesverbalin e kësaj mbledhjeje dhe e paraqiti për miratim procesverbalin.

Propozimi u miratua njëzëri dhe procesverbali i mbledhjes CVII të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Kuvendi e shqyrtoi Platformën e përbashkët (ASHAK-ASHSH) për Enciklopedinë Shqiptare. Kryetari Kraja e njoftoi Kuvendin se Platforma është shqyrtuar nëpër seksione, janë marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet dhe sot e kemi për diskutim dhe miratim. H. Islami në diskutimin e tij paraqiti disa vërejtje si në vijim:

Tha se ka pritur që me materiale të Kuvendit anëtarëve të Akademisë t'u vihet në dispozicion edhe Marrëveshja e dy qeverive, por kjo nuk ka ndodhur; Ka pritur që t'i bëhet me dije Kuvendit që vërejtjet dhe sugjerimet më kryesore, që tani më janë në Platformë, janë propozuar pikërisht nga SSHSH-ja. Këshilli i Enciklopedisë është propozuar pikërisht nga SSHSH-ja dhe është

propozim me vend, sepse Kryetari i Akademisë nuk mund të jetë në krye çdokund; Duhet të definohet pse projekti quhet "Projekt madhor në albanologji"; Tha se ky Kuvend nuk është dashur të quhet i jashtëzakonshëm, sepse nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Kuvend të jashtëzakonshëm Akademia ka mbajtur vetëm një herë. Ky nuk është rast i rrallë, meqë ky projekt ka qenë për vite të tëra në programin e punës së Akademisë, ka pasur shumë entuziazëm edhe atëherë, por nuk kanë ecur punët, sepse ka munguar gatishmëria nga ana e ASHSH-së. H. Islami më pas tha se është mirë që tani ka gatishmëri nga qeveritë dhe ASHSH-ja, por se ky është projekt madhor dhe në të nuk punojnë grupet, por punojnë breza të tërë, dhe se nuk e kupton këtë nguti e cila duket shumë populiste. Ne e kemi bërë Fjalorin Enciklopedik pa pasur ndonjë përvojë të madhe dhe ia kemi arritur. Ai po ashtu bëri vërejtje që Rregullorja nuk ka kaluar për shqyrtim nëpër seksione, sepse duhet të dihet kush e ka hartuar atë dhe në fund tha se puna në projekt kërkon mbështetje administrative, prandaj duhet ta aktivizojmë QLE-në, të angazhojmë njerëz dhe për këtë duhet të kërkojmë mjetet financiare, se pa to nuk mund të ketë punë efektive.

Lidhur me vërejtjet dhe pyetjet e H. Islamit, diskutoi M. Kraja. Ai tha se Marrëveshja e dy qeverive nuk u është ndarë anëtarëve të Akademisë, meqë nuk është dokument i ASHAK-ut, nuk jemi pyetur për të, na ka ardhur e gatshme dhe nuk kemi pasur pse ta diskutojmë; Sa i përket asaj që propozimet kanë dalë nga SSHSH-ja ai tha se e tha në fillim që janë marrë parasysh propozimet e seksioneve dhe se Këshilli i Enciklopedisë është ngritur

sipas propozimit të bërë; Emërtimi projekt në albanologji është rregulluar në Platformë; Është vendosur nga Kryesia të thirret Kuvend i jashtëzakonshëm për shkak të afateve kohore, sepse këto dokumente, sipas Marrëveshjes së qeverive duhet të dorëzohen më 31 tetor dhe nuk kemi pasur në dispozicion 15 ditë për ta thirrur Kuvendin e rregullt; Platforma është hartuar nga grupi punues, anëtarët e të cilit janë caktuar nga seksionet. Emrat e grupit sipas kërkesës së SSHSH janë përfshirë në Platformë. Ai tha se e ka bërë draftin e Platformës dhe më pas të njëjtin e ka diskutuar me të gjithë anëtarët e grupit. Përpos S. Hamitit që kanë punuar bashkë, nga anëtarët e tjerë të grupit ka marrë mbështetje që ta procedojë tutje; Sa i përket Rregullores ai tha se është hartuar nga grupet punuese të të dy akademive (grupi i ASHAK –ut është caktuar nga Kryesia) dhe është në përputhje me Platformën. Nëpër seksione nuk kemi arritur ta kalojmë për shkak të afateve kohore; Dhe në fund për punën e QLE-së M. Kraja tha se nuk mund të hapim njësi të reja, por do të angazhojmë ekspertë shkencorë dhe me punët administrative do të merret administrata e Akademisë.

Në vazhdim diskutuan N. Daci, A. K. Berishaj, S. Hamiti, Z. Rrahmani dhe R. Ismajli.

N. Daci në diskutimin e tij tha se e përkrah projektin e Enciklopedisë Shqiptare dhe se edhe ai vetë në kohën sa ishte Kryetar i Akademisë ka realizuar takime me ASHSH-në për fillimin e këtij projekti. Ai po ashtu përmendi vështirësitë që kanë pasur në të kaluarën dhe përmendi kontributin e madh e të çmuar që H. Islami kishte

dhënë në atë kohë, por siç tha ai atëherë ka munguar gatishmëria nga ASHSH-ja. Tani vazhdoi ai, ka gatishmëri dhe ne bashkërisht do t'ia dalim, ashtu siç ia kemi dalë edhe me Fjalorin Enciklopedik. N. Daci e inkurajoi M. Krajën që ta shtyjë përpara projektin dhe e përgëzoi për punën e bërë në këtë fazë.

A. K. Berishaj tha se në Platformë figuron emri i tij, porse ai si anëtar i grupit nuk ka marrë pjesë në asnjë takim për hartimin e saj.

Me këtë rast ndërhyri M. Kraja dhe tha se dokumentet e kësaj natyre nuk mund të punohen njëkohësisht nga disa persona. Ai tha se e ka hartuar draftin e Platformës të cilin ua ka ndarë anëtarëve të grupit dhe me të gjithë ka pasur takim për diskutimin e saj në zyrën e tij. Nga të gjithë (N. Daci, R. Dhomi, A. K. Berishaj) ka marrë miratimin, më pas ka punuar në Platformë dhe e ka finalizuar atë bashkë me S. Hamitin.

Më pas diskutoi S. Hamiti i cili tha se kanë qenë katër veta në grup, nga secili seksion nga një. Unë kam qenë në atë grup, kam punuar dhe jam shumë i kënaqur me punën që është bërë dhe me tekstin e Platformës. Pra kush ka dashur të punojë ka punuar, të tjerët e kanë pranuar dhe i falënderoj.

Z. Rrahmani në diskutimin e tij tha se u diskutua çështja e Kuvendit të jashtëzakonshëm, porse tani po dalin edhe gjëra të jashtëzakonshme. Po del Marrëveshja e qeverive, po del që QLE-ja nuk mund të funksionalizohet, sepse nuk ka mjete financiare për të. Duhet të kërkohen mjete financiare. Pajtohet me H. Islamin se nuk është dashur të ketë nguti. Ai po ashtu paraqiti vërejtje se pse selia të jetë vetëm në Tiranë, kur ka mundur të bëhet atje dhe këtu në

Prishtinë dhe dokumentacioni të ruhet këtu dhe atje. Ai në fund paraqiti edhe disa vërejtje për Rregulloren.

Pas diskutimit të Z. Rrahmanit, M. Kraja tha se për punën emërtimit të mbledhjes së Kuvendit dhe për punën e QLE-së u dhanë sqarimet më parë, ndërsa sa i përket çështjes së selisë ajo mbetet vetëm në Tiranë, nuk mund të ketë dy seli, sepse nisma ka dalë nga ta, ndërsa dokumentacioni do të ruhet njëjtë në të dy akademitë. Lidhur me vërejtjet për Rregulloren, ai tha se Platforma është ajo që përcakton parimet, ndërsa Rregullorja i saktëson gjërat.

Diskutoi më pas R. Ismajli, i cili tha se ka qenë i kyçur edhe në të kaluarën për punën e Enciklopedisë Shqiptare dhe ka përvojë. Në të kaluarën nuk ka pasur bashkëpunim, shpresoj që tani do të jetë ndryshe. Ne kemi vullnet për punë, por duhet të jemi të kujdesshëm që të mos dështojmë, sepse kërkohet shumë punë dhe mund të vijmë në situatë të merremi vetëm me Enciklopedi dhe t'i lëmë anash punët e tjera. R. Ismajli në vazhdim tha se Qeveria ka dhënë urdhër, por tani duhet të japë edhe mjete financiare. Në fund ai tha se dokumentacioni duhet të ruhet patjetër në Tiranë dhe në Prishtinë.

Pas diskutimeve Kuvendi me shumicë votash dhe tri abstenime (H. Islami, Z. Rrahmani dhe A. K. Berishaj) e miratoi Platformën e përbashkët (ASHAK-ASHSH) për Enciklopedinë Shqiptare.

Ad. 3.-

Në vazhdim u shqyrtua Rregullorja për mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të Redaksisë qendrore, të redaksive vendore dhe të redaksive të fushave të Enciklopedisë Shqiptare. Kryetari Kraja

paraqiti në pika të shkurtra rrjedhën e punës në rregullore. Ai tha se rregullorja ka qenë kërkesë e Marrëveshjes ndërqeveritare. Është hartuar bashkë me ASHSH-në dhe se nuk ka qenë e lehtë të hartohet, marrë parasysh që jemi dy institucione dhe dy shtete me specifika të ndryshme.

Ai e hapi diskutimin dhe meqë diskutime nuk pati, rregullorja u paraqit për miratim. Ajo u miratua unanimisht nga Kuvendi.

Ad. 4.-

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kuvendi u njoftua me propozimet e strukturave redaksionale të Enciklopedisë Shqiptare.

Kryetari Kraja e njoftoi Kuvendin se propozimet për anëtarët e Redaksisë qendrore dhe Redaksisë vendore janë paraqitur nga seksionet e ASHAK-ut, ndërsa propozimi për Kryeredaktorin/drejtuesin i është paraqitur Kryesisë nga Këshilli i Enciklopedisë dhe Kryesia e ka proceduar për miratim në Kuvend. Ai tha po ashtu se seksionet i kanë paraqitur propozimet për Redaksinë qendrore dhe atë vendore, pos Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë që i ka paraqitur dy emra, pa bërë ndarjen e tyre sipas redaksive. Lidhur me këtë çështje S. Hamiti e propozoi R. Ismajlin për anëtar të Redaksisë qendrore.

Në diskutimin e tij H. Islami, tha se pajtohet me emrat e propozuar, por tërhoqi vërejtjen se disa nga këta emra janë anëtarë të Kryesisë dhe mund të kenë angazhime të shtuara.

Kryetari Kraja tha se propozimet janë të seksioneve dhe se duhet respektuar.

Më pas Kuvendi unanimsisht mori vendim për zgjedhjen e strukturave redaksionale, Redaksia vendore dhe Redaksia qendrore e Kosovës (ASHAK-ut) për projektin shkencor Enciklopedia Shqiptare, si në vijim:

Redaksia vendore:

1. Akademik Mehmet Kraja
Kryeredaktor/drejtues
2. Akademik Rexhep Ismajli
3. Akademik Jusuf Bajraktari
4. Akademik Nexhat Daci
5. Akademik Rauf Dhomi
6. Akademik Sabri Hamiti
7. Akademik Anton K. Berishaj
8. Akademik Fejzullah Krasniqi
9. Anëtar korrespondent Luan Mulliqi

U tha që anëtarët e Redaksisë vendore, akademikët: Mehmet Kraja, Rexhep Ismajli, Jusuf Bajraktari, Nexhat Daci dhe Rauf Dhomi do të përfshihen (janë anëtarë) të Redaksisë qendrore.

Mbledhja u mbyll në orën 12: 40.

Procesmbajtëse
Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Mehmet Kraja

Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Albin Kurti viziton ASHAK-un



Në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti së bashku me ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Murati dhe zëvendësministri i Ekonomisë, z. Mentor Arifaj, u pritën nga akademiku z. Mehmet Kraja, Kryetar i Akademisë së Shkencave Akademik, akademike znj. Justina Pula, nënkryetare dhe anëtarët e ASHAK-ut.

Në pritjen e sotme, kryeministri Kurti u shpreh mirënjohës për kontributin dhe rolin historik e kulturor, por gjithnjë edhe politik e akademik të anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK).

Ne besojmë se progresi socio-ekonomik, jeta e dinjitetshme e qytetarëve në Republikë, varet sa nga demokracia, përfaqësimi e vendimmarrja me integritet e kompetencë, po ashtu edhe nga konsiderata e pazëvendësueshme për shkencën, tha kryeministri Kurti. Në

këtë fushë për shkencën, por në të tjerat edhe për artin e kulturën, shtoi ai.

Gjatë takimit u potencua interesimi i Qeverisë dhe ASHAK-ut, për bashkëpunim të ngushtë. Kryeministri theksoi domosdoshmërinë e bashkëpunimit jo vetëm në sektorin e energjisë, por edhe në fusha të tjera.

Ai veçoi rëndësinë e qëndrueshmërisë së furnizimit dhe konsideratën gjeopolitike, meqë energjia sot është bërë kryefjalë e politikës dhe gjeopolitikës, jo vetëm në vendin tonë.

Duhet të kemi parasysh konsideratat mjedisore, meqenëse siç thotë një fjalë e urtë, të tashmen e kemi jo vetëm trashëgimi nga paraardhësit tanë, por në një farë mënyre edhe hua nga brezat e ardhshëm, për shkak se çfarëdo që bëjmë ne, kemi kosto për brezat që do të vijnë pas nesh, tha kryeministri Kurti.

Në këtë takim, akademik z. Fejzullah Krasniqi, prezantoi raportin e ASHAK-ut për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë, një dokument për analizën dhe sugjerimet për zhvillimet e ardhshme në sektorin e energjisë. U theksuan të gjeturat e raportit për opsionet për furnizim të qëndrueshëm e me çmim të arsyeshëm për konsumatorët.

Koncert artistik me vepra të akademik Zeqirja Ballatës

Koncerti u mbajt më 16 shkurt 2022. Veprat e akademik Ballatës u ekzekutuan nga interpretët e solistët e mirënjohur të Kosovës, si: Adhurim

Grelda-Bariton, Lirika Pula-Piano, Lule Ballata-Flaut, Shkumbin Bajraktari-Klarinet, Meriton Ferizi – Fagot, Visar Kuçi- Violinë, Antonio Gashi- Violonçel, Avni Krasniqi-Trumpetë, Ardit Pira-Trumpetë, Betim Krasniqi-Trombon, Bledar Bujupi-Kornë, Meriton Ferati-Tubë dhe Tringa Sadiku –Kitarë.

Akademikët Nexhat Daci dhe Rauf Dhomi shpallen anëtarë të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Më 25 shkurt akademikër Nexhat Daci dhe Rauf Dhomi morën pjesë në ceremoninë solemne të asamblesë së ASHSH-së në të cilën u shpallën anëtarë të jashtëm të saj.

Mbahet Panairi mbarëkombëtar i librit akademik

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në kuadër të veprimtarive kushtuar 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me bashkëpunimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, organizuan Panairin mbarëkombëtar të librit akademik, më 22-24 prill.

Pjesëmarrës në panair ishin: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Institute dhe qendra shkencore publike: Akademia e Studimeve Albanologjike (Tiranë), Instituti Albanologjik I Prishtinës (Kosovë), Instituti i Historisë (Kosovë), Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (Maqedoni e Veriut), Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë (Tiranë), Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (Kosovë), Muzeu Historik Kombëtar (Tiranë), Institucione të Arsimit të Lartë

(publik): Universiteti i Tiranës, Universiteti Mjekësor i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej”, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Universiteti i Korçës “Fan Noli”, Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali”, Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu” Universitete publike në Kosovë: Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” Universitete publike në Maqedoninë e Veriut: Universiteti Shtetëror i Tetovës, Universiteti i Europës Juglindore, Tetovë, Universiteti i Shkupit “Nënë Tereza” Ente botuese nga Mali i Zi: Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë, Art-Club, Ulqin Nga ente botuese jopublike: Botimet Çabej, Shtëpia Botuese “Dritëro”, Shtëpia Botuese “Onufri”, Shtëpia Botuese “Toena”, Shtëpia Botuese “Naimi”, Shtëpia Botuese “Papyrus”, Shtëpia Botuese “Mediaprint”.

Në ditët e panairit kishte promovime të botimeve akademike shkencore dhe universitare: monografi dhe periodikë shkencorë të institucioneve dhe qendrave kërkimore etj. Panairi i parë i librit akademik dhe shkencor, përveç ekspozimit të literaturës shkencore e informuese për veprimtarinë kërkimore shkencore në hapësirën shqiptare, përmes promovimeve të arritjeve në nivel akademik; përmes paraqitjes së disa botimeve të kërkuesve shkencorë, studiuesve, trupave pedagogjike, krijoi edhe hapësira dhe mundësi diskutimi për çështje e tema specifike të dijeve shqiptare. Libri shkencor për herë të parë në këtë panair solli pranë e bashkoi në një eksperiencë të veçantë akademikët, kërkuesit, studiuesit, pedagogët, lexuesit e specializuar, duke ofruar mundësi më të drejtpërdrejta

kontaktesh, duke krijuar hapësira bashkëpunimi dhe ndërveprimi të mendimit dhe kërkimit akademik universitar. Promovimet u zhvilluan me pjesëmarrje të hapur, me mundësi diskutimi.

Ligjëratë e akademikut të Akademisë Slovene Vinko Dolenc



Seksioni i Shkencave të Natyrës më 19 maj 2022, me iniciativën e anëtarit korrespondent, Arsim Morina, e ka organizuar ligjëratën e akademikut sloven, prof. Vinko Dolenc me titull “Erërat, ujërat dhe mendimet nuk respektojnë kufijtë”.

Tubimin e hapi sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës, anëtari korrespondent Fetah Podvorica i cili ndër të tjera theksoi se ligjëratat e akad. Vinko Dolenc, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Sllovenisë dhe emër i njohur i neurokirurgjisë në botë realizohet në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që e ka ASHAK-u me Akademinë Slovene të Shkencave dhe Arteve.

Anëtari korrespondent Arsim Morina bëri një prezantim të përmbledhur të biografisë dhe të veprimtarisë shkencore shumë të begatë të akademik Vinko Dolenc, emër ky i njohur në fushën e neurokirurgjisë në

nivel botëror që dëshmohej me punime të shumta shkencore, si dhe me libra autorialë. Ky njihet si pionier i aplikimit të teknikave mikrokirurgjikale në kirurgjinë e aneurizmës në fazën akute. Në vazhdim të fjalës së vet, anëtar korrespondent Arsim Morina solli shembuj të shumtë të kontributit shkencor të prof. Dolenc për dekada me radhë, me të cilin ka bashkëpunuar për një kohë të gjatë edhe vetë prof. Morina.

Pas fjalës së prof. Morinës, akademik Dolenci e mbajti ekspozueun e vet gjatë 45 minutave në të cilën ai i paraqiti disa nga rezultatet e rëndësishme në kuadër të punës së vet shkencore.

U mbajt simpoziumi shkencor “Institucionalizimi i Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992”



Në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 24 maj 2022, me fillim në orën 10:00, u mbajt simpoziumi shkencor “Institucionalizimi i Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992”, organizuar nga Seksioni i Shkencave Shoqërore.

Është realizuar ekspozita kolektive *Thurje kosovare*

Ajo u hap në mjediset e Akademisë, më 26 maj 2022. U prezantuan vepra artistike të artisteve tona të njohura.

Ekspozita u përcoll me program të shkurtër artistik, me vepra të interpretuara nga grupi “Zana” të shoqëruara me piano nga pianisti Edon Ramadani.

U mbajt konferenca shkencore “Kritika dhe studimet letrare shqipe në shekullin XXI”



Me organizim të përbashkët të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK) dhe të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nën përkujdesjen e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë së ASHAK-ut, në Prishtinë u mbajt konferenca shkencore nga fusha e letërsisë “Kritika dhe studimet letrare shqipe në shekullin XXI”. Në këtë konferencë njëditore u paraqitën afro njëzet kumtesa nga studiues të kësaj fushe nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, në të cilat u trajtuan zhvillimet kryesore në këtë fushë në këto dy deceniet e para të shekullit XXI.

Akademik Ali Aliu në fjalën e hapjes foli për trendet e përgjithshme që e kanë

karakterizuar kritikën dhe studimet në fushën e letërsisë shqipe gjatë kësaj periudhe, ndërsa akademik Sabri Hamiti u kushtoi vëmendje raporteve mes krijuesit, lexuesit, autorit dhe kritikut. Anëtarë korrespondent, Nysret Krasniqi, në kumtesën e tij trajtoi çështje që lidhen me raportet e kritikës letrare me dijet teorike, teksa dr. Lindita Aliu foli për zhvillimet e njëkohshme të kritikës letrare brenda botës akademike, autoritetet e së cilës mbështeten në metodologji dhe profesionalizëm dhe kritikën letrare publike, e cila synon formimin e shijes letrare dhe popullarizimin e letërsisë. Akademik Shaban Sinani, ndërkaq, trajtoi çështje që lidhen me autorecensiminin e veprave letrare tek autorët shqiptarë, ndërsa dr. Dhurata Shehri foli për kritikën e realizmit socialist, e cila mbijetoi edhe pas rënies së realizmit socialist.

Kumtesat e tyre i lexuan edhe Persida Asllani, Zeqirja Neziri, Arben Prendi, Muhamet Hamiti, Afrim Rexhepi, Kujtim M. Shala, Anton Gojçaj, Laura Smaqi etj.

U paraqit botimi “Studimet për shqiptarët në Francë”



Në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të

mërkurën, me datë 15 qershor, në orën 11:00, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Seksioni i Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut, paraqitën botimin e akteve të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Studimet për shqiptarët në Francë”. U paraqitën botimet “Pozita gjeografike, politike dhe popullsia shqiptare në dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe 1912-1918”, “Shqiptarët gjatë vitit 1943 sipas dokumenteve ushtarake gjermane” dhe “Shqiptarët në përfundim të Luftës së Dytë Botërore (1944) sipas burimeve gjermane”

Aktivitetin e shpalli të hapur akademik Sabri Hamiti, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, i cili falënderoi pjesëmarrësit, prezantoi strukturën e botimit duke theksuar traditën e ndërkomunikimit kulturor shqiptar-frëng, e cila tashmë përbën një histori albanistike.

Për botimin “Studimet për shqiptarët në Francë” folën: akademik Rexhep Ismajli, akademik Muhamedin Kullashi dhe anëtari korrespondent, Nysret Krasniqi.

Akademik Rexhep Ismajli, në formë të përmbledhur, sintetizoi autorë e vepra, për të krijuar kështu një pamje të historisë së albanologjisë të parë nga prizmi i dijes frënge, e cila shërben si njohje e rinjohje moderne, e cila është prezantuar në botimin “Studimet për shqiptarët në Francë”.

Akademik Muhamedin Kullashi vlerësoi botimin e kësaj vepre dhe prezantoi studime e tekste të autorëve frëngë për shqiptarët duke u përqëndruar në historinë e diplomacisë, me fokus nga vitet nëntëdhjetë të shekullit të kaluar e këndej.

Ndërkaq anëtari korrespondent, Nysret Krasniqi, paraqiti një mozaik të teksteve teorike-letrare dhe kulturologjike të cilat përbëjnë diskursivitetin kulturor për shqiptarët në Francë, të botuara në veprën “Studimet për shqiptarët në Francë”.

U paraqitën botimet “Pozita gjeografike, politike dhe popullsia shqiptare në dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe 1912-1918”, “Shqiptarët gjatë vitit 1943 sipas dokumenteve ushtarake gjermane” dhe “Shqiptarët në përfundim të Luftës së Dytë Botërore (1944) sipas burimeve gjermane”



Më 17 qershor 2023 në ASHAK-u paraqitën botimet:

1. POZITA GJEOGRAFIKE, POLITIKE DHE POPULLSIA SHQIPTARE NË DOKUMENTET DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË JASHTME TË BRITANISË SË MADHE 1912-1918, Prishtinë 2021, i autorit Frashër Demaj.

Për botimin foli recensenti Akademik Jusuf Bajraktari i cili e vlerësoi lart duke e quajtur arritje kulmore botimin e kësaj monografie. Një fjalë të shkurtër mbajti edhe autori i këtij studimi Frashër Demaj.

2. SHQIPTARËT GJATË VITIT 1943 SIPAS DOKUMENTEVE USHTARAKE GJERMANE”, Prishtinë 2021, përgatitur nga Frashër Demaj, Jusuf Bajraktari e Teki Kurti.

Për botimin foli Arsim Bajrami, në cilësinë e recensentit i cili në mënyrë të sintetizuar foli për cilësinë dhe përmbajtjen e botimit.

3. SHQIPTARËT NË PËRFUNDIM TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE (1944) SIPAS BURIMEVE GJERMANE, Prishtinë 2021, përgatitur nga Jusuf Bajraktari, Frashër Demaj e Teki Kurti.

Për botimin foli Fehmi Rexhepi, specialist i periudhës. Profesor Rexhepi vuri thekse në dokumentet që trajtojnë marrëdhëniet ndërmjet krahëve politikë shqiptarë, urdhëresat e komandave gjermane, luftimet dhe ngjarjet e tjera të vitit 1944 nga këndvështrimi i dokumenteve gjermane.

Në fund, në emër të përgatitësve falënderoi Jusuf Bajraktari.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, vizitoi Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës



Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me

bashkëpunëtorët e tij, prof. dr. Ardian Gola dhe z. Ilir Kërçeli, me datë 21 qershor 2022 i bëri një vizitë Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ku u prit nga kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja dhe anëtarët e Kryesisë së Akademisë, akademik Justina Sh. Pula, nënkryetare, akademik Sabri Hamiti, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore, anëtar korrespondent Fetah Podvorica, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe znj. Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Në takim u bisedua për aktivitetet dhe punën shkencore të Akademisë, për projektet dhe angazhimet e këtij institucioni më të lartë të dijes në fushat e ndryshme, përfshirë edhe projektin e përbashkët të kësaj akademie me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, për hartimin e Enciklopedisë Shqiptare. Kryetari Konjufca tregoi gatishmëri për bashkëpunimin institucional me Akademinë e Kosovës dhe shprehu mbështetje për projektet e Akademisë në fusha të ndryshme të shkencës dhe të arteve.

U paraqitën botimet “Në botën e përbashkët: tradita, tranzicioni, anomia”, dhe “Fshehja e krimit: politika serbe e mashtrimeve të mëdha në Kosovë”

Në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, të enjten, me datë 23 qershor, në orën 11:00, Seksioni i Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut paraqiti botimet:

1. "Në botën e përbashkët: tradita, tranzicioni, anomia" Anton K. Berishaj, Prishtinë 2021 dhe
2. "Fshehja e krimit: politika serbe e gënjeshtreve të mëdha" nga Anton Vukpalaj, Prishtinë 2021.



Për botimin "Në botën e përbashkët: tradita, tranzicioni, anomia" folën akademik Muhamedin Kullashi, recensent dhe akademik Anton K. Berishaj, autor.

Për botimin "Fshehja e krimit: politika serbe e gënjeshtreve të mëdha" folën akademik Anton K. Berishaj, recensent dhe Anton Vukpalaj, autor.

Akademini e vizitoi ambasadori i Malit të Zi në Kosovë

Akademini e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, më 25 korrik 2022 e vizitoi ambasadori i Malit të Zi në Kosovë z. Mirsad Bibović

Ambasadori Bibović u prit nga kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, akademike Justina Sh. Pula, nënkryetare dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqi, sekretar shkencor.


Kryetari Kraja pasi e falënderoi Ambasadorin për vizitën e njoftoi atë me punën e Akademisë dhe për marrëveshjen e bashkëpunimit me

Akademini e Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi.

Ambasadori Bibović shprehu gatishmërinë e tij për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, si dhe për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës me Akademini e Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi. përmes realizimit të kontakteve në mes tyre.

Iku albanologu e dijetari Leonard Newmark (1929-2022)

In memoriam



Me vonesë morëm vesh lajmin e hidhur të ndarjes nga kjo botë e studiuesit të shquar, gjuhëtarit, njërit nga albanologët më të rëndësishëm amerikanë, një nga profesorët e shquar të Universitetit të Kalifornisë në San Diego, personalitet që dha ndihmesa të shumta për ndërtimin e kapaciteteve të Universitetit *La Jolla*, në veçanti të ngritjes së studimeve për gjuhët. Profesor Leonard Newmark (Njemark) u nga nga kjo botë më 2 maj 2022 në moshën 93-vjeçare pas një sëmundjeje të gjatë Parkinson dhe pastaj të ndjekur

nga dementia, më në fund e pësoi nga COVID. Në shënimet e La Jolla-s Leonard Newmark cilësohej me tone të ngrohta vlerësimi shumë të lartë: “Shumë kanë komentuar duke thënë se Leonardi ishte më i zgjuari dhe personi më kurioz që kishin takuar”; “Ai ishte njeri i Renesancës që rrallë ishte i kënaqur, sidomos me punën e tij. Ai i shtyri kufijt e besimeve dhe metodologjive të pranuar përgjithësisht, duke sfiduar kështu status quo-në”.

JETA DHE VEPRAT

Leonard Newmark ishte fëmijë i një familjeje imigrantësh fshatarë. Shkollimin e nisi në Universitetin e Chicago-s në moshën 15-vjeçare, diplomën e parë e mori në moshën 18-vjeçare. Pastaj studioi gjuhësi në Universitetin Indiana dhe më 1954 iu bashkua Universitetit Shtetëror të Ohio-s, për t'u kthyer më vonë si profesor i asociuar i Universitetit Indiana. Më 1963 u ftua si profesor në Universitetin e Kalifornisë në San Diego, ku themeloi departamentin e gjuhësisë dhe drejtoi Programin Themelor Gjuhësor, Qendrën për hulumtim në Nxënien e Gjuhëve dhe Programin Amerikan për Gjuhë dhe Kulturë. Kishte shoqërimi të shumta me specialistë të fushave të ndryshme në dijet e sakta dhe në shkencat shoqërore, sidomos në fushën e muzikës. Universiteti i Harvardit e kishte ftuar dy herë për të kaluar atje, por lidhjet e tij me Universitetin e Kalifornisë e bënë të mos ikte atje. Gjurmët e tij në atë Universitet janë të hetueshme dhe pasardhësit kanë dëshirë t'i pohojnë vazhdimisht. Fushat e tij të studimit ishin: nxënja e gjuhëve, historia e gjuhës angleze dhe studimet për shqipen. Për merita të veçanta në fushën e

studimeve albanologjike profesor Leonard Newmark në vitin 2000 u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Leonard Newmark ka lënë prapa të shoqen Ruth dhe dy fëmijët Katya dhe Mark.

STUDIMET PËR SHQIPEN

Siç ka treguar dhe vetë në Parathënie të veprës së tij Structural Grammar of Albanian (1957), Leonard Newmark-u kishte marrë kontakt me çështje të gramatikës së shqipes qysh në vitin 1951, kur kishte pasur mundësinë që në kuadër të përgatitjes për mësimin e shqipes në Programin Air Force Language Training të Universitetit Indiana të bashkëpunonte me pesë folës të shqipes për tre vjet me radhë. Sa i përket vetë përshkrimit të gjuhës shqipe, ai kishte përzgjedhur të kufizohej tek e folmja e njërit prej tyre për të folmen e qytetit të Beratit, gjithë duke synuar evitimin e përzjerjeve dialektore. Dhe nga ajo punë ai nxori librin e përmendur, që paraqet një përshkrim të gjerë të të folmes së Beratit, sipas modeleve të përshkrimeve strukturale të kohës në ShBA, por duke mëtuar kështu dhe një gramatikë të shqipes. Në studimet dialektologjike për shqipen ka pasur dhe autorë të tjerë që janë marrë me të folmen e Beratit, kuptohet, me mënyra të tjera të punës. Kjo vepër e ruan vlerën e vet qoftë për modelin përshkrues, qoftë edhe për faktin se kemi mundësi të bëjmë krahasime për këtë të folme me rëndësi të arealit tosk në një kohë të caktuar. Në vitet në vijim, Newmark-u është marrë me hartimin e teksteve për mësimin e shqipes në raste të ndryshme dhe për nevoja të ndryshme. Më 1982 bashkë me Philip Hubbard-in dhe Peter Prifti-n te Stanford University

Press të Universitetit të Kalifornisë në 343 faqe të formatit të madh botoi veprën *Standard Albanian*. A reference Grammar for Students (Shqipja standarde. Gramatikë referenciale për studentë). Qysh në mbështjellësin e librit ishte paralajmëruar se pas LDB-së ishin bërë përpjekje të ndryshme për të gjetur pajtimin rreth një varieteti të vetëm të shqipes për të shërbyer si gjuhë standarde, përpjekje që kishin rezultuar në botime të ndryshme, më në fund të Drejtshkrimit dhe të Gramatikës referenciale. Autorët kanë përzgjedhur të paraqisnin rezultatet e gramatikës së atillë qoftë në formë të përshtatur apo ndonjëherë edhe të përkthyer, kuptohet, gjithmonë përmes një terminologjie të afërt për studiuesit në gjuhën angleze. Në këtë mënyrë ata ia bënë të mundur lexuesit ndërkombëtar studimin e problematikave gramatikore të shqipes gjithë duke qenë afër me përvojat dhe mënyrat e analizave të gramatologjisë shqipe. E këtillë, kjo vepër i ndihmoi në shkallë të gjerë studimet në këto fusha dhe bashkë me Gramatikën e Akademisë, atë të O. Buchholz-W. Fiedler gjermanisht dhe të Camajit të botuar anglisht, u bë vepër referimi gati e paevitueshme. Luajti dhe një rol me rëndësi në përhapjen e shqipes standarde në qarqet përkatëse. Për qëllime të nxënies së gjuhës shqipe L. Newmark bashkë me bashkëpunëtorët e tij *Spoken Albanian*, Ithaca 1980 dhe *Readings in Albanian*, Washington 1908 (1600 f.). Ka hartuar dhe tekste të tjera për nevoja të ndryshme (e kam të gjallë kujtimin nga vitit 1999 kur ai e bënte gati fjalorin me shprehje gegnisht). Në vitet '80 ai e nisi projektin e madh të Fjalorit shqip-anglisht, të cilin e botoi si *Oxford Albanian-English*

Dictionary (The most comprehensive dictionary of twentieth-century Albanian. Includes standard and non-standard Albanian, me 978 f. me shkronja të imta në dy shtylla me 40-50 hyrje në çdo shtyllë. Ky fjalor e çoi në një shkallë tjetër përhapjen dhe përdorimin e shqipes në rrafshet ndërkombëtare. Me të autori i ka bërë një shërbim të madh përhapjes së shqipes dhe përdoruesve që kanë nevojë të konsultojnë tekste shqip në mbarë botën. Me sa kam informacione, profesor Newmark e ka skicuar dhe për një pjesë elaboruar dhe Fjalorin anglisht-shqip.

Profesor Leonard Newmark ka qenë pjesëmarrës në veprimtari të ndryshme shkencore për shqipen dhe shqiptarët. Para viteve '90 të sh. XX ka qenë pjesëmarrës i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në Prishtinë, ndërsa në vitin 2000 u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Kolegët nga mbarë bota dhe miqtë e atëhershëm në Prishtinë e kujtojnë me mall gjallërinë, afërsinë dhe ngrohtësinë e bisedave me profesor Newmark-un.

Profesor Leonard Newmark i ka bërë shërbime të rëndësishme shkencës dhe dijes, sidomos albanologjisë dhe studimeve për shqiptarët, miqësinë me të cilët e seliti për më shumë se 7 dekada. Vepra e tij shkencore e botuar mbetet gjithnjë e referuar në studimet albanologjike.

U mbajt tryeza shkencore “Rishfrytëzueshmëria e brezave të rinj frekuencorë UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela”

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) nën përkujdesjen e Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut, në Prishtinë organizoi tryezën shkencore njëditore “Rishfrytëzueshmëria e brezave të rinj frekuencorë UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela”, e cila u mbajt me datën 12 shtator 2022, me pjesëmarrjen e studiuesëve dhe ekspertëve të kësaj fushe nga Kosova, Italia dhe Shqipëria.

Anëtari korrespondent, Fetah Podvorica, në fjalen e hapjes dha informacione të përgjithshme për rezultatet e projektit “Hulumtim mbi mundësitë e rishfrytëzueshmërisë së brezave të rinj frekuencorë UHF, VHF dhe valëve milimetrike për rrjete të komunikimeve pa tela në territorin e Kosovës”, projekt ky i mbështetur nga ASHAK-u, i cili është realizuar në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Universitetin Politeknik të Torinos. Në kuadër të tryezës shkencore, lidhur me këtë temë bosht, u paraqiten dhjetë kumtesa. Anëtare korrespondente Myzafere Limani paraqiti në mënyrë të detajuar rezultatet kryesore të arritura, të cilat janë të rëndësishme për mundësinë e rishfrytëzimit të brezave frekuencorë, rezultate këto të publikuara në revista të rëndësishme dhe konferenca ndërkombëtare. Akademik Neki Frashëri paraqiti informacione për radiofrekuencat në Shqipëri, ndërsa

prof. Carla Fabiana Chiasserini nga Universiteti Politeknik i Torinos mbajti një ligjëratë në lidhje me mundësinë e të mësuarit e shpërndarë të makinave bazuar në topologjitë optimale të rrjetit. Dr. Enver Hamiti në prezantimin e tij u përqendrua në mundësitë e ripërdorimit të brezave frekuencorë në objektet shkollore. Dr. Francesco Malandrino nga Këshilli Kombëtar i Kërkimeve të Italisë prezantoi temën mbi menaxhimin e rrjetit mobil nga aspekti human duke diskutuar rreth korrnizës referente të niveleve të lejuara të rrezatimit. Dr. Mimoza Ibrani paraqiti rezultatet krahasuese të hulumtimit të ndikimit të fushës eketrike të emetuar nga teknologjitë që operojnë në brezin frekuencor deri në 6GHz. Dr. Zana L. Fazliu në prezantimin e saj trajtoi disa qasje për vlerësimin e përshtatjes efektive të rrezes komunikuese në mes të transmetuesit dhe marrësit në ambiente urbane për valët milimetrike, në kushtet kur kërkohet përcaktimi sa më i saktë dhe njohja e pozitës, duke u bazuar në sinjalet e trafikut dhe në projektimin e përshtatshëm të rrezes.

Në punën e tryezës me prezantime dhe kumtesa u paraqiten edhe Dr. Hëna Maloku–Berzati nga Universiteti i Prishtinës, Rezarta Duraku-Rizaj, përfaqësuese e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Besnik Duriqi nga Telekom i Kosovës dhe Flamur Gosalci nga kompania 3CIS.

Gjatë tryezës u zhvilluan diskutime të frytshme për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe mundësitë e bashkëpunimit dhe të ndërlidhjes në mes të hulumtimeve shkencore dhe aktiviteteve të kompanive që operojnë në fushën e

telekomunikimeve dhe autoriteteve rregullative.

Ekspozitë personale e skulptorit Luan Mulliqi

Më datën 6 shtator 2022, në Galerinë Kombëtare të Maqedonisë së Veriut, në Shkup u hap ekspozita personale e titulluar “Erosi” ku u prezantuan tridhjetë skulptura në materialin bronz. Hapjen solemne e bëri ambasadori i Kosovës në Shkup, Z. Qehaja, i cili ceku rëndësinë e bashkëpunimit kulturor në mes të dy vendeve tona.

Në hapjen solemne morën pjesë një numër i madh vizitorëve nga Shkupi, Tetova dhe Prishtina.

Kjo ekspozitë zgjoi interesim të posaçëm te vizitorët, meqenëse në të njëjtën kohë ishte hapur një debat i gjerë në lidhje me edukimin seksual nëpër shkolla.

Ekspozita qëndroi e hapur deri më datën 30 shtator 2022.

Paraqitje e botimeve dhe e dokumenteve për Çamërinë



Më 28 shtator në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u paraqitën botimet dhe dokumentet për Çamërinë të një

periudhe tridhjetëvjeçare, prej vitit 1991 deri më 2021, organizuar nga nga Fondacioni “Hasan Tasini”.

Prezantimin e botimeve e hapi kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, i cili ndër të tjera tha se autorët e këtyre botimeve që po i prezantojmë sot, janë emra të shquar në fushën e shkrimit të historisë ose të letërsisë historike, të cilët me veprat e tyre kanë dhënë kontribut të çmuar për depërtime të rëndësishme në fushën e studimeve për çështjen çame. Më tej ai shtoi se Kosova gjatë historisë së saj më të re, e ka jetuar dhe rijetuar disa herë tragjedinë e ngjashme me dramën dhe tragjedinë çame: gjenocidi ndaj Kosovës është ushtruar në sekuenca të përsëritura, që nga luftërat ballkanike dhe prapa, gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore; para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, në dhjetëvjetëshin e parë dhe të dytë të ndërtimit të socializmit dhe, së fundi, me eksodin dhe spastrimin e madh etnik të vitit 1999, duke shtuar në fund se ne që i kemi përjetuar drama të ngjashme me atë të Çamërisë, kemi mësuar një gjë: e vërteta për pësime të këtilla nuk duhet të harrohet, sepse humbja e kujtesës është rituali alegorik i përsëritjes së mundshme të tragjedisë. Për botimet për Çamërinë fjalën hyrëse e mbajti prof. dr. Bashkim Kuçuku dhe më pas ligjëruan prof. Hajredin Isufi, prof. Irakli Koçollari, prof. Ahmet Mehmeti, Enver Kushi etj.

U mbajt Konferenca e 22-të Ndërkombëtare e Tendencave në Nanoteknologji në Tiranë

Konferenca e 22-të Ndërkombëtare e Tendencave në Nanoteknologji u mbajt prej 3 deri më 7 tetor 2022 në Tiranë. Ky ishte edicioni i dytë i konferencës që

mbahet në Tiranë. Konferenca ishte e bashkorganizuar nga Akademia e Shkencave me ndihmën e njësisë së hulumtimit NanoAlb dhe nga Institutet kryesore të nanoteknologjisë në Barcelonë (ICREA – ICN2 – BIST) dhe Fondacioni Phantoms. Në konferencë morën pjesë me prani fizike 250 shkencëtarë nga 25 vende të ndryshme të botës, ndërsa ASHAK-un e ka përfaqësuar prof. dr. Fetah Podvrocica, anëtar korrespondent. Konferenca i ka vazhduar punimet e veta gjatë 5 ditëve. Prof. Fetah Podvrocica ka marrë pjesë aktivisht në të, ku i ka pasur edhe dy ligjërata. Njërin ligjëratë me titull “Attachment of polymers onto material surfaces via aryl diazonium salts” e ka mbajtur më datën 6 tetor në kuadër të seminarit të përbashkët trilateral Shqipëri – Japoni – Spanjë si pjesë e njësisë kërkimore të NanoAlb. Ndërsa tjetrën ligjëratë me titull “Control of the composition of the grafted organic layer by diverting the reactivity of aryl radicals” e ka mbajtur më 7 tetor 2022 në seancën e parë të konferencës në cilësinë e ligjëruesit të ftuar.

U paraqit botimi “Çesk Zadeja në muzikën shqiptare”



Më 4 tetor 2022 në ambientet e Akademisë u promovua libri studimor i

akademik Vasil S. Tole “Çesk Zadeja në muzikën shqiptare (jeta dhe vepra)”, me pjesëmarrjen e ministrit të Kulturës të Republikës së Kosovës, z. Hajrullah Çeku, të anëtarëve të akademisë dhe të të interesuarve të tjerë nga fusha e muzikës dhe e studimeve muzikologjike. Për librin e V. Toles foli Suzana Jakupi, e cila e bëri një përshkrim të përmbajtjes së librit dhe vështrim të përgjithshëm të aspekteve biografike dhe të krijimtarisë së kompozitorit, Çeska Zadeja. Akademik Vasil S. Tole shprehu mirënjohje dhe falënderoi ASHAK-un për botimin e librit dhe për organizimin e promovimit. Ai në mënyrë të veçantë foli për lidhjet e kompozitorit Zadeja me Kosovën, me kompozitorët dhe njerëzit e muzikës në Kosovë dhe për inspirimet e tij nga areali muzikor gjithëkombëtar.

U mbajt ligjërata e dr. Joachim Matzinger dhe dr. Katsiaryna Ackermann

Më 6 tetor 2022, në ambientet e Akademisë, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë organizoi ligjëratën e dr. Joachim Matzinger dhe dr. Katsiaryna Ackermann me temë: “Settlement Dynamics and Toponomastics of the Balkans 1: Albanian-speaking areas”.

Kryetari i ASHAK-ut me bashkëpunëtorë merr pjesë në manifestimin e shënimit të 50-vjetorit të ASHSH-së

Në seancën solemne më 10 tetor Kryetari Kraja paraqiti fjalën përshëndetëse:

“Të nderuar miq, akademikë, mysafirë dhe të tjerë të pranishëm!
Më lejoni që nga kjo foltore e rëndësishme e historisë më të re të Shqipërisë, në emër të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës t’i uroj Akademisë së Shkencave të Shqipërisë 50-vjetorin e themelimit, një përvjetor ky shumë i rëndësishëm i dijes dhe i shkencës shqiptare në përgjithësi.

Uroj që në vitet dhe dekadat që vijnë të shënoni suksese të reja në misionin tuaj të rëndësishëm të përparimit të shkencës dhe thellimit të dijes shkencore në funksion të iluminimit të mbarë botës shqiptare.

Ky gjysmë shekulli i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë është i shoqëruar me prurje idesh të lidhura ngushtë me dimensionin më vital të historisë së kombit shqiptar, me albanologjinë, me historinë, me shkencat e tjera shoqërore dhe ato të natyrës, të cilat përbëjnë korpusin e madh të dijes dhe të identitetit. Studimet që kanë buruar nga ky institucion kanë synuar të zënë vendin e vlerave më të qëndrueshme dhe të arritjeve tona më të mëdha në fushën e shkencës dhe të njohjes.

Të nderuar miq!
Themelimi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më 1972 dhe themelimi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 1975 shënuan fazë të re në zhvillimin e shkencës në botën shqiptare.

Pavarësisht se koha jonë ka njohur ndryshime të mëdha në të gjitha fushat, përfshirë edhe studimet dhe kërkimet shkencore, përkujdesja institucionale mbi këtë veprimtari vjen dhe bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, veçmas në rrethanat tona, kur qarkullimi i ideve ka filluar tashmë të

shoqërohet me lëvizje demografike jotipike dhe me një zhvendosje fizike edhe të bartësve të dijes shkencore. Ne sot po përballemi me një dëmtim substancial të potencialit shkencor, i cili po largohet nga vendet tona, jo vetëm si potencial krijues, por edhe si recipient i kësaj dijeje, njësoj sikundër edhe i vlerave artistike.

Mbase është thjeshtë iluzion, por nga kjo foltore më lejoni të them se nxitja institucionale e një fryme idealiste në krijimtarinë shkencore dhe artistike ndoshta do t’i ndryshonte trendet negative të mërgimit të bartësve të krijimtarisë dhe të dijes, të cilët po largohen bashkë me ardhmërinë tonë, bashkë me potencialin krijues të së nesërme sonë.

Me këtë idealizëm pothuajse të braktisur, nxitja e frymës kritike në dijet shkencore, përfshirë edhe çideologjizimin e tyre, pastaj me bashkëkohësimin e metodave të hulumtimit, pa mëdyshje që do të krijoheshin impakte të reja, duke ndihmuar ristrukturimin dituror të mbarë botës shqiptare.

Ju faleminderit!”

Simpoziumi “Energjia e pastër dhe zhvillimi i qëndrueshëm”

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) nën përkujdesjen e Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe atij të Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut, në Prishtinë organizoi simpoziumin shkencor njëditor “*Energjia e pastër dhe zhvillimi i qëndrueshëm*”, i cili u mbajt me datën 14 shtator 2022, me pjesëmarrjen e studiuesve dhe ekspertëve nga Kosova, Shqipëria, Kroacia, Zvicra dhe Britania e Madhe. Këshillin organizativ të këtij Simpoziumi

e përbënin: akad. Fejzullah Krasniqi, akad, Jorgaq Kaçani, akad. Isuf Krasniqi, akad. Justina Pula, anëtar korrespondent, Fetah Podvorica, akad. Ilirjan Malollari dhe anëtar korrespondent, Myzafere Limani. Akademik Fejzullah Krasniqi, kryetar i këshillit organizues shkencor, në fjalën e hapjes dha informacione të përgjithshme për qëllimin e simpoziumit. Më tutje, mbajtën fjalime kryetari i ASHAK-ut, akademik Mehmet Kraja, akademik Jorgaq Kaçani në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe ministrja e Ekonomisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, dr. Artane Rizvanolli.



Në simpozium u paraqitën gjithsej 15 kumtesa. Në seancën e parë kumtesën e tij e paraqiti prof. Neven Duić nga Universiteti i Zagrebit (Kroaci): “Si të bëjmë një tranzicion të shpejtë të energjisë me sistemet inteligjente”, në të cilën bëhej fjalë për tranzicionin energjetik në vende të ndryshme të botës, duke disenjuar modelet e suksesshme të integritimit të burimeve të ripërtrishme në sisteme të mençura të energjisë. Më tutje prof. Amor Abdelkader, profesor në Universitetin e Bournemouth-it të Britanisë së Madhe kishte prezantimin me titull “Bateritë metalike alkaline për ruajtjen e energjisë së nesërme: përtej sistemeve kimike të litiumit”. Ai tregoi për modelet e reja të baterive alkaline që përmbajnë jone të metaleve alkaline,

të cilat kanë performanca pothuajse të njëjta me bateritë e litiumit dhe që është metal që nuk është shumë i pranishëm në kore të tokës. Më pas prezantimin me titull “Rruga drejt dekarbonizimit të sektorit energjetik” e mbajti prof. Adhurim Haxhimusa nga Universiteti i Grisons në Zvicër. Ai paraqiti të dhëna për mënyrat e tranzicionit energjetik në vende të ndryshme në BE dhe sfidat me të cilat përballlet Kosova në këtë proces. Në seancën e dytë u paraqitën prezantimet: “Analiza e sistemeve të kapjes së CO2 pas djegies përmes simulimit të procesit duke përdorur Aspen Hysys” nga akademik Ilirjan Malollari, pastaj “Energjia dhe ndryshimet klimatike” nga prof. Majlinda Daci, “Analiza energjetike dhe mjedisore e përdorimit aktual të ngrohjes dhe rekomandime për sistemet më të përshtatshme të ngrohjes energjetike dhe mjedisore në qytetin e Korçës” nga prof. Ramadan Alushaj, “Efiçienca energjetike e prodhimit të energjisë mekanike nga termocentralet” nga akademik Fejzullah Krasniqi, “Sfidat e tranzicionit energjik të Kosovës përmes burimeve të ripërtrishme” nga prof. ass. Arben Gjukaj dhe “Strategjitë e zhvillimit në sektorët energjetikë të Kosovës drejt një sistemi të qëndrueshëm energjetik” nga prof. ass. Drilon Meha. Në seancën e tretë u paraqiten prezantimet e tyre: Msc. Andi Hida, Msc. Arlinda Bresa, Msc. Elio Voshtina, Msc. Bukurije Hoxha, Msc. Blerina Bylykbashi dhe prof. ass. Bahri Prebreza. Pas secilit prezantim u zhvilluan diskutime të frytshme për temat e shtjelluara në kuadër të tranzicionit energjetik. Në fund të seancave anëtar

korrespondent Fetah Podvorica
paraqiti konkluzionet e simpoziumit.

Konferenca shkencore “Roli i këmbimit të dhuratave në konstituimin e lidhjeve shoqërore”



Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) nën përkujdesjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore, në Prishtinë organizoi konferencën shkencore njëditore “Roli i këmbimit të dhuratave në konstituimin e lidhjeve shoqërore”, e cila u mbajt me datën 28 tetor 2022.

Fjala e kryetarit të ASHAK-ut në 55-vjetorin e Institutit të Historisë së Kosovës

“Të nderuar historianë dhe të tjerë të pranishëm!

Më lejoni që në fillim t’ju uroj 55-vjetorin e themelimit të Institutit të Historisë dhe t’ju dëshiroj arritje dhe depërtime të reja në ndriçimin e të vërtetës historike për Kosovën dhe të shkuarën e saj.

Këtu e 55 vjet më parë, Instituti i Historisë së Kosovës, Enti, siç quhej në fillim, u themelua për t’i dhënë mbështetje ideologjike një ideje politike: se kombet dhe kombësitë e

asaj ish-Jugosllavie ishin të barabartë dhe se kjo barazi buronte nga pjesëmarrja e tyre në Luftën Nacionalçlirimtare, në revolucion dhe në vetëqeverisjen socialiste. Por, meqë në atë ish-Jugosllavi disa mund të ishin më të barabartë se të tjerët dhe se e vërteta e tyre historike mund të ishte më e vërtetë se e vërteta historike e të tjerëve, në fillim ky Institut u quajt Ent dhe kompetencat e tij nuk mund të shkonin përtej glorifikimit të LNÇ-së dhe heronjve të saj.

Më pas, me Kushtetutën e vitit 1974, e vërteta historike e Kosovës, disi duke u “shtyrë me bërriyla”, siç i thonë një fjale, fitoi të drejtën të futej në një garë të vështirë dhe të pabarabartë për të dëshmuar jo vetëm pjesëmarrjen shpesh të mohuar në LNÇ, por mbi të gjitha të përballonte dhe t’i kundërvihej shovinizmit historiografik serb dhe jugosllav, i cili mohonte origjinën, zhdukte dëshmi për trashëgiminë dhe me çdo kusht donte të pamundësonte çdo subjektivitet historik të Kosovës. Në këtë pikë ishin të një mendjeje pothuajse të gjitha kombet dhe kombësitë e ish-Federatës jugosllave: Kosova nuk mund të ishte asgjë më shumë se një tokë e pushtuar dhe e harruar në heshtjen e saj.

Të bëhej Kosova me subjektivitet historik në një rrethanë të tillë pothuajse dukej e pamundur. Ashtu sikundër mund të pritej, ndërkohë, përballja e vazhdueshme me këtë trend mohimi, sikundër edhe krijimi i një fronti të përhershëm të refuzimit ndaj tij, krijoi terren të përshtatshëm për nacionalizmin tonë historik, i cili i glorifikoi ngjarjet dhe personat e historisë deri në dëmtim të ndjeshëm të substancës dhe të përmbajtjeve historike.

Kjo i përket së shkuarës dhe është ajo

pjesë e historisë së Kosovës që duhet të rishkruhet ose të ridizajnohet. Sot konsiderohet se nacionalizmi historik është errësim i mendjes dhe i gjykimit kritik. Këtë mësim largvajtës për historinë e kemi mësuar të gjithë dhe tani na mbetet që nga parimet e vlerësimit kritik, të kalojmë në terrenin e vështirë të rishkrimit të historisë në shumicën e përbërësve të saj. Kjo nuk do të mund të bëhet me një urdher dhe me një dekret, por mbase mund të bëhet me një atmosferë produktive në shkencë, në shkencën e historisë në këtë rast, duke nxitur njohjen më të mirë të dëshmimeve historike dhe dokumenteve arkivore, leximin e tyre objektiv dhe interpretimin mbi baza thellësisht shkencore.

Pas kësaj përvoje 55-vjeçare të këtij institucioni të shkrimit të historisë së Kosovës, besoj se ju mund ta bëni këtë! Ju faleminderit dhe urime!”

U paraqit botimi i Brian D. Joseph “Vështrime albano-ballkanologjike”



Më 7 nëntor, në ambientet e Akademisë, nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë u paraqit botimi i librit “Vështrime albano-ballkanologjike” i autorit Brian D. Joseph dhe më pas u mbajt ligjërata e tij me titull “Pse është gjuha shqipe e rëndësishme për gjuhësinë?”.

Për autorin Brian D. Joseph, për arritjet e tij në fushën e shkencës së albanologjisë, foli akademik Rexhep Ismajli, ndërsa paraqitjen e librit “Vështrime albano-ballkanologjike” e bëri anëtari korrespondent Bardh Rugova.



Me këtë rast albanologut B. Joseph, nga kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, iu dorëzua fletëdëshmia e pranimit anëtar i jashtëm i Akademisë së shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Konferencë jubilarë në nderim të 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit

Kryetari Kraja me bashkëpunëtorë më 10 nëntor mori pjesë në ceremoninë e shënimit të 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit. Ai u paraqit me fjalë përshëndetëse, si në vijim:

“Të nderuar miq, akademikë, dinjitarë të gjuhës shqipe, zoti President, Kryeministër!

Më lejoni të them që në fillim, se unë i takoj asaj gjenerate, e cila e ka njohur dhe e ka përjetuar gjuhën letrare shqipe në të gjithë përbërësit e saj: idealizmin, entuziazmin, ndonjëherë dilemat dhe

skepticizmin, më pas përpjekje agresive për ta reviduar standardin, për ta përdorur paskajoren si “mea culpa” për të gjitha dështimet.

Sot, duke qenë shkrimtar që i përkulet gjuhës shqipe si më të madhes vlerë që kemi, ju them pa asnjë mëdyshje se gjuha letrare shqipe nuk më ka zhgënjyer asnjëherë, as me kuptimet e bartura të fjalëve, as me të kryerën e tejshkuar ose me paskajoren e foljeve dhe as me hijeshinë sintaksore që marrin fjalitë e bashkërenditura ose nënrenditura në një frazë shumëkuptimore.

I lexoj dhe i shijoj me po aq ëndje Mjedën dhe Fishtë, Naimin dhe Çajupin, Koliqin dhe Kutelin.

Gjuha letrare shqipe u ka shërbyer mrekullisht të gjithë shkrimtarëve të mirë, më pak u ka shërbyer shkrimtarëve mesatarë dhe pak ose aspak u ka shërbyer shkrimtarëve të pazot, të cilët edhe sot vazhdojnë ta fajësojnë gjuhën letrare për dështimet eventuale në fushë të krijimtarisë dhe të dijes. Skepticizmi i tyre nuk ka të bëjë me mundësitë e gjuhës, por me mungesat e tyre në fushën e dijes dhe të njohjes.

Përtej këtyre observimeve personale, më lejoni të them se në Kosovë gjuha letrare shqipe dhe standardi, gjatë këtyre njëzet vjetëve kanë njohur zhvillime pozitive: tashmë ka ndodhur dhe po vazhdon një proces i gjatë dhe i vështirë i desllavizimit, si dhe i kthimit të gjuhës shqipe nga gjuhë e dytë në gjuhë të përdorimit të gjerë shtetëror dhe institucional.

Por në këtë drejtim ne kemi ende shumë punë për të bërë, sepse Kosova përveç shtetit politik, gjeografik, shtetin juridik, diplomatik,

administrativ, ushtarak, e ka të nevojshme të bëjë edhe shtetin gjuhësor. Ky është një proces i vështirë, që duhet të fillojë nga Kushtetuta e Kosovës, e cila, e miratuar nën trysni të mëdha, bën diskriminim gjuhësor, duke vendosur në pozitë të barabartë gjuhën e 95% të folësve me gjuhën e 5% të folësve të Kosovës.

Së fundi më lejoni të them se shtetet tona nuk kanë nevojë të bëjnë politika të mbrojtjes së gjuhës nga folësit e saj, madje edhe nëse ata ndonjëherë ndodh të abuzojnë me gjuhën dhe nuk janë në të drejtën e Zotit për me e përdorë gjuhën me dinjitet dhe nder, por shteti ka nevojë të bëjë politika të mbrojtjes së gjuhës nga braktisja e folësve të saj. Ju faleminderit për vëmendjen!”

Konferencë shkencore “Shqipja standarde sot”



Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, nën përkujdesjen e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, në Prishtinë me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimi organizoi konferencën shkencore njëditore “Shqipja standarde sot”, e cila u mbajt më datën 17 nëntor 2022.

Ligjëratë e Irena Savickës



Më 22 nëntor 2022, në ambientet e Akademisë, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë organizoi ligjëratën e prof. dr. Irena Sawicka me temë: “Izokronia në gjuhën shqipe”.

Për profesoreshën Irena Sawicka, për arritjet e saj në fushën e shkencës së albanologjisë, foli akademik Rexhep Ismajli.

Me këtë rast albanologes Irena Sawicka, nga kryetari i Akademisë, akademik Mehmet Kraja, iu dorëzua fletëdëshmia e pranimit anëtar i jashtëm i Akademisë së shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Akademikët Sabri Hamiti dhe Rexhep Ismajli qëndrojnë në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë

Më 24-26 nëntor akademikët Sabri Hamiti dhe Rexhep Ismajli me ftesë të Akademisë Sllovene qëndruan në Lubjanë. Më 25 nëntor në mjediset e Akademisë, S. Hamiti mbajti ligjëratë me titull: “Letërsia shqipe e shekullit XXI”. Ligjëratat u mbajt në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ASHAK-SAZU.

U çel ekspozita e Eshref Qahilit



Me datë 1 dhjetor 2022 në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në prani të një numri akademikësh dhe artdashësish të tjerë, u çel ekspozita personale e piktorit Eshref Qahili. Ekspozitat e prezantuara në ekspozitë përbëjnë një retrospektivë të punës krijuese të Qahilit, të përfshirë në disa cikle, që autori i ka përmbledhur me titullin e përbashkët “Muzeu i fëmijërisë”.

Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më 16 dhjetor.

Ekspozitë për abetaren shqip (1844-1942)



Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit çelën të enjten, më datë 15 dhjetor, ekspozitën retrospektive “Rrugëtimi i abetares shqip 1844-1942”, e cila sjell për herë të parë në

Prishtinë ekzemplarë të rrallë të teksteve të abetareve të gjuhës shqipe të personaliteteve dhe figurave të shquara të kombit.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, z. Mehmet Kraja, tha se “me këtë aktivitet po prezantohet një periudhë 100-vjeçare e historisë së abetares shqipe. Janë më shumë se 100 vjet të abetares shqip, me një distancë kohore më shumë se 70 vjet deri në ditët e sotme, kjo nuk është thjesht një e dhënë historike se abetarja shqipe ka një moshë pjekurie gati 180-vjeçare, por më shumë se kaq, reflekton një përpjekje për të gjetur rrugë më të përshtatshme për emancipim të përgjithshëm të një populli të vuajtur, të dëshpëruar, për të gjetur metoda më efikase shkencërisht të mbështetur për nxënësit, për të nxënëit e shkronjës shqipe si parakusht i dijes, por edhe i identitetit”, duke theksuar më tej se “abetarja nuk ka qenë asnjëherë të shqiptarët vetëm për të nxënëit të shkronjave, por edhe vetëdije për përkatësi”.

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, z. Piro Misha, vuri në dukje se “ekspozita lë për të kuptuar dhe vlerësuar rrugën për emancipimin shqiptar. Pjesa më e madhe e abetareve janë shtypur e botuar jashtë vendit, që reflekton për situatën e vështirë që ekzistonte dhe vështirësitë në rrugëtimin e njohjes dhe përhapjen e gjuhës shqipe dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare. Ato janë shtypur në Stamboll, Bukuresht, Selanik, Firence apo Vjenë”. Më tej, z. Misha bëri me dije se “‘Ëvetari’ i Veqilharxhit gjen në bibliotekë edhe formatin e tij digjital dhe shumë shpejt do të krijohet edhe katalogu me gjithë abetaret në gjuhën shqipe”.

Ndërkohë, drejtorja e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, znj. Alda Bardhyli, e ka konsideruar ekspozitën si “udhëtimin më të mirë në ndërgjegjen e shqiptarëve që bart punën e madhe për edukimin e brezave. Sipas saj, “ekspozita përmban ngjyrat dhe gjithë punën e madhe për edukim nëpërmjet abetares, si mesazhi më i mirë për pastërtinë e gjuhës në kohën kur çdoherë e më shumë po hyjnë fjalë të gjuhëve të huaja. Abetarja është mjeti identitar i shqiptarëve që ka pasur rol të rëndësishëm në përsosjen e gjuhës shqipe, por në anën tjetër do të doja ta shihja këtë ekspozitë edhe si formë nderimi për të gjitha ato figura që kanë kontribuar pikërisht për këtë përsosje shpirtërore dhe qytetërimi të shqiptarëve”, përfundoi znj. Bardhyli. Kjo ekspozitë, e cila vjen nën kujdesin e veçantë të dr. Etleva Domit, zëvendësdrejtoreshë e BKSh-së, sjell për herë të parë në Prishtinë ekzemplarë të rrallë të teksteve të abetareve, që ruhen si një trashëgimi e vyer në fondin arkivor të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, duke shërbyer edhe si një kujtesë e kontributeve në botimin e abetareve të gjuhës shqipe të personaliteteve dhe figurave të shquara të kombit. Ato mbajnë për autorë emra të mëdhenj të letrave shqipe, duke nisur me Naum Veqilharxhin e duke vijuar me Kostandin Kristoforidhin, Anastas Kulluriotin, Sami Frashërin, Jeronim de Radën, Luigj Gurakuqin, Nikolla Lakon, Mati Logorecin, Ndre Mjedën, Jani Vreton, Pashko Vasën, Ndoc Nikajin, Parashqevi Qiriazin, Aleksandër Xhuvanin, Ndue Paluçen etj., të cilët duhet t’i kujtojmë për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm. Janë rreth 100 vjet rrugëtim të

abetares shqip, duke nisur nga abetarja parë e gjuhës shqipe e njohur gjer më sot, ajo e Naum Veqilharxhit më 1844, e cila mendohet të jetë botuar në Bukuresht ose Brail, Rumani, duke shkuar deri në vitin 1942 me abetaret toskërisht e gegënisht, botuar nga Ministria e Arsimit në Firence. Shumica e abetareve të ekspozuara janë shtypur jashtë vendit, çka reflekton edhe situatën e vështirë që ekzistonte në Shqipëri dhe vështirësitë në rrugëtimin e lëvrimin, njohjen dhe përhapjen e gjuhës shqipe dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare. Këto abetare janë shtypur në Bukuresht, Konstancë, Athinë, Selanik, Bruksel, Firence, Milano, Vjenë, Paris, Stamboll, Sofje etj. Ndërkohë që abetarja e parë e shtypur në vend është ajo e Shoqërisë “Bashkimi”, shtypur në Shkodër, më 1899.

Ekspozita tërheq vëmendjen e publikut me abetaren e Kostandin Kristoforidhit (1872), ku dallohet struktura bashkëkohore e tekstit dhe krijimtaria letrare e spikatur; të Vasil Rusosë (1877) “Pelagjika” me alfabet të përzier; të Anastas Kulluriotit me “Abavatar Arbëror” (1882), botuar në Athinë; Gaspër Benusit (1890), botuar në Bukuresht; “Abecedario”-n e Jeronim de Radës, botuar në Koriliano Kalabro, në kuadër të Kongresit të Gjuhës Shqipe, më 1896; “Alfabetaren” e Stambollit të vitit 1879, të Jani Vretos, Sami Frashërit, Koto Hoxhit, Pashko Vasës, botuar nga “Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip” me alfabetin e Stambollit, e cila pati përhapje të gjerë dhe u përdor si model për tekstet e gjuhës shqipe; abetaret e Sami Frashërit (1886, 1888, 1900) që u përdorën si tekste mësimore për Mësonjëtorët Shqipe; atë të Jovan Risto Terova (1887), botuar në

Bukuresht, e cila kishte fizionominë e një teksti mësimor të mirëfilltë etj. Ndërkohë që abetarja e parë që botohet në Shqipëri “Abetari i citun prei Shocniet t’ Bashkimit”, daton në vitin 1899, në Shkodër, në vitin 1904, në Vjenë, Ndre Mjeda boton “Këndime për shkollë të para”, me karakteristikën që çdo tingull shoqërohej me figurë. Më 1909, në Paris, Nikolla Lako boton “Stërvitjetore për nxënësit shqipëtarë”, më 1909 në Manastir, Parashqevi Qiriazhi boton abetaren e saj, e cila shërbeu si tekst mësimor për “Shkollën e Vashave” e hapur në vitin 1891, ku ajo ishte mësuese etj.

Në vitrinat e ekspozitës numërohen edhe mjaft botime të realizuara në Shqipëri, si: “Abetarja” e vitit 1910 në Korçë nga mësuesi i “Mësonjëtores” Ali Korça, “Abetare për Shkolla Fillore” në vitin 1911 në Elbasan nga Dhimitër Papanisto me editor Lef Nosin; “Abetareja shqip” më 1911, po në Elbasan nga Simon Shuteriqi; Ndoc Nikaj në Shkodër, më 1915; Thoma Pano në Vlorë, më 1919; Dhori Koti më 1922, në Korçë, në Tiranë nga Ndue Paluca më 1931 e 1939, Aleksandër Xhuvani e Pertef Pogoni prej vitit 1923-1938, Mati Logoreci etj.

Ekspozita mbyllet me disa botime për abetaret shqipe dhe alfabetin e gjuhës shqipe të studiuesve: Xhevat Lloshi, Gjystina Shushka (Cacaj), Shefik Osmani e Njazi Kazazi, Tomorr Osmani, Kujtim Bevapi, Petro Janura etj.

Koncert festiv



Më 20 dhjetor u mbajt koncerti tradicional i fundvitit, me vepra të zgjedhura të kompozitorëve të njohur e që u interpretuan nga solistë e instrumentistë të mirënjohur nga Kosova, si: Lule Elezi

Lirika Pula, Pranvera Hoxha, Alba Muçolli Dehiri, Syzana Jakupi, Zana Badivuku Basha, Besa Llugiqi, Adelina Paloja, Zana Ramadani, Arta Jashari, Adhurim Grezda, Nikollë Gjini, Arstina Kelmendi, Elikona Hysaj, Sihana Badivuku, Antonio Gashi, Enkelelda Gorani.



**VJETARI
2022**

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Bahri Koskoviku

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 8 tabakë shtypi

Tirazhi: 100 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

